



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva


RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT DHE DREJTORIVE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS (JANAR-DHJETOR 2024)

KRYETARI
EKREM KASTRATI



Malishevë, Maj 2025



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 06.05.2025
PËRSHENJE:
Mr. No. 01/536



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

1. HYRJE	f. 2-12
2. DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCË DHE BUXHET	f. 13-18
3. DREJTORIA E URBANIZMIT	f. 18-23
4. DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM	f. 23-40
5. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE	f. 31-56
6. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE	f. 56-70
7. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	f. 71-87
8. DREJTORIA E INSPEKTORATIT	f. 88-93
9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË	f. 94-105
10. DREJTORIA PËR PRONË	f. 106-107
11. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	f. 108-129
12. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË	f. 130-136
13. DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM	f. 136-141
14. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM	f. 141-144
15. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM	f. 144-151
16. PËRFUNDIME	f. 152
17. SHTOJCA NR. 1 - RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE	
18. SHTIJCA NR. 2 - RAPORTI PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE	



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

HYRJE

Raporti i Punës së Kryetarit dhe drejtorive komunale të Komunës së Malishevës, është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Malishevës dhe akteve të tjera nënligjore, dhe si rrjedhojë e kësaj, gjithë angazhimi i Kryetarit të Komunës dhe organeve tjera komunale, gjatë periudhës së raportimit janar-dhjetor 2024, ka qenë në funksion të respektimit të rendit, ligjit dhe disiplinës në punë.

Ky Raport pasqyron një përmbledhje të disa prej projekteve më kryesore që kemi bërë gjatë këtij viti si qeverisje komunale, ku disa nga këto projekte dhe angazhime kanë përfunduar, dhe disa nga to janë ende në proces të realizimit, gjithnjë konform afateve kohore të parapara.

Sigurisht që puna dhe angazhimi i Kryetarit të Komunës dhe drejtorive tona komunale, gjatë vitit 2024 ka qenë i shtrirë në fusha të ndryshme, ku secila nga ato e kanë pasur rëndësinë e vet të veçantë në raport me interesin e qytetarëve tanë, e ndër më kryesorët janë të listuara më poshtë:

▪ ENERGJIA ELEKTRIKE

Pa dyshim që, edhe këtë vit një nga preokupimet më kryesore të qeverisjes sonë komunale në vazhdimësi ka qenë edhe zgjidhja e çështjes për **energji elektrike** për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës.

Ne si qeverisje e kemi marrë shumë me seriozitet këtë çështje, dhe siç e dini që në start të mandatit tonë, pra para 3 viteve kemi filluar të zhvillojmë takime me të gjitha institucionet e mundshme, pra me KOSTT, me KEDS, me ZRRE, etj.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Pas një angazhimi shumë të madh, më në fund. Tek gjatë këtij viti ne kemi arritë që kërkesat tona dhe shqetësimet tona të trajtohen nga ana e KEDS.

Pra, gjatë verës 2024 ka filluar implemtimin i projektit për vendosjen e një kablllo kualitativ, pra një përçuesi të ri elektrik, që për të qenë korrekt, ka ardhur direkt nga SHBA-të, dhe për herë të parë është vendosur në qytetin tonë, si vendi i parë që një përçues i tillë po vendoset në një vend të Ballkanit Perëndimor.

Implementimi i këtij projekti ka pasur një kosto rreth 1 milion euro. Mirëpo, kosto më e madhe dhe e cila për ne ka qenë edhe brenga më e madhe gjatë këtij viti, është ajo e reduktimeve të detyrueshme të energjisë elektrike, ku pa shmangshëm i ka dëmtuar edhe ekonomitë familjare, por edhe bizneset. Mirëpo, çdo punë që niset me synime të mira, e kanë edhe një fund të mirë. Prandaj, gjatë tetorit ky projekt është përmbyllur, dhe Malishevës i është kthyer normaliteti sa i përket furnizimit me energji elektrike.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm për ngarkesat që ka shkaktuar implementimi i këtij projekti, mirëpo jam edhe shumë krenar që qytetarët tanë e kanë mirëkuptuar situatën tonë, dhe për këtë u jam pafundësisht mirënjohës.

Por, pavarësisht nga kjo, ne në të njëjtën kohë kemi vazhduar angazhimin edhe në raport me KOSTT, sepse fokusi ynë final mbetet ndërtimi i nënstacionit prej 220kV në komunën e Malishevës.

Faza e parë e hartimit të projektit ka përfunduar dhe jemi në pritje për të vijuar me fazën e tenderimit, për ti dhënë një herë e mirë zgjidhje komunës sonë lidhur me energjinë elektrike. Mos të harrojmë se kur jemi te energjia elektrike, përgjegjës kryesor edhe me ligj është qeveria e Kosovës, konkretisht institucionet e saj vartëse, këtë rast KOSTT, ZRRE dhe normal KEDS.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

▪ FURNIZIMI ME UJË

Një tjetër preokupim i yni gjatë këtij viti (2024) por edhe viteve më parë, ka qenë çështja e ujit të pijes, një problem me të cilin ballafaqohen në masë të madhe qytetarët tanë, dhe për të qenë korrekt, lidhur me shqetësimet që qytetarët tanë kanë në lidhje me ujin, unë asnjëherë nuk i kam trajtuar me arrogancë, por gjithmonë i kam mirëkuptuar, pavarësisht se mundësia e Komunës për të bërë diçka më shumë përtej kapaciteteve aktuale që kemi janë shumë të vogla.

Lidhur me çështjen e ujit, besoj e kemi bërë mjaftueshëm publike edhe herëve të tjera, se, ne kemi vënë kontakte me një nga organizatat më të fuqishme austriake “OSTAP”, të cilët na kanë përkrahur në realizimin e një projekti ideor për zgjidhjen e çështjes së ujit, të cilët bashkë me stafin tonë komunalë kanë dalë për disa muaj rresht në teren, kanë bërë matje dhe analiza të shumta për tu kyçur në Ujësjellësin e Radoniqit. E kemi finalizuar si dokument, pastaj në bashkëpunim me ta edhe e kemi adresuar një kërkesë në Qeveri të Kosovës, për të na dhënë një përkrahje procedurale, që në si Komunë të merrnim një financim kaq të madh nga Austriakët.

Mirëpo deri më tani nuk kemi marrë përgjigje as nga Ministri i Financave, dhe as nga Kryeministri i Kosovës.

Po ashtu, kemi bërë edhe disa angazhime të fundit rreth kësaj çështje, ku muajt e fundit kam bërë me dhjetëra komunikime zyrtare edhe me disa donatorë të tjerë, ku ne si Komunë po kërkojmë në vazhdimësi të na financojnë projektin për furnizim me ujë të pijes. Kërkesat e fundit jemi duke i adresuar edhe përmes misionëve diplomatike në Kosovë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Gjithashtu, ne si Komunë kemi vazhduar edhe bashkëpunimin me kompaninë qe operon tek ne “Hidroregjionin Jugor”, ku në bazë të një Memorandumi të Mirëkuptimit, që kemi, i ka hapur rrugë iniciimit të disa projekteve konkrete, në funksion të shfrytëzimit maksimal të burimeve ekzistuese të ujit të pijes, mundësisë së rritjes së kapaciteteve në mënyrë që të bëjmë zgjidhje për të gjitha fshatrat e komunës sonë, si dhe për të ndërmarrë hapa konkret për menaxhimin e ujërave të ndotura.

Pra, këto janë disa nga angazhimet tone, që kemi bërë dhe e kemi për obligim të bëjmë si qeverisje komunale, sa i përket çështjes se furnizimit me **energji elektrike** dhe furnizimit me **ujë të pijes** për qytetaret e Komunës se Malishevës.

▪ REALIZIMI I PROJEKTEVE TË TJERA

Falë një angazhimi të madh të të gjithë qeverisjes sonë komunale, duke ju falënderuar edhe bashkëpunimit të mirë me Asamblenë Komunale, dhe në përgjithësi kuadrit të Komunës sonë, por mbi të gjitha falë bashkëpunimit dhe koordinimit të shkëlqyeshëm me qytetarët tanë, gjatë vitit 2024 janë realizuar projekte të infrastrukturës publike, me fokus projektin tonë më madhor në gjithë historinë e zhvillimit të Malishevës, pra projektin e “Ndërtimit të Sheshit së bashku me parkingun nëntokësor”, pa lënë anash, gjithmonë sipas mundësive edhe projekteve të tjera si;

- Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve lokale
- Ndërtimi dhe vazhdimi i trotuareve në Qytezë dhe në fshatra,
- Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza,



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Renovimi i objekteve të shkollave fillore dhe të mesme,
- Ndriçimi publik,
- Investimet në shëndetësi, arsim, sport, kulturë,
- Mirëmbajtja e rrugëve lokale,
- Mirëmbajtja e kanalizimeve të ujërave të zeza nëpër fshatra dhe Qytezë, etj.

Lidhur me aktivitetet e shumta që janë realizuar përmes drejtorive tona përkatëse, me lejoni që të përmend vetëm disa nga më kryesorët, si të përmbledhura, ndërsa në raportet e mëposhtme sipas drejtorive përkatëse mund t'i gjeni më të zgjeruara;

- Siç e thash, është duke u punuar me intensitet të lartë në projektin më madhor në historinë e Komunës sonë, pra projekti i Sheshit të Dëshmorëve, një projekt i jashtëzakonshëm që për qëllim ka Urbanizimin e qytetit. Ky projekt tashmë është në një fazë të rëndësishme të punimeve, dhe besojmë e shpresojmë që ta përfundojmë sa më parë që ta kemi të gatshëm para se mërgata jonë të vie për pushime në vendlindje, nëse edhe kjo pjesë e punimeve aktuale ecën sipas planifikimeve dhe projekteve tona edhe kohore.
- Lirimi i hapësirave publike – Gjatë këtij viti ka vazhduar edhe procesi i lirimit të hapësirave publike, me theks të veçantë në segmentet e rrugëve ku është duke u punuar në projektin e sheshit, pra janë rrugë që janë të prekura përmes këtij projekti.
- Ka nisur realizimi i një projekti tjetër të madh, ai i rregullimit dhe trajtimit të shtratit të lumit nga Ura në qendër deri te ura e mini-transitit. Ky projekt është i rëndësishëm, dhe i hap rrugë zhvillimit dhe zgjerimit të qytetit të Malishevës, gjithmonë në kuadër të



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

projekteve tona për Malishevën Urbane. Është projekt që ne e kemi fituar përmes Grantit të Përformancës Komunale, ku komuna e Malishevës ka qenë në mesin e pakë komunave të Kosovës që e ka fituar një grant të tillë.

- Një projekt tjetër i cili është finalizuar së fundmi është edhe Ndërtimi i Tribunës Lindore dhe zhveshtoreve në stadiumin “Liman Gegaj” në Malishevë. Ky projekt është bërë me qëllim të përmirësimit të kushteve për klubet tona sportive, me theks të veçantë për klubin tonë të qytetit, FC Malisheva, që është duke treguar suksese të larta në garat e super ligës së Kosovës në futboll, por këtë vit (2024) ka përfaqësues Komunën tonë dhe vendin tonë edhe në Garat evropiane të Ligës së Konferencës.
- Po ashtu, një tjetër investim që kemi bërë gjatë këtij viti raportues është edhe ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Habib Berisha”, që lidhet nga rrethi afër Lindi Center dhe që shkon deri të stadiumi “Liman Gegaj”, duke përfshirë këtu edhe disa rrugica të lagjeve që atakohen përgjatë kësaj rruge.
- Gjithashtu, vlen të theksohet se gjatë këtij viti kemi arritur të bëjmë edhe disa rrugë alternative me qëllim të krijimit të sa më shumë mundësive për qarkullimin e automjeteve dhe qytetarëve tanë. Vlen të përmendim rrugën që edhe e kemi asfaltuar nga stacioni i Policisë, mbrapa stacionit të autobusëve për të vazhduar deri të lagja e Mekajve.
- Një tjetër angazhim i yni gjatë këtij viti, ka qenë edhe dhënia e çelësave për 10 familje me kushte të vështira ekonomike, të cilëve ua kemi ndërtuar 10 shtëpi të banimit, në bashkëpunim me organizatën “Qatar Charity”.
- Kur jemi të bashkëpunimet, gjatë kësaj periudhe kam nënshkruar edhe një marrëveshje të bashkëfinancimit me organizatën “Qatar Charity” për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kijevë. Besoj shumë shpejt do të nis edhe ndërtimi i saj.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Kur jemi të shëndetësia, dua të përmend edhe disa angazhime shtesë që i kemi bërë gjatë kësaj periudhe përmes mekanizmave tonë lokal, si;
 - Ndarja e mjekësisë Familjare nga urgjenca, ky hap ka bërë që qytetarët të marrin shërbimin cilësor dhe të shpejt pa e penguar shërbimin e urgjencës.
 - Formimi i ekipes për realizimin e vizitave të nënës dhe fëmijëve deri në moshën 0 - 3 vjeçare, ky ekip ka bërë monitorimin dhe ka dhënë këshilla për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, sipas standardeve të parapara në protokollet e nxjerra nga Ministria.
 - Kemi bërë hapjen e një bunari në oborrin e QKMF-së, dhe ky është realizuar fal donacionit nga shoqata bëmirëse Bereqeti, ku me këtë hap është plotësuar një standard i kërkuar nga inspektorati shëndetësor e që krijohen mundësitë të mbahet higjiena në këtë institucion shëndetësor.
 - Kanë vazhduar vizitat paliative në shtëpi të të gjithë qytetarët në nevojë ku edhe kemi ofruar shërbime shëndetësore duke ju ndihmuar pacientëve në nevojë.
- Po ashtu, kur jemi te donatorët, gjatë vizitës sime në Komunën e Mejrinit në Zvicër, kjo e fundit, na ka dhuruar 5 mjete motorike për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve, duke përfshirë këtu 2 automjete për fshirjen e rrugëve. Gjithashtu, për këto qëllime të ambientit, një mjet motorik për pastrimin e shesheve dhe trotuareve na ka dhuruar edhe biznesmeni nga Malisheva, z, Njazi Bytyqi.
- Kemi inauguruar Shtëpinë e Veteranëve dhe Muzeun e UÇK-së, pranë varrezave të dëshmorëve në Malishevë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Gjatë muajit të festave të verës, kemi pas nderin të kemi mysafirë personalitete nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku Komuna jonë i ka shpallë Qytetar Nderi, tri personalitete të jetës politike dhe publike në Neë York: z. David Carr, Charles D. Fall dhe z. Naser Nika.
- Gjithashtu, kam nënshkruar një MM bashkëfinancimi me FKEE për renovimin e objektit të banimit social 01 në Malishevë.

Po ashtu,

- Kemi vazhduar me subvencionimin e qumështit për 0.3. cent/litër, për të gjithë fermerët që dorëzojnë qumështin në pikat grumbulluese.
- Kemi bërë shpërndarjen e mekanizmit bujqësor nga shpallja publike e vitit paraprak. Kanë përfituar nga kontrata rreth 90 fermerë.
- Kemi bërë subvencionimin e fermerëve me 25% të çmimit të farës së patates dhe qepujkave. Nga ky subvencionim kanë përfituar 11 fermerë.
- Është bërë monitorimi i fushatës së korrje-shirjeve ku gjatë fushatës janë korrur 3000ha me grurë, 202 ha me tërshërë dhe 66 ha ne elb.

Gjithashtu,

- Është bërë organizimi i “Flakës së Janarit” – Për nderë të dëshmorëve Ali Kryeziu dhe Hisni Mazreku. Organizmi i aktiviteteve kulturore, rinore e sportive si dhe nderime të varrezat e dëshmorëve për nder të Përvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Organizimi i aktiviteteve të ndryshme rinore, kulturore e sportive për nder të Epopesë së UÇK-së me 5, 6 dhe 7 mars. Botime



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Librash që e kanë përcjellë gjatë tërë vitit komunën e Malishevës. Organizmi i Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të komunës së Malishevës. Ky aktivitet është përcjellë me organizime të ndryshme kulturore, rinore e sportive. Organizimi i Festivalit “Oda e Llapushës” me 1 dhe 2 gusht. Organizimi i mbrëmjes me etno-grupin TRIX me 3 gusht, si dhe i Festivalit “MALFEST” më 4 gusht. Dhe së fundmi, organizimi i Akademisë Përkujtimore për të gjithë veteranët që nuk jetojnë më.

Gjithashtu,

- Kemi bërë kontrata për shërbime transportuese për nxënësit, të cilët vijojnë mësimet në SHFMU” Dëshmorët e Kombit” në Ngucat, SHFMU” Hasan Prishtina” në Tërpezë, dhe SHFMU” Ismet Jashari” në Temeqinë, nxënësve të lagjes Garaqevë për në SHFMU” Asim Vokshi” në fshatin Panorc, SHFMU” 28 Nëntori” në Kërvasari. Po ashtu, edhe kontrata për bartjen e nxënësve në fshatin Janqist dhe Shkozë.

▪ BASHKËPUNIMET

Për shkak se Komuna e Malishevës, ka një buxhet të limituar krahas nevojave të mëdha që komuna jonë ka për të bërë investime kapitale, bashkëpunimi me institucionet qendrore është i domosdoshëm, mirëpo jo në nivelet e dëshirueshme për shkak të mos gatishmërisë nga ana e institucioneve qendrore.

Në mënyrë që të kërkojmë përkrahje për projekte zhvillimore për komunën tonë, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Malishevës, së bashku me bashkëpunëtorë kemi zhvilluar disa takime me disa nga ministritë që lidhen ngushtë me fushën e projekteve tona.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Duhet theksuar, se deri më tani një bashkëpunim deri diku korrekt kemi pasur me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të cilave ju kemi drejtuar me disa kërkesa për përkrahje të disa nga projekteve tona, të cilat kanë nevojë për më shumë buxhet së sa janë mundësitë tona komunale.

Në mesin e disa kërkesave që na kanë përkrahur për realizimin e projekteve tona komunale janë: Bashkëfinancimi në tribunën e stadiumit, dhe rruga për tek ujëvara e Mirushës e cila ende është në procedura të tenderimit.

Ndërsa, kemi adresuar edhe shumë kërkesa të tjera të cilat akoma nuk po gjejnë përkrahjen nga institucionet qendrore apo më mirë të themi nga qeveria e Kosovës, si p.sh:

- Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës lokale nga fshati Lumishtë deri në fshatin Llapqevë (Mrasor).
- Zgjerimi i rrugës nga Malisheva në drejtim të fshatit Banjë deri në hyrje të autostradës.
- Rregullimi i rrugës nga dalja e autostradës deri në fshatin Duhel
- Renovimi i rrugës Malishevë-Kijevë.
- Faza e dytë e projektit të Parkut Mirusha, etj.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Bashkëpunimi me partnerët dhe donatorët vendorë e ndërkombëtarë

Nevoja për të rritur bashkëpunimin tonë si Komunë me partnerë dhe donatorë, qoftë vendorë apo ndërkombëtarë është e domosdoshme, sepse vetëm duke bashkëpunuar mund të bëjmë punë të mira për qytetarët tanë.

Ndër hapat që kemi ndërmarr në funksion të kësaj janë;

Kam nënshkruar një marrëveshje me **Komunën e Haraqinës** për të konkurruar së bashku në programe të ndryshme ndërkombëtare, me interes për të dy komunat, në kuadër të programeve të Bashkësisë Ndërkombëtare për komunat ndërkufitare.

Kemi vijuar bashkëpunimin me organizatën siç e thash më lartë, **Qatar Charity**, ku me këtë donator, shpresojmë se do të zgjerohemi edhe në projekte tjera që ndërlidhen me shëndetësi, bujqësi, etj. Po ashtu, edhe një MM me **Islamic Relief Kosova**, për përkrahje me pajisje bujqësore.

Kemi vazhduar me takimet e rregullta me qytetarët në baza ditore dhe me diskutimet publike konform legjislacionit në fuqi.

Gjatë vitit 2024, qeverisja jonë komunale është angazhuar përmes secilit sektor, të cilat i kemi të pasqyruara si më poshtë:



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS SIPAS DREJTORIVE

DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCË DHE BUXHET

Gjatë vitit 2024, Drejtoria për Ekonomi, Financë dhe Buxhet ka bërë ofrimin e shërbimeve në mënyrë sa më efikase për drejtoritë tjera si dhe ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë, duke ofruar kryerje të shërbimeve, informacioneve sa më të sakta të të hyrave dhe shpenzimeve.

Në Drejtorinë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet gjatë kësaj periudhe të raportimit kanë operuar këta sektorë:

- Sektori për Buxhet
- Sektori i Tatimit në Pronë
- Sektori për Financa
- Sektori i Thesarit,
- Sektori i regjistrimit të Biznesit dhe të Hyrave
- Sektori për shpenzime dhe kontabilitet

Sektori për Buxhet

Një nga sektorët më të rëndësishëm të organizatës buxhetore është sektori i buxhetit, që kryesisht merret me hartimin dhe planifikimin e buxhetit për të gjitha kategoritë, si: Pagat dhe mëditjet, Mallrat dhe shërbimet, Investimet kapitale, Shërbimet komunale, si dhe Subvencionet dhe transferet.

Sektori i buxhetit pas pranimi të Qarkorës së parë buxhetore fillon përgatitjen e kornizës afatmesme buxhetore (KAB), harton apo nxjerrë Qarkoren interne të Organizatës buxhetore, njofton të gjitha njësitë kërkuese dhe ju dërgon Qarkoren interne, kërkon nga njësitë kërkuese kërkesat për vitin vijues, më pas, pas pranimi të kërkesave përgatit KAB dhe e përcjell për KPF dhe me rekomandim te KPF-së e kalon në Kuvend Komunal për aprovim. Pas aprovimit në Kuvend dërgohet në Ministrinë e Financave sipas afatit kohor



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Pas marrjes së Qarkores së dytë buxhetore përgatitet draft buxheti final për tri vitet e ardhshme, më theks te veçantë për vitin në vijim dhe gjatë përgatitjes së buxhetit njëkohësisht përgatitën edhe PIP-at për projektet kapitale
Pas përgatitjes nga buxheti dërgohet në KPF dhe me rekomandim shkon në Kuvend për miratim
Pas miratimit në Kuvend sipas afatit ligjor dorëzohet në MEF
Në momentin e aprovimit të buxhetit në nivel qendrorë sektori i buxhetit përgatit planin e keshit, zotimit, shpenzimit sipas kategorive ekonomike të Organizatës buxhetore përmes sistemit në Fre Balance

Sektori i tatimit në pronë

Ky sektor ka vazhduar të bëjë grumbullimin e tatimit në pronë, verifikimin e pronave të regjistruara, vjeljen e detyruar, plotësimin e të dhënave personale të tatim paguesve, shqyrtimin e ankesave-kërkesave të tatim paguesve etj.

- Mban evidencën e të hyrave nga tatimi në pronat e paluajtshme;
- Bënë identifikimin, klasifikimin dhe vlerësimin e pronës së paluajtshme;
- Përgatit faturimin për tatim në pronë për të gjitha pronat e paluajtshme
- Angazhohet dhe përcjell shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë;
- Zhvillon vjeljen e detyruar sipas procedurave;
- Regjistrimi i pronave të reja dhe tatimpaguesve;
- Verifikimi i pronave të regjistruara dhe tatimpaguesve;
- Futja e të dhënave në sistem të tatimit në pronë;
- Kontrollimi dhe mbikëqyrja e të hyrave dhe të dalurave dhe miratimin e tyre sipas fondit, kodit dhe kategorive ekonomike.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Planifikon, raporton dhe mban evidencën e të hyrave vetanake për të gjitha drejtoritë
- Pranimi i faturave
- Procedurat dhe shpenzimet e mjeteve buxhetore
- Alokimet-Plani i zotimit dhe plani i shpenzimeve (plani i keshit)
- Zotimet
- Raportimi i shpenzimeve të realizuara sipas drejtorive

Sektori i tatimit në pronë

- Mban evidencën e të hyrave nga tatimi në pronat e paluajtshme;
- Bën identifikimin, klasifikimin dhe vlerësimin e pronës së paluajtshme;
- Përgatit faturimin për tatim në pronë për të gjitha pronat e paluajtshme
- Angazhohet dhe përcjell shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë;
- Zhvillon vjeljen e detyruar sipas procedurave;
- Regjistrimi i pronave të reja dhe i tatimpaguesve;
- Verifikimi i pronave të regjistruara dhe i tatimpaguesve;
- Futja e të dhënave në sistem e tatimit në pronë;



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Shqyrtimi i ankesave të tatimit në pronë
- Shqyrtimi i kërkesave të tatimpaguesve;
- Bashkëpunon me Departamentin e Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave;
- Lëshon certifikata-vërtetim për kryerjen e obligimeve të tatimit në pronë, sipas kërkesës së palëve;

Sektori për Financa

Regjistrimi i të hyrave vetanake të mbledhura për përu dhën Janar-Dhjetor 2024 kap shumën në vlerë prej: **2,692,724.5 €** •

Procedimi i pagesave prej zotimit-përpunimit-shpenzimit të mjeteve për periudhën Janar-Dhjetor 2024 në shumë prej **22,029,503.07 €**

- Menaxhimi dhe raportimi i buxhetit;
- Menaxhimi i arkës, janë grumbulluar për vitin 2024 në vlerë prej: **65,358.20 €**
- Raporti mujor nga drejtoria e financave për ZKA-Zyra e Kryetarit.

Sektori i tatimit në pronë

Në Sektorin e Tatimit në Pronë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 janë kryer këto aktivitete;

- Janë realizuar të hyrat nga tatimi në pronë në shumë prej **747,110.92 €**
- Janë realizuar të hyra nga taksa për automjete motorike në shumë prej **122,711.00 €**.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Sektori i Thesarit

- Buxheti i alokuar për periudhën Janar-Dhjetor 2024 kap shumën prej **22,029,503 €**
- Ndërsa sipas shënimeve nga librat e thesarit, shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar për periudhën Janar-Dhjetor 2024 është në vlerë prej **21,639,360.42€**.
- Llogaritur në përqindje shpenzimi i tërësishëm i buxhetit për periudhën Janar- Dhjetor është **99.00%**

Sektori i regjistrimit të biznesit dhe të hyrave

- Në sektorin e regjistrimit të buxhetit në periudhën Janar -Dhjetor 2024 është përpiluar dhe miratuar Rregullorja për Taksa Komunale dhe bazuar në rregullore ky sektor ka nxjerr **1627** Aktvendime mbi caktimin e Tarifës për Taksapagues,
- Ngarkesa e caktuar nga këto akte të veçanta juridike arrin shumën e planifikuar prej **257,275.00€**
- Regjistrimi i pagesave të kryera nga subjektet afariste për periudhën Janar- Dhjetor 2024 arrin shumën **19,605.00€**
- Gjatë periudhës Janar -Dhjetor 2024, Zyra për Biznes ka kryer gjithsejtë **656** lëndë, prej tyre;
- **206** regjistrime të reja të biznesit
- **91** ndryshime në biznes
- **42** ndërrime të certifikatave të biznesit
- **211** nxjerrje të informatave të bizneseve
- **24** shuarje biznesi
- **82** vërtetime biznesi



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

• Plani i realizimit të të hyrave vetanake për periudhën Janar-Dhjetor 2024 është në shumë prej **1,763,807.70€** të cilat të hyra janë faturuar në sistem dhe janë alokuar për shpenzim, kurse të hyrat të cilat arkëtohen nga gjobat e trafikut dhe nga gjobat e gjykatave kapin shumën prej **474,544.34€**.

Pra të hyrat e përgjithshme vetanake për periudhën Janar-Dhjetor kapin shumën prej **2,238,352.04€**

Sipas shënimeve aktuale në këtë periudhë Janar -Dhjetor 2024 përqindja e të hyrave vetanake në krahasim me planifikimin e të hyrave kemi një tejkalim për **244 %**.

DREJTORIA E URBANIZIMIT

Drejtoria e Urbanizmit, duke u mbështetur në fushëveprimtarin e vet dhe planin e punës për vitin 2024, angazhimet e veta i ka fokusuar në realizimin e projekteve kapitale nga viti 2023 (vazhdimin e projekteve dyvjeçare) dhe përgatitjen e materialeve paramasave, projekteve dhe parallogarive për projektet e vitit 2024 në lëmin e infrastrukturën publike.

Për vitin 2024 janë planifikuar projekte të infrastrukturës publike si Ndërtimi i sheshit dhe parkingut nëntokësorë në Malishevë dhe infrastrukturës tjetër përcjellesë nën dhe mbitokësore, ku deri tani ka përfunduar 70 % punimeve, ndërtimi-asfaltimi i rrugëve lokale, ndërtimi vazhdimi i trotuareve në Qytezë dhe në fshatra, ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza, renovimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, renovimi objekteve të shkollave fillore dhe të mesme, ndriçimi publik, investimet në shëndetësi arsim, sport, kulturë dhe mirëmbajtja e kanalizimeve të ujërave të zeza nëpër fshatra dhe Qytezë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Projektet e infrastrukturës publike të realizuara dhe në realizim në vitin 2024

- Vazhdim ndërtimi-asfaltimi i rrugë lokale në fshatrat; Astrazup l= 850 m, Kravasari l=875 m, Lladrovc l= 200 m, Burim l= 500, Gurbardhë l= 600 m, Guriq l= 700 m, Gajrak l=640 m, Dragobil l= 400 m **gjithesëjtë; 4.7 km** dhe mirëmbajtja e tyre nëpër fshatra dhe Qytezë (projekte dy vjeqare).
- Ndërtimi i sheshit dhe parkingut nëntoksorë në Malishevë dhe infrastrukturës tjetër përcjellesë nën dhe mbitokësore, ku deri tani ka përfunduar 70% punimeve.
- Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në fshatin Turjakë është në përfundim.
- Ndërtimi dhe renovimi i kanalizimeve nëpër fshatra të komunës ku si projekt dyvjeçar ka filluar intervenimin në këto fshatra; L= 2000 m.
- Renovimi i kolektorit kryesorë të ujrave të zeza (faza e parë) fshatrat Bubël-Lumnishtë në gjatësi prej 2.5 km ku ka filluar të punohet.
- Ndërtimi i tri fusha sportive në fshatrat; Guriq, Berishë dhe Stapanicë
- Ndriçimi publik renovimi i tyre nëpër fshatrat e Komunës dhe Qyteza, 80 km.
- Renovimi i objektit shkollor në fshata dhe Qytezë ku shumica e objekteve shkollore janë përfunduar dhe një pjese e mbetur pritet të përfundojnë.
- Punimet në stadiumin e Qytetit “Liman Gegaj “ në Malishevë ku ka përfunduar punimet dhe është funksional.
- Ndërtimi i rrugës “Habib Berisha” deri te stadiumi dhe rregullimi i palestrës sportive ku punimet kanë përfunduar deri në shtrirjen e fazës së parë të asfaltit L = 1.2 km’, trotualet L= 5 km’, kanalizimi fekal L= 1.6 km’, kanalizimi atmosferik L= 1.6 km’, shtegu për biçikleta L= 1.2 km dhe trupa ndriques 90 copë veq kanë përfunduar.
- Mirëmbajtja verore -dimërore e rrugëve urbane dhe lokale gjatë vitit 2024 është duke vazhduar ku për këtë vit janë realizuar punuar diku 94 km mirmbajtje verore (asfaltim, pastrim kanalesh dhe pune tjera) dhe mirmbajtja dimrore në pastrimin e rrugëve lokale dhe Qytezës nga dëbora në gjatësi 142 km.
- Ndërtimi i fazës së parë te parku Mirusha, ku ka përfunduar.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Ndërtimi i rrugës tek Ujvaret e Mirushes në fshatin Llapqevë, projekt i financuar nga Ministria e Infrastrukturës është në fazën e nënshkrimit të kontratës
 - Ndërtimi i dy anave të Lumit Mirusha në Qytezë, projekt i financuar nga grani i performances (DEMOS -i, MAPL-ja dhe Komuna) ku është duke u punuar.
 - Rregullimi i rrethë rrotullimit dhe rrethoja e lapidarit në fshatin Pagarushë projekt i financuar nga Ministria dhe Kuvendi Komunal në vlerë prej 74,000 euro dhe ndërtimi i lapidarit në fshatin Llazicë.
- Dalja në terën dhe përgatitja e paramasave për ndërtimin asfaltimin e rrugëve lokale në fshatrat; Ngucat, Kravasari, Llapqevë, Mirushë, Turjakë, Astrazup, Rudë, Panorc, Pagarushë, Terpezë e Ulët, Shkarashnik, Lumnishtë, Banjë, Gajrak, Gurishtë, Burim, Dragobil, Lladrovc, Carrallukë dhe Gurbardhë, si dhe renovimin e rrugëve lokale Drenovc-Vermicë, Carrallukë-Shkarashnik, Bellanicë-Ngucat, Dragobil-Pagarushë dhe Lumnishtë-Turjakë. Projekt që po vazhdojnë të realizohen, mirmbajtja e rrugëve lokale nëpër fshatra dhe Qytezë. Vlen të ceket edhe përgatitja e paramasave dhe projektit të asfaltimi të rrugës tek Ujvaret e Mirushes në fshatin Llapqevë në gjatësi prej 3 km dhe projekti ndërtimi i lumit Mirusha në Qytezë i financuar nga Ministria dhe Komuna ku deri me tani është duke u punuar me ritëm të lartë.
- Dalja në terën dhe përgatitja për fillimin e punimeve të renovimit të kanalizimit të ujërave të zeza të kolektorit kryesor (faza e parë) fshati Bubël-Lumnishtë ku punimet janë duke vazhduar si dhe rregullimi kanalizimit të liqeni në fshatin Mirushë ku deri tani është përfunduar një pjesë dhe pritet të vazhdohet në ditët në vijim dhe planifikimi i rregullimit të kanalizimit në fshatrat; Bubaveç, Kijevë, Drenovc, Banjë dhe lagjen Mirditë në Malishevë si dhe mirmbajtja e kanalizimeve nëpër fshatra ku deri tani janë realizuar diku 12 kilometre, ky projekt është dy vjeçarë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Dalja në terën dhe përgatitja e paramasave dhe parallogarive për punimin e ndriçimit publik dhe mirmbajtjen në fshatrat dhe Qytezë ku është mëndur të jetë projekt tre vjeçar për mirmbajtje ku ka filluar implemtimi i tijë në disa fshatra dhe është duke u realizuar ku deri tani janë realizuar diku 15 km kabell të shtrirë dhe ndërimi i poqave elektrik.
- Gjatë kësaj periudhe një pjesë e stafit është marrë me përgatitjen e materialit të Planit Zhvillimor Komunal (2017-2025) ku si projekt për hartat zonale ku deri më tani janë mbajtur disa takime dhe janë shtjelluar shumë tema me interes për territorin e Komunes sonë është duke vazhduar që brenda këtij viti të konkretizohet si projekt ku është duke u financuar nga Kuvendi Komunal.

Gjatë kësaj periedhe kemi pasur edhe takime pune me Ministrinë e Planifikimit rreth procedurave për finalizimin e hartës zonale për komunën ku është kontraktur përfunimi i hartave zonale për tërë territorin.

- Dalja në teren dhe përgatitja dhe vazhdimi i ndërtimit të zhveshtoreve dhe tribunave në stadiumin e qytetit ku është duke u punuar ku deri tani kanë përfunduar shumica e punëve janë në finalizim e sipër. Kemi përgatitur paramasën edhe për pjesën tjetër të zgjerimit të tribunave dhe terrenit ndihmës të fushave sportive. Si dhe fillimi i punimeve të fushave sportive në fshatrat Berishë, Stapanicë.
- Një pjesë e stafit është marrë me përgatitjen e materialeve aplikacioneve për konkurrim në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për projektin mirëmbajtja e rrugës lokale Lumnishtë-Llapqevë, projekti tjetër ka qenë konkurrimi në Ministrinë e Zhvillimit rajonale rreth projektit të ndërtimit të çerdhës së fëmijëve në fshatin Bellanicë. Aktivitet tjetër është konkurrimi në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal me projektin rregullimi i parkut tek liqeni Mirusha ku edhe është fituar dhe kanë



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

filluar punimet në realizimin e parkut Mirusha projek i financuar nga Ministria dhe Komuna dhe kohëve të fundit thirrja prezantimi i disa projekteve infrastrukturore në takimin rajonal në Prizren.

- Si drejtori kemi marrë pjesë në komisione për pranimin teknik vlersime të projekteve të ndryshme në projekte kapitale.
- Po vazhdon realizimi i projektit **“Ndërtimin e Sheshit së bashku me parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës”** i cili konsiderohet si projekti më i madh i realizuar në komunën e Malishevës , ku është duke u punuar me tempo të lartë në gjurmimin e parkut për ndërtim të parkingut dhe pregaditjen për përfundim të ures së madhe dhe lëshurja për qarkullim.
- Është duke u punuar në rrugën që lidhet nga shkolla profesionale Qendra e Kompetencës rruga “Habib Berisha” që kalon ka restorant Princesha Palace që lidhet me rrugë e unazës së qytetit deri të stadiumi i qytetit “Liman Gegaj”, ku deri tani kanë përfunduar punimet e asfaltimit të fazes së parë në gjatësi prej 1.2 km, ndërtimi i trotuarve në të dy anet e rruges në gjatësi prej 5.1 km, kanalizimi fekal dhe atmosferik në gjatësi prej 3.3 km, shtegu për biçikleta në gjatësi prej 1.2 km dhe punimi i 90 trupave ndriquese për gjatë rruges.
- Ndërtimi e rrethë rrotullimit dhe rrethojës së lapidarit të “Nexhmije Pagarusha” në fshatin Pagarushë projekt i financuar nga Ministria dhe Kuvendi Komunal në vlerë prej 74,000 euro ku deri tani veq ka përfunduar rrethë 90% të punimeve, ndërsa projekti i lapidarit në fshatin Llazicë ende nuk ka filluar të punohet.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Në Drejtorinë e Urbanizmit gjatë periudhës Janar- Dhjetor janë parashtruar gjithsejtë 337 kërkesa, ku 181 kërkesa janë realizuar (leje ndërtimore, kushte urbanistike, vërtetime, pëlqime, leje përdorimi, leje mjedisore dhe raporte teknike) dhe 156 kërkesa janë në shqyrtim. Të hyrat finaciare në drejtori gjatë kësaj periudhe janë në vlerë prej 571,710.91 €.

DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM

Bazuar në realizimin e punës së Drejtorisë për Arsim dhe Edukim deklarojmë që gjatë kësaj periudhe ka pasur aktivitete të shumta të cilat janë bazuar në planin e veprimit të DKA-ës për vitin 2024.

Për të realizuar punët në procesin edukativo arsimor DKA-ja ka zhvilluar një varg konkurses, të cilat janë bazuar në legjislacionin në fuqi përfshirë rekrutimin e personelit arsimor mësimdhënës dhe teknik. DKA-ja ka bashkëpunuar ngushtë me Institucionet kompetente për të shpallë dhe realizuar konkurset për personelin arsimor, mësimdhënës dhe administrativ.

Në drejtim të arritjeve të avancimit të pozitës së personelit arsimor, gjithashtu kemi bashkëpunuar ngushtë me MASHT-in dhe SBASHK-un e donator të tjerë në realizimin e pakove trajnuese për mësimdhënësit. Këtu përfshihen angazhime në fushën e kurrikulës, dhe programeve të trajnimit të organizuara nga SBASHK-u, të cilat janë mbajtur nëpër shkolla në koordinim me nevojat e personelit arsimor sindikalist. Po ashtu kemi bashkëpunuar me CARITAS-in në avancimin në realizimin e projekteve, të cilat janë zbatuar në tri shkollat e mesme të larta, përfshirë QK'' Kujtim Krasniqi'', Gjimnazin '' Hamdi Berisha'' dhe IAAP'' Lasgush Poradeci''.

Duke ditur që nevoja për ngritje të kapaciteteve arsimore për burimet njerëzore shumë herë ka qenë pjesë e programeve online në fushën e kurrikulës, dhe metodologjisë arsimore duke bashkëpunuar ngushtë me shumë donatorë dhe MASHT-in në realizimin e programeve të ndryshme dedikuar personelit arsimor. Po ashtu në këtë drejtim janë realizuar bashkëpunime të shumta, Zyrën për vlerësime dhe trajnime në MASHT.

Këtu duhet veçuar bashkëpunimin që kemi pasur me SIA në Gjakovë në shqyrtimin e shumë kërkesave nga personeli arsimor dhe gjithashtu shqyrtimin e licencave. Në kuadër të bashkëpunimit për qasje në programet vlerësuese ndërkombëtare dhe kombëtare,



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

shumë mësimdhënëses janë angazhuar në programin e vlerësimit PISA duke u njoftuar me mënyrën e realizimit të këtij testi ndërkombëtar, i cili është me rendësi edhe për sistemin tonë arsimor. E gjithashtu angazhime në realizimin e testeve të tjera si TIMS-PIRLS.

Për të përkrahur të rinjtë dhe studentët DKA-ja ka lejuar edhe realizimin e shumë hulumtime të studentëve të drejtimeve të ndryshme arsimore që kanë realizuar praktikën profesionale në shkollat tona. Po ashtu është mbajtur edhe testi i maturës shtetërore për afatin e parë dhe të dytë, ku kalueshmëria është rreth 53.29 % e nxënësve në të dy afatet.

Kontratat në përkrahje të institucioneve arsimore:

Për të realizuar kushte më të mira të punës në procesin edukativo- arsimor janë realizuar edhe këto punë dhe aktivitete:

- Furnizimi me material teknik;
- Furnizimi me tonerë dhe letër për institucionet arsimore nga AQP-ja;
- Furnizimi me gravura dhe mirënjohje për nevojat e personelit arsimor pensionist;
- Realizimi i kontratës për mjete të zërimit për nevojat e aktiviteteve shkollore;
- Furnizimi me derivate për nevojat e shkollave me rastin e reduktimeve të energjisë elektrike;
- Kryerja e Shërbimeve të Internetit për Institucionet Arsimore;
- Furnizim me ushqim dhe pije për Çerdhen'' Zërat e Ëmbël'' në Malishevë;
- Kontrata shërbime transportuese për nxënësit, të cilët vijojnë mësimet në SHFMU'' Dëshmorët e Kombit'' në Ngucat, SHFMU'' Hasan Prishtina'' në Tërpezë, dhe SHFMU'' Ismet Jashari'' në Temeqinë, nxënësve të lagjes Garaqevë për në SHFMU'' Asim Vokshi'' në fshatin Panorc, SHFMU'' 28 Nëntori'' në Kërvasari dhe kontrata për transportin e nxënësve të fshatit Janqist dhe Shkozë për në SHFMU'' Salih Bytyçi''.
- Furnizim me lëndë djegëse dru dhe pelet për institucionet arsimore.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Realizimi i disa punëve në evitimin e defekteve në infrastrukturën shkollore përfshirë rrjetin e kanalizimit, energjisë elektrike, nyjeve sanitare dhe punë të natyrës renovuese.
- Furnizimi i Çerdhës me material didatik.
- Kontrata për mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore në institucionet arsimore-dyvjëçare
- Kontrata për renovimin e shkollave, kontratë dyvjëçare.

Aktivitetet të tjera:

DKA gjithashtu gjatë vitit 2024, ka realizuar edhe një varg aktivitete të tjera, të cilat kanë të bëjnë me:

- Realizimi i aktiviteteve për nder të Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve;
- Realizimi i aktiviteteve për nder të Ditëve të Shkollave;
- Realizimi i testeve provuese për testin e arritshmërisë për nxënësit e klasave të Nënta dhe të testeve provuese për Testin e Maturës shtetërore;
- Realizimi i testeve -Testit PISA, TIMS, Testit të Arritshmërisë dhe Testit të Maturës për dy afatet;
- Pjesëmarrja në garat shkollore sportive në Futboll, Volejbol, Atletikë, etj.
- Pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme organizuar për Nxënësit me Nevoja të Veçanta;
- Pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme organizuar për Edukatorët;
- Organizimi i takimeve me KFOR- LMT në Malishevë për të realizuar projekte të ndryshme në dobi të institucioneve arsimore.
- Vizita nëpër shkolla për nder të Ditëve të Shkollave;
- Pjesëmarrja në vizita monitoruese për institucionet arsimore;
- Bashkëpunimi me SIA në Gjakovë, MASHT-in e institucionet tjera e locale qendore;
- Takime me palë të ndryshme të nivelit lokal dhe qendror për mbarëvajtjen e arsimit;
- Përgatitjet për furnizim me tekste të reja shkollore.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Drejtoria për Arsim dhe Edukim ka realizuar edhe aktivitete të tjera si në:

- Realizimin e dhjetëra vizitave me karakter pune nëpër institucionet arsimore në komunë;
- Shqyrtimi i qindra kërkesave dhe ankesave të palëve të ndryshme;
- Pjesëmarrjen në shumë takime në nivel lokal dhe qendror për tematikat e ndryshme arsimore, përfshirë fushën kurrikulare, integrimin e nxënësve me nevojat të veçanta;
- Përgatitja e raporteve për Asamblenë Komunale;
- Realizimi i vizitave me karakter pune nëpër institucionet arsimore;
- Pjesëmarrje në takimet shkollore me rastin e njohjes së kontributit për mësimdhënësit pensionist;
- Përgatitja e raporteve për programin e performancës;
- Realizimi i testit Pisa, Testit TIMSS, Testit të Arritshmërisë dhe Testit të Maturës shtetërore. etj.;
- Mbajtja e takimeve me Aktivin e Drejtorëve;
- Organizimi i garave me karakter garues sportivë në mes shkollave;
- Përkrahja e aksioneve për pastrim të objekteve shkollore;
- Shqyrtimi i fillimit të projekteve për investimet kapitale në shkolla sipas Buxhetit të vitit 2024 në koordinim me drejtorinë e urbanizmit.
-

Aktivitetet e realizuara sipas planit të veprimit të DKAE-së

Muaji Janar:

- ✓ Monitorimi i fillimit të gjysmë vjetorit të II-të;
- ✓ Dorëzimi i raporteve të punës për nevojat e DKA-ës/ Zyrën e Informimit si dhe përfundimi i formularëve për nevojat e DKAs;



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- ✓ Përgatitja e Cash Floë (Rrjedhës së parasë) bazuar në buxhetin e aprovuar të vitit 2024;
- ✓ Planifikimi i mbajtjes së takimeve për kurrikulë: përgatitja e dosjeve të mësimdhënësve;
- ✓ Mbajtja e takimit në mes EPVP;
- ✓ Paraqitja e kërkesave pranë zyrës së kryetarit për të realizuar fillimin e PPP dhe plotësimin e nevojave përmes përkrahjes financiare bazuar në buxhet
- ✓ Realizimi i takimeve me MASHT-të dhe donatorë tjerë
- ✓ Mbajtja e takimit në mes EPVP
- ✓ Vizitë institucioneve arsimore.
- ✓ Vizitë organizatave të Shoqërisë civile.
- ✓ Pjesëmarrja në aktivitete shkollore me rastin e flakës së janarit
- ✓ Monitorimi i statistikave shkollore, plan programeve dhe fillimit të funksionimit të aktiveve profesionale

Muaji shkurt:

- ✓ Vazhdimi i përgatitjeve nëpër shkolla për kremtimin e Ditës së Pavarësisë duke u angazhuar në aktivitete shkollorë, gara mësimore, kuize diturie, orë letrare, koncerte muzikore.
- ✓ Realizimi i zotimeve për disa kërkesa të kategorisë për mallra dhe shërbime
- ✓ Fillimi i përgatitjeve për shënimin e Ditës së Mësuesit dhe monitorimi i procesit edukativo arsimor
- ✓ Evidentimi i të gjitha aktiviteteve me bazë shkollore si dhe regjistrimi i të gjithë nxënësve, të cilët do të marrin pjesë në gara të karakterit komunal për nder të Ditës së Mësuesit dhe të Ditës së Nënës
- ✓ Identifikimi përmes aktiveve profesionale për nxënësit të cilët do të iu nënshtrohen garave të karakterit komunal, dhe kombëtar.
- ✓ Mbajtja e takimit në mes EPVP
- ✓ Identifikimi i nevojave të komunitetit shkollor në fushën e NVM



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- ✓ Identifikimi përmes aktiveve profesionale për nxënësit të cilët do të iu nënshtrohen garave të karakterit komunal, dhe kombëtar;
- ✓ Vlerësimi i procesit edukativo arsimor në fushën e cilësisë në shkolla përmes vizitave dhe identifikimeve të vlerësimeve të brendshme të shkollave
- ✓ Vlerësim i shkurtër rreth ecurisë së deritanishme në Institucionet Arsimore, DKA dhe bashkëpunimi me institucionet relevante

Muaji Mars:

- ✓ Shënimi i Ditës së Mësuesit;
- ✓ Vizitë pune nëpër të gjitha shkollat e komunës sonë;
- ✓ Takim me Këshillin e Drejtorëve mësimdhënës dhe me Veteranë të Arsimit;
- ✓ Fushata e vetëdijesimit për parandalimin e etheve hemorragjike;
- ✓ Mbajtja e takimit mujor në nivel të DKA-ës në nivel të Kuadrit të DKA-ës/ Koordinatorët e cilësisë dhe kurrikullës/ nivel të ekspertëve dhe bashkëpunorëve profesional/ të shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në shkolla;
- ✓ Vlerësimi i përfundimit të kërkesave për tremujorin e parë të shkollave;
- ✓ Vizitë pune në disa shkolla të komunës sonë qasja e pjesëmarrjes së NMV-ve në aktivitetet shkollore;
- ✓ Realizimi i zotimeve për shpenzimet kapitale për vitin 2024 dhe përgatitje e raportit shpenzues për të gjitha kategoritë e shpenzimeve

Muaji Prill:

- ✓ Kërkesa për regjistrim në klasën e parë;
- ✓ Kërkesa për numrin e teksteve shkollore, të cilat nevojiten për vitin shkollor 2024-2025;
- ✓ Kërkesa për regjistrim në klasat e dhjeta në arsimin e mesëm të lartë;



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- ✓ Takime me ZRA, MASHT, Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies sociale si dhe Organizata tjera, të cilat punojnë në fushën e arsimit dhe edukimit;
- ✓ Realizimi i aktiviteteve mjedisore në shkolla;
- ✓ Mbajtja e takimit mujor në nivel të DKA-ës dhe të aktivitetit të drejtorëve e koordinatorëve të shkollave;
- ✓ Organizimi dhe mbajtja e aktiviteteve garuese në nivel të shkollave dhe pjesëmarrja e shkollave në organizime rajonale e kombëtare të karakterit shkollor;
- ✓ Mbajtja e takimit mujor në nivel të DKA-ës;
- ✓ Takime me ZRA, MASHT, Drejtorinë e Punës dhe të Mirëqenies sociale si dhe Organizata tjera, të cilat punojnë në fushën e arsimit dhe të edukimit për FNV.

Muaji Maj:

- ✓ Pjesëmarrje në Shënimin e aktiviteteve për Ditën e Evropës;
- ✓ Përgatitja e kërkesave për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2025;
- ✓ Regjistrimi i fëmijëve në Çerdhe;
- ✓ Regjistrimi i fëmijëve në klasën para fillor në kuadër të shkollave fillore;
- ✓ Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë të arsimit fillor;
- ✓ Riprovimet për maturantë;
- ✓ Rezultati i riprovimeve për maturantë;
- ✓ Provimi përfundimtar në shkollat profesionale;
- ✓ Rezultati nga provimet përfundimtar në shkollat profesionale;
- ✓ Paraqitja e Provimit të Maturës Shtetërore
- ✓ Dorëzimi i shënimeve përfundimtare për listën e nxënësve dhe Qendrave të testimit për maturantë
- ✓ Konsultimet me shkollat për buxhetin për vitin 2025;



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- ✓ Sensibilizim i opinionit për regjistrimin e FNV në institucione arsimore;
- ✓ Pjesëmarrje në Shënimin e aktiviteteve për Ditën e Evropës;
- ✓ Realizimi i pjesëmarrjes në vizita shkollore të karakterit festiv, mësimor dhe inspektues;
- ✓ Mbajtja e takimit mujor të DKA-ës.

Muaji Qershor:

- ✓ Fushatë vetëdijesimi për përfshirjen më të madhe të fëmijëve në edukimin parashkollor;
- ✓ Ankesat e nxënësve;
- ✓ Publikimi i rezultateve të ankesave;
- ✓ Përfundimi i vitit mësimor për klasat: e 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe 12-ta;
- ✓ Lista përfundimtare e administrueseve dhe qendrat e testimit;
- ✓ Faza përgatitore për riprovime për klasat: e 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe 12-ta;
- ✓ Riprovime për klasat: e 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe 12-ta;
- ✓ Rezultati nga riprovimet e klasave të 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe 12-ta;
- ✓ Mbarimi i mësimit klasa 1-8-të dhe para fillorët;
- ✓ Faza përgatitore për riprovime për klasat: e 6-ta, 8-ta;
- ✓ Riprovime për klasat: e 7-ta, 8-ta;
- ✓ Komunikimi i suksesit klasat nga 1-5-të;
- ✓ Dorëzimi i kërkesave për tekste shkollore;
- ✓ Dorëzimi i tabelarit të suksesit të nxënësve për të gjitha nivelet e arsimit
- ✓ Përgatitja e procedurave për furnizim me lëndë të parë për ngrohje me dru, pelet, derivate dhe antifriz;



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- ✓ Vlerësimi i zbatimit të tremujorit të dytë të kërkesave nga shkollat si dhe hartimi raportit të punës për gjashtëmujorin e parë janar – qershor 2023.
- ✓ Regjistrimi i nxënësve për drejtimet e reja në IAAP” Lasgush Poradeci” në Kijevë, si; Bashkëpunor profesional i infermierisë, Teknik i Sistemeve të TIK; Zhvillues i aplikacioneve softuerike; Asistent Restoranti

Muaji Korrik

- ✓ Publikimi i rezultateve të testit të arritshmërisë së klasat e 9-të.
- ✓ Shqyrtimi i ankesave të rezultateve të testit të arritshmërisë
- ✓ Publikimi i rezultateve të ankesave
- ✓ Komunikimi i suksesit për klasat 6-8 -ta
- ✓ Shpallja e konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, gjimnaze dhe shkolla profesionale
- ✓ Dorëzimi i dokumenteve për regjistrim në klasa e 10-të gjimnaze dhe shkolla profesionale
- ✓ Shpallja e listës së nxënësve të regjistruar në klasën e 10 -të, gjimnaze dhe shkolla profesionale
- ✓ Shpallja e konkursit për mësimdhënës, viti shkollor 2023-2024
- ✓ Përgatitja e statistikave të gjysmë vjetorit të dytë dhe dërgimi në MASHT
- ✓ Realizimi i takimit mujor në nivel të DKA-ës / Drejtorëve të shkollave dhe koordinatorëve të cilësisë

Muaji Gusht

- ✓ Riprovimet për klasat e 6-12-ta.
- ✓ Përgatitjet për shpërndarjen e teksteve.
- ✓ Rezultati nga riprovimet 6-12-ta.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- ✓ Paraqitja e provimit të Maturës Shtetërore.
- ✓ Realizimi i shpërndarjes së librave falas nga MASHT-i.
- ✓ Përzgjedhja e kompanive për bartjen e transportit të nxënësve për vitin shkollor.
- ✓ Konkursi plotësues për klasat e 10-ta, gjimnaze dhe shkolla profesionale.
- ✓ Dorëzimi i dokumenteve për regjistrim në klasat 10-të gjimnaze dhe shkolla profesionale.
- ✓ Shpallja e listës së nxënësve të regjistruar në klasën e 10 -të, gjimnaze dhe shkolla profesionale
- ✓ Pranimi i kuadrit mësimor për vitin shkollor 2024-2025.
- ✓ Përgatitja e objekteve shkollore.
- ✓ Furnizimi i shkollave me material për zyrë, sportiv, pedagogjik etj.
- ✓ Furnizimi i nxënësve me tekste shkollore
- ✓ Takime me shkollat e mesme të larta për organizimin e ekskursioneve shkollore për Maturantët
- ✓ Angazhimi për të planifikuar hartimin e buxhetit për vitin 2025
- ✓ Mbajtja e takimit mujor në nivel të DKA-ës

Muaji Shtator:

- ✓ Fillimi i vitit shkollor 2024-2025.
- ✓ Inspektimi i fillimit të procesit me pjesëmarrjen edhe të kryetarit të komunës
- ✓ Shpërndarja e kalendarit shkollor dhe e orarit mësimor të shkollave- komunitetit të prindërve
- ✓ Monitorimi i procesit të shpërndarjes së teksteve mësimore.
- ✓ Provimi i Maturës Shtetërore –dita e dytë
- ✓ Publikimi i rezultateve të testit të maturës
- ✓ Hulumtimi i rasteve të braktisjes së shkollimit



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- ✓ Takime me Këshillin e Prindërve
- ✓ Plotësimi i librave të klasës me të dhënat e kërkuara për lëndët dhe tekstet mësimore dhe monitorimi i përfshirjes së të dhënave në sistemin e SMIA
- ✓ Monitorimi i ekskursioneve shkollore të maturantëve.
- ✓ Vlerësimi i kërkesave të shqyrtuara për tremujorin e tretë dhe plotësimi i nevojave dhe vlerësimi përfundimtar i të dhënave në buxhetin e shkollave për delegim në asamblenë komunale

Muaji Tetor:

- ✓ Realizimi i vizitave në shkolla
- ✓ Mbledhja e të gjitha të dhënave për aktivet profesionale, grupet mësimore, organet e tjera shkollore
- ✓ Organizimi i garave ndërshkollore në shkollat fqinjësore duke realizuar edhe ekskursione shkollore
- ✓ Organizimi i takimit në nivel të DKA-ës me Grupet Profesionale/ Drejtorët e Shkollave/ Përfaqësuesit e Prindërve/ SIA- Gjakovë / Koordinatorët e cilësisë
- ✓ Organizimi i takimit në nivel të DKA-ës me Grupet Profesionale/ Drejtorët e Shkollave/ Përfaqësuesit e Prindërve/ SIA- Gjakovë / Koordinatorët e cilësisë dhe EPVP
- ✓ Realizimi i vizitave inspektuese në shkolla
- ✓ Furnizimi me lëndë djegëse dru dhe pelet e me derivate për institucionet arsimore.

Muaji Nëntor:

- ✓ Përgatitjet për shënimin e festave të nëntorit. Organizimi i aktiviteteve me karakter garues, mësimorë, dhe kulturor me pjesëmarrje edhe të komunitetit të prindërve dhe komunitetit të biznesit.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- ✓ Organizim i takimit me Këshillin e Drejtorëve
- ✓ Realizimi i vizitave inspektuese në shkolla.
- ✓ Organizimi i takimit me përfaqësuesit të Sindikatës, Policisë së Kosovës, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale/ OJQ-të
- ✓ Organizimi i garave të Olimpiadës për Matematikanëve të rinj.
- ✓ Përgatitja e planit dinamik të prokurimit për vitin 2025.

Muaji Dhjetor:

- ✓ Organizime shkollore për nder të ditës për të Drejtat e fëmijëve;
- ✓ Pjesëmarrje në aktivitetet për Personat me nevoja të veçanta
- ✓ Vlerësim i realizimit të plan programit mësimor për gjysmë vjetorin e parë.
- ✓ Realizimi i takimit me Këshillin e Drejtorëve
- ✓ Organizimi i takimit me aktivin e drejtorëve, këshillin e prindërve, koordinatorëve të cilësisë
- ✓ Nxjerrja e raportit përfundimtar për gjashtë mujorin e dytë dhe raportit vjetor për vitin 2024.

Bashkëpunimi me institucionet tjera:

DKA-ja ka realizuar bashkëpunime me shumë institucione lokale dhe qendrore:

- Bashkëpunimi me Zyrën për Barazi Gjinore në realizimin e aktiviteteve për të drejtat e njeriut, të fëmijëve dhe të gruas;
- Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës në projekte të përbashkëta për mjedis të sigurtë shkollor;
- Bashkëpunimi me Shoqata Joqeveritare lokale dhe Qendrore në projekte me rëndësi për komunitetin shkollor;
- Bashkëpunimi me Hidro Regjionin në trajtimin e disa kërkesave nga ana institucioneve arsimore;



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Bashkëpunimi me Ekoregjonin për arritjen e objektivave për mjedise të pastra shkollore;
- Bashkëpunimi me KEDS-in për trajtimin e problemeve në rrjetin e energjisë elektrike;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Drejtoritë komunale;
- Bashkëpunimi me QKMF'' Dr. Shpëtim Robaj'' në Malishevë;
- Bashkëpunimi me shumë donatorë, të cilët përkrahin vazhdimisht institucionet arsimore;
- Bashkëpunimi me LMT me seli në Malishevë për shqyrtimin e realizimit të projekteve me rëndësi shkollore;
- Bashkëpunimi me KFOR-in Turk dhe Zvicerian: Realizimi i projektit për kabinetin e informatikës për Gjimnazin '' 12 prilli'' në Vërmicë.
- Bashkëpunimi me Komitetin e Arsimit në Trajtimin e temave me rëndësi arsimore;
- Bashkëpunimi me KPF-ën në shqyrtimin e raporteve për Asamblenë Komunale;
- Bashkëpunimi me Këshillin për Sigurinë në Bashkësi.

PËRGATITJET PËR VITIN E RI SHKOLLOR 2024/2025

Duke u bazuar në vazhdimësinë e zhvillimit të procesit edukativo arsimor, Drejtoria për Arsim dhe Edukim kishte filluar përgatitjet për të realizuar përgatitjet që viti i ardhshëm shkollor të jetë i organizuar dhe të funksionojë në kushte sa më të mira në përputhje me rekomandimet që do të ipen nga MASHT-i

Për të realizuar përgatitje sa më të mira të stafit mësimdhënës DKAЕ-ja ka bashkëpunuar ngushtë me shkollat në përgatitjet e konkursit për pranimin e punëtorëve të rinj. Kjo është bërë në koordinim dhe bazuar në legjislacionin në fuqi të nxjerrë nga MASHT-i. DKAЕ-ja ka shpallë konkurs për plotësimin e mbi 20 pozitave të punës. Në kuadër të rekrutimit të personelit arsimor për nivelin 0 programi parashkollor- edukimi në Çerdhe, ne kemi rekrutuar personelin arsimor përmes konkursit dhe janë kryer të gjitha procedurat shpresojmë se në shtator stafi i pranuar në punë do të fillojë punën e vet për të realizuar funksionimin edhe të dy Çerdheve të reja.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Në drejtim të një arsimi sa më gjithëpërfshirës, Drejtoria për Arsim dhe Edukim ka bërë kërkesë që të shtohet numri i edukatoreve në institucionet tona. Kjo e bazuar në KAB të vitit 2024, ku thuhet se raporti Edukatore nxënës duhet të jetë: 1:12 nxënës. Vlerësuar në aspekte të përgjithshme konsiderojmë që institucionet arsimore janë duke lëvizur në drejtim të mirë të plotësimit të kuadrit të kualifikuar që na garanton për rezultate sa më të larta të procesit edukativo arsimor. Në këtë drejtim bazuar edhe në konkursin e shpallur kemi nevojë për plotësimin e pozitave me kualifikime për lëndët matematikë, gjuhë gjermane, TIK, gjuhë angleze, Art dhe muzikë. Në fushën e përgatitjeve për arsim gjithëpërfshirës DAE-ja ka punuar ngushtë me Shkollat, Këshillin e Prindërve, dhe gjithashtu ka themeluar Ekipin për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me nevoja të Veçanta me qëllim të plotësimit të këtij standardi institucional dhe përfshirjen e këtyre fëmijëve në procesin arsimor. Po ashtu formimi i EPRMB-ve – Ekipëve për Parandalimin e Braktisjes dhe Reagimit për mos Regjistrim të Nxënësve është kërkesë për të gjitha shkollat e koordinuar me MASHT-in.

Në përgatitjen për vitin e ardhshëm shkollor do veçuar edhe anën e planifikimit financiar, ku kemi duke punuar ngushtë me Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Buxhet dhe me MASHT-in që të koordinojmë sa më mirë veprimet tona që të kemi një planifikim sa më gjithëpërfshirës. Do të mbetet sfidë angazhimi i koordinatorëve të cilësisë në shkollat, të cilat deri tani janë çertifikuar nga MASHT-i. Po ashtu po planifikojmë të angazhojmë edhe rritjen e numrit të Shërbimit Pedagogjik dhe Psikologjik në shkollat tona. Gjithashtu në këtë drejtim e kemi pasur të lejuar që të angazhojmë edhe mësuesë mbështetës për të ndihmuar integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat tona, ku tash janë të punësuar 18 asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta..

Për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme për përgatitjet dimërore nëpër shkolla po paraqesim një raport të përgjithshëm cili do të reflektojë anën e burimeve njerëzore, përgatitjet për mallra dhe shërbime e gjithashtu infrastrukturën shkollore.

Në aspektin e burimeve njerëzore kemi pothuajse kuadrin e kompletuar dhe të kualifikuar për të realizuar punën në procesin edukativo arsimor në rast të zhvillimit të punës në institucionet arsimore. Për të plotësuar nevojat për stafin e drejtorisë, konsiderojmë që Drejtoria për Arsim dhe Edukim ka nevojë të domosdoshme të shtojë numrin e stafit të vet të punës, pasi që aktualisht funksionon me 3 punëtorë dhe Drejtoreshën e DKAE-së. Për të kompletuar stafin, i cili do të ndikonte në rritjen e përgjegjësisë krahas



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

institucioneve arsimore, konsiderojmë se prania e një pedagogu dhe një psikologu dhe një zyrtari për arsimin parafillor dhe zyrtari për arsimin fillor është nevojë e domosdoshme që të mund të plotësojmë stafin për punë sa më gjithëpërfshirëse, që do të na garantonte cilësi dhe rezultate pozitive nga i gjithë procesi edukativo arsimor.

Në aspektin e infrastrukturës besojë që kemi një infrastrukturë të mirë që garanton funksionimin e rregullt të institucioneve arsimore

Këtu do të veçojmë intensifikimin e punimeve në Shkollat në Dragobil, projektin për Çerdhen në Banjë, projekte të MASHTI-it. Besojmë që në këtë vit shkollor do të fillojmë punën në të Objektit të ri shkollor në SHFMU" Emin Duraku" në Dragobil. Po ashtu për të përkrahur infrastrukturën shkollore kanë qenë në zbatim kontrata për renovimin e shkollave. Po ashtu ishte kontrata për mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore e cila vazhdon të mbetet në realizim edhe për pjesën shtesë sipas nevojave të institucioneve arsimore.

Kemi vështirësi në furnizim me material administrativ përveç letres për shkak të kufizimeve në procedurat e prokurimit publik. Është në realizim kontrata për furnizim me rekuizita sportive. Po ashtu kontrata për shkollat me rastin e ditëve të shkollave dhe mirënjohjen e kontributit të mësimdhënësve pensionistë. Gjithashtu do të bëjmë në këtë javë furnizimin me librat e klasës, materialit pedagogjik Po ashtu edhe këtë vit DKAE-ja do të përkrah nxënësit e familjeve në nevojë, të cilat kanë nevojë të furnizohen me pajisje shkollore.

Besoj që në javët në vazhdim do të fillojnë edhe procedurat për furnizim me material teknik dhe mirëmbajtja teknike për institucionet arsimore. Por edhe kjo është e diktuar nga procedurat e prokurimit publik për shkak të ankesave.

Drejtorja për Arsim dhe Edukim gjatë këtij viti, ka realizuar edhe shumë punë të tjera administrative përfshirë, raportet statistikore, koordinimin me shkollat për planifikimin e shpenzimeve për vitin 2025, identifikimin e nevojave për projekte prioritare për institucionet arsimore, dhe komunikimin e rregullt me Drejtorinë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa në përgatitjen e planifikimeve buxhetore për vitin 2025. Duke ditur që edhe këtë vit jemi furnizuar me tekste shkollore, ju njoftojmë se ka pasur furnizim për nivelin 1 pra për klasat 1-5 – ta dhe DKAE-ja ka dorëzuar me kohë të dhënat për furnizimin me tekste shkollore.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Po ashtu janë bërë edhe shumë specifikime për realizimin e shërbimeve për shkollat. Gjithashtu janë realizuar me dhjetëra konkurse për plotësimin e personelit arsimor dhe administrativ e teknik për shkollat. Po ashtu DKAE-ja ka realizuar të gjitha raportet për mbajtjen e Testeve-ICILS, Testit TIMSS, Testi i Arritshmërisë, dhe Testin e Maturës për afatin e parë e gjithashtu ishte e përgatitur për mbajtjen e testit të maturës për afatin e dytë. etj

STATISTIKAT

REZULTATET E TESTIT TE MATURES SHTETËRORE-2024

Viti shkollor 2023/2024- Kalueshmëria e testit të maturës shtetërore- Afati i Qershorit.										
Nr.	Shkolla	Nxënës të cilët iu kanë nënshtruar testit të maturës shtetërore	Nxënës që kanë kaluar pragun e kalueshmërisë				Totali	%	Nxënës të cilët nuk kaluan provimin	%
			M	%	F	%				
1	Qendra e Kompetencës" Kujtim Krasniqi" në Malishevë	94	19	20.21	28	29.79	47	50.00	47	50.00
2	Gjimnazi" Hamdi Berisha" në Malishevë	300	56	18.67	129	43.00	185	61.67	115	38.33
3	IAAP " Lasgush Poradeci" në Kijevë	62	10	16.13	16	25.81	26	41.94	36	58.06
Totali		456	85	18.64	173	37.94	258	56.58	198	43.42



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

VITI SHKOLLOR 2023-2024 -KALUESHMËRIA E MATURËS -AFATI I GUSHTIT

Nr.	Shkolla	Nr. i nxënësve <i>Që ju kanë nënshtruar provimit të Maturës</i>	Totali i kalueshmërisë	%	Nxënës që nuk e kanë Kalu provimin	%
1	SHMP" Qendra e Kompetencës" Malishevë	41	19	46.34	22	53.66
2	Gjimnazi" Hamdi Berisha" Malishevë	107	57	53.27	50	46.73
3	IAAP " Lasgush Poradeci" Kijevë	26	11	42.31	15	57.69
	Totali	174	87	50.00	87	50.00



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Përfundim:

Bazuar në rrjedhat e përgjithshme konsiderojmë që sektori i arsimit duhet të mbështetet nga Granti i Përgjithshëm për të mbuluar të gjitha nevojat, të cilat i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime ku janë rritur çmimet dhe e kemi të pamundur të jemi të kompletuar në plotësimin e tyre duke ditur që kemi një buxhet të kufizuar të kësaj kategorie, e cila nuk plotëson të gjitha nevojat.

Gjithashtu jemi duke pasur vështirësi me tërheqjen e mjeteve nga lëndët përmbartimore për shujtën ushqimore dhe pagat jubilarë sipas kontratës kolektive.

Shkollat kanë nevojë, për furnizime me mjete konkretizimi, pajisje informatike, perde, kamera të sigurisë, furnizim me lëndë djegëse pelet e dru dhe nevojat tjera. Kemi nevojë për përkrahje në realizimin e shërbimeve trajnuese për personelin arsimor dhe Këshillat Drejtues të Shkollave, realizimin e praktikës profesionale. Po ashtu në vitin shkollor planifikojmë të mbulojmë transportin e nxënësve në Ngucat, Tërpeze, Temeqinë, Shkozë, Carrallukë, Lagjen Kodrali të Kërvasarisë. Garaqevë.

Bazuar në realizimin e aktiviteteve të deritanishme deklarojmë që DKA-ja do të vazhdojë të punojë me përkushtim për realizimin e planeve të punës dhe arritjen e sa më shumë sukseseve.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

DShMS gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 është marrë me organizim dhe monitorim të procesit të punës brenda stafit të drejtorisë, monitorim të punës brenda Qendrës për Punë Sociale, si dhe monitorimin permanent të punës brenda Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë, dhe përmes drejtorit të QKMF-së , përcjellje të punës edhe në QMF-të , AMF-të në gjithë territorin e Komunës së Malishevës.

Përveç aktiviteteve në funksion të realizimit të planit të punës së kësaj drejtorie, e të cilat do t'i përmendim më poshtë, ndër aktivitetet kryesore të drejtorit të DShMS-së gjatë kësaj periudhe janë edhe këto:

Ka marrë pjesë në disa Trajnime ditore "Trajnimi për personel shëndetësor "- Malishevë, Trajnim në Gjakovë "Kompetencat dhe përgjegjësi e institucioneve në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizem të dhunshëm që shpie në terrorizëm". "Trajnim Integriteti dhe etika në administratën publike, " Trajnimi Terre des hommes -Ndihmë për fëmijët ", si dhe Trajnimi "Takim i Kolegjiut për shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale".

Zyra për përkujdesje të familjeve të dëshmorëve dhe të invalidëve të UÇK-së

Gjatë kësaj periudhe Janar-Dhjetor 2024 konform detyrave të punës, ka rregulluar disa vërtetima për familje të dëshmorëve, për familjarë të të zhdukurve, viktimave civile dhe të plagosurve civil, dhe i ka udhëzuar për plotësim të dokumentacionit për përfitim të beneficionit sipas Ligjit Nr.04L-54 . Ka marrë pjesë në tubime përkujtimore, homazhe së bashku me Kryetarin e Komunës, z. Ekrem Kastrati.

Zyra për sigurimin pensional dhe shëndetsor

Gjatë kësaj periudhe Janar-Dhjetor 2024 ka kryer punët dhe detyrat e punës të përcaktuara sipas kompetencave dhe autorizimeve dhe atë me sa vijon :

-Dëshmi për sigurim shëndetsor jashtë vendit që nuk kanë sigurim shëndetësor në Kosovë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Vërtetima që janë pensionuar në Kosovë për jashtë vendit.
- Vërtetima për botën e jashtme që personat janë në jetë.
- Plotësimi i formularëve për shtesa fëmijore për botën e jashtme.
- Vërtetima që janë mbajtës të familjes në Kosovë për botën e jashtme.
- Mbajtja dhe evidentimi i lëndëve në librin e protokollit, gjithsej 510 lëndë të protokoluara.

Zyra për shëndet primar, publik mental

Ka bërë pranimin e pacientëve të lajmëruar dhe të sëmurë mental, konsultat me familjarët e pacientëve.

Gjatë këtyre muajve zyrtari përkatës ka kryer edhe vizita në familjet e të sëmurëve mental, hospitalizim të pacientëve në spitalin rajonal Psikiatri në Gjakovë dhe shoqërim të pacientëve për në Q.SH.M në Gjakovë, gjithashtu ka një bashkëpunim të mirë me Q.K.M.F. “Dr. Shpëtim Robaj” në Malishevë.

Fatkeqësisht ka mungesë të shoferëve për dërgimin e pacientëve për vizita në Q.SH.M.-Gjakovë e që kjo bëhet pengesë në kryerjen e detyrave më të cilat zyrtari është i ngarkuar, andaj shpresojmë të bëhet një zgjidhje sa më e shpejtë e këtij problemi.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Raporti i QKMF "Shpëtim Robaj" në Malishevë

Fillimi i vitit 2024 mund të konsiderohet një fillim i ri, i qetë sa i përket gjendjes së pandemisë me COVID-19, në territorin e Komunës së Malishevës, por edhe më gjerë.

Objektivat dhe qëllimet që ishin përcaktuar në fund të vitit 2023 për vitin 2024 kanë filluar të finalizohen përgjatë këtij viti, dhe me të drejtë ne këtë vit mund ta quajmë: vit i sfidave dhe vit i realizimit të projekteve më të mëdha, që deri më tani mund të arrihen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë.

Është i njohur fakti se institucionet shëndetësore funksionojnë atëherë kur janë të fuqizuara tri shtylla të forta:

- I. Staf të mjaftueshëm profesional për jetësimin e konceptit të Mjekësisë Familjare,
- II. Infrastrukturë të përshtatshme, kushte të punës për staf dhe pacientë,
- III. Pajisje të sofistikuar-bashkëkohore, material sanitar, administrativ dhe higjienik të mjaftueshëm, si dhe të realizuar në kohë.

Nisur nga shtylla e parë, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë kemi pasur mbështetje nga Komuna e Malishevës. Shfrytëzoj rastin ta falënderoj qeverinë komunale, e cila na ka dalë në ndihmë me projektin SHËRBIMET SHTËPIAKE, të cilin e ka realizuar dhe punëtorët kanë filluar punën dhe ende vazhdojnë.

Mbështetur në këto kapacitete, institucioni ynë shëndetësor ka arritur të realizojë shërbime në shumicën e shtëpive ku është paraqitur nevoja, duke bërë mjekim, referim dhe kujdes gjatë referimit. Pasi që në këtë dymbëdhjetë muaj të vitit 2024 nuk kemi pasur mungesë të theksuar të stafit, me përjashtim të Mjekëve Familjarë, angazhimi ynë si menaxhment ishte të sigurojmë kushte për të ofruar shërbime mjekësore, si: aparatura, material sanitar, material higjienik dhe masa mbrojtëse, të cilat janë të domosdoshme për punë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Mbështetur në këto kapacitete, institucioni ynë shëndetësor ka arritur të realizojë shërbime në çdo shtëpi ku është paraqitur nevoja, duke bërë mjekim, referim si dhe kujdes gjatë referimit. Pasi që në këtë tremujor të vitit 2022 të vështirë kishim mungesën me staf dhe kuadro të duhura në institucionin tonë, atëherë angazhimi ynë si menaxher ishte të sigurojmë kushte për të ofruar shërbime mjekësore si: aparatura, material sanitar, material higjienik dhe masa mbrojtëse të cilat janë të domosdoshme për punë.

Planifikimi

Angazhimi i stafit menaxherial në QKMF Malishevë, gjatë vitit 2023, është fokusuar në vlerësimin e nevojave të institucionit, iniciimin e kërkesave, ndërsa mbështetja nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Kuvendi Komunal ka bërë të mundur realizimin dhe finalizimin e disa prej kërkesave tona.

Investimet kapitale të cilat janë paraparë për t'u realizuar gjatë këtij viti, sipas kërkesave tona, janë realizuar disa prej tyre. Aparaturat dhe materialin tjetër medicinal do t'i prezantojmë në formë të tabelave duke përshkruar me detaje vendin dhe llojin e investimeve, llojin e aparaturave dhe materialin tjetër shpenzues. Të gjitha këto investime në institucionin tonë janë të prekshme dhe në shërbim të qytetarëve, ku çdo ditë po rrisim cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe rrjedhimisht po rritet kënaqësia e pacientëve të komunës sonë dhe e pacientëve të komunave të tjera përreth, të cilët marrin shërbim në qendrën tonë.

Problemi kryesor në QKMF Malishevë tani për tani është mungesa e kuadrit profesional (mjekëve), gjë për të cilën kemi pasur vështirësi dhe mbingarkesë të mjekët me orë shtesë në QKMF, QMF dhe në vizitat shtëpiake.

Furnizimi me medikamente nga lista e barnave esenciale nga Ministria e Shëndetësisë gjatë këtij viti ka qenë jo i kënaqshëm.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Aktivitetet e QKMF-së;

- Janë mbajtur ligjërata vetëdijesuese për parandalimin dhe mbrojtjen nga ethet hemoragjike në çdo shkollë të komunës së Malishevës.
- Takimet koordinuese me Drejtorin e DSHMS-së.
- Takimet dhe kontaktet e rregullta me MSH, IKSHIP dhe IRSHP.
- Mbledhjet e rregullta çdo dy javë me Shefat e shërbimeve, për organizimin e punës në shërbime, vërejtje, sugjerime dhe detyra.
- Takimet e rregullta ditore me Koordinatorin e cilësisë për mbarrëvajtjen e punës, vërejtjet, sugjerimet dhe raportet për gjendjen e cilësisë së shërbimeve.
- Takimet e rregullta ditore me Kryeinfermierin për koordinim dhe mbarrëvajtje të procesit të punës.
- Organizimi i ligjëratave për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional të stafit.
- Trajnimet e rregullta të stafit të organizuara nga MSH, OJQ-të dhe shoqatat profesionale.
- Takimet e rregullta me Donatorë dhe grupet e tjera të interesit.

SHËRBIMET NË QKMF, QMF, AMF NË DYMBËDHJETË MUJORIN E VITIT- 2024

Puna e stafit në të gjitha institucionet tona përbën një kapitull të rëndësishëm në këtë raport, si: Gjinekologji, Interno, Pediatri, Stomatologji, Laborator, RTG, ECHO, Vaksitim, Kartotekë, Barnatore, Depo, Mjekësi Familjare, Urgjencë, Vizita nënave shtatzëne dhe fëmijëve deri në moshën 3 vjeçare.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Vizita në familje dhe përkujdesje të drejtpërdrejtë me pacientë të mjekimit paliativ. Stafi i administratës, stafi i autoparkut, higjienëmbajtës dhe stafi i mirëmbajtjes, të gjithë kanë kontribuar në forma të ndryshme në ndihmë të pacientëve, përkundër punës dhe detyrave të tyre të zakonshme.

Më pas do të paraqesim raportin e punës për të gjitha shërbimet për dymbëdhjetë mujorin e vitit 2024, ku nga të gjitha institucionet tona gjatë kësaj periudhe janë ofruar: **422192** vizita dhe shërbime mjekësore.

Vizitat dhe shërbimet në institucionin tonë për dymbëdhjetë mujorin e vitit- 2024 janë si vijon:

Raporti tremujor	TM1	TM2	TM3	TM4	Gjithsej
Gjinekologjia	2116	2016	2251	2194	8577
Interno	1154	0	0	0	1154
Stomatologj	832	993	1126	835	3786
Ultrazë	825	714	332	1037	2905
Laboratori	Pac.4237	3893	4293	3774	16197
	Shërbime.32649	32737	38527	34048	137961
Pediatri	3912	3024	4257	3737	14930
Vaksinim anti Covid	0	0	0	0	0
Vaksinim	2220	3917	1915	3773	11825



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Mjekësia Familjare	15261	12560	18642	14950	61413
Intervencat	10841	8684	10401	9252	39178
Infuzione	7803	7126	9734	6871	31534
Urgjenca	7953	7447	9875	6326	31602
Lidhtorja	1774	2031	2832	1817	8454
RTG	1550	1425	1701	1565	6241
Këshillimorja	1184	967	467	796	3414
Kijevë	MF.3025	MF.1692	MF.3592	MF.2920	11229
	Pediatria.810	Pediatria.523	Pediatria.699	Pediatria.730	2762
	Stom. 173	Stom.101	Stom.184	Stom.115	573
	sher inf.3420	Sher.inf.1983	Sher.inf.4556	Sher.inf. 3438	13397
Bellanicë	631	549	772	480	2432
Llazicë	150	111	149	127	537
Drenoc	392	444	150	63	1049



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Panorc	560	376	463	511	1910
Llapqevë	0	0	0	0	0
Lubizhdë	0	0	0	0	0
Dragobil	70	38	45	48	201
Pagarushë	154	100	15	0	269
Kravasari	184	192	172	183	731
Carrallukë	138	134	132	137	541
Terpezë	25	21	12	17	75
Berishë	0	0	0	0	0
Vizita shtëpiake dhe paljativ.	V,me Dr.499	320	237	159	1215
	Sher inf. 1336	1116	1205	1769	5426
Pickime nga rriqrat	26	818	219	19	1082
Participimi	€.14318	€.11746	€.18139	€.17760	€. 61963
Gjithësej	105494	96052	118955	101691	422192



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Shërbime të ofruara për dymbdhjetëmujorin e vitit 2024 janë gjithsej: 422192

Kërkesat:

Janë bërë kërkesat për nevojat e QKMF-së drejtuar DSHMS-së sipas planifikimeve për:

- Investime kapitale
- Furnizim me material dhe aparatura
- Rekrutim të stafit

RAPORTI (Janar-Dhjetor 2024) TË HYRAT DHE SHPËNZIMET PËR VITIN -2024

Buxheti për vitin 2024 është 2,380.896.00 €

Pagat dhe mëditjet ----- 1,440.268.96 €
Mallra dhe shërbime- -----502.627.04 €
Investime kapitale-----200.000.00 €
Shpenzimet Komunale-----170,000.00 €
Subvencione dhe Transfere (Të H. V) 68.000.00

Pagesa të kryara në kategorin mallra dhe shërbime për vitin 2024 kapin shumën në vlerë prej: **500,775.38 euro**

Furnizimit me barna nga lista esenciale (Ministria e Shëndetësisë) edhe të hyra tjera të kontraktuara me prokurim për një vit janë në vlerë prej- **91,340.57 €**. **Shuma** e barnave që janë dalë nga depoja për vitin 2024 kapë shumën prej **74,183.87€**.

Furnizimi me barna nga lista esenciale si dhe furnizimi me Insulin përmes Barnatores kapë shumën në vlerë prej **-101,019.97 €**. Të dalurat nga Barnatorja është shuma prej- **83,805.70 €**



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Material shpënzues për laborator për këtë vit është blerë në vlerë prej- **71,571.47 €**. Furnizimi është bërë në bazë të kontratave nga Kompanit "INTERLAB" dhe "KEIS" me seli në Prishtinë. Materjali është pranue mesë depos dhe me këtë si shumë komplet është ngarkuar Laboratori.

Të hyrat nga participimi për vitin 2024 janë në vlerë prej: **59,793.30** euro, të hyrat nga qertifikatat mjekësore janë në vlerë prej: **2,170.00** euro. Totali i të hyrave nga participimi është: **61,963.30** euro.

Përshkrimi	Të hyrat	Të dalurat	Mbetjet
Të hyra nga lista esenciale dhe të tjera 10,968.15€ 15,182.05 € 18,885.73 €	91,340.57 €	74,183.87 €	17,157.63€
Të hyrat nga Brnatorja	101,019.97€	83,805.70 €	17,214.27 €
Të hyrat e materjalit kontraktues për laborator.	71,571.47 €	71,571.47 €	
Të hyrat nga matriali higjenik dhe zyrtar	7,633.52	3,398.42 €	4,235.10
Të hyrat nga participimi 2024	61,963.30 €		
Paisjet		35,900.00 €	
Investime kapitale		50,000.00 €	
Pagat dhe medi.Janar- Dhjetor/2024		1,318,947.44 €	
Shpenzimet Komunale		168,782.76 €	
 Mallra dhe shërbime			 500,775.38 €



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Rastet me pickim nga rriqrat paraqesin prapë një problem të madh për komunën tonë, edhe pse shifrat kanë tendencë rënjeje, rreziku nga infeksioni vazhdon të mbetet i njëjtë.

Ne si kuadër menaxherial do të angazhohemi në realizimin e synimeve dhe qëllimeve tona, gjithmonë duke pretenduar të ngrisim cilësinë e shërbimeve, gjë që është edhe synimi kryesor i Mjekësisë Familjare. Shpresojmë në një bashkëpunim të mirë me të gjithë stafin e QKMF-së, e po ashtu një mbështetje nga strukturat e Kuvendit Komunal që janë kompetente për të udhëhequr Kujdesin Parësor në Komunën e Malishevës. Mbështetje e rendit të parë është kuadri shëndetësor, i cili përballet me pacientët. Profesionalizmi dhe humanizmi i kuadrit shëndetësor reflekton imazhin e institucionit tonë. Zhvillimi i burimeve njerëzore është një ndër elementet më të rëndësishme të kujdesit shëndetësor dhe kjo realizohet me zhvillimin e vazhduar profesional, gjë për të cilën dua ta falënderoj koordinatorin e EVP-së, Ragip Thaçi, Bachelor i Infermierisë, i cili e bën këtë punë me shumë profesionalizëm dhe krejtësisht pa pagesë. Po ashtu, një falënderim shkon edhe për komisionin për regjistrimin e pasurisë së institucionit: Behije Thaçi, Lirije Krasniqi dhe Besjanë Krasniqi, të cilat kanë bërë një punë të madhe. Përdorimi i rregullt i standardeve dhe i protokolleve të cilësisë së shërbimeve dhe të performancës në punë do të jetë synimi ynë kryesor gjatë vitit 2024, ku me këtë synojmë të zbatojmë ligjet dhe rregulloret e punës në KPSH. Ndihmesa dhe mbështetje e vazhdueshme për realizimin e objektivave të QKMF-së, padyshim është Koordinatorin i cilësisë, Dr. Ali Krasniqi, Specialist i Biokimisë Klinike, dhe me këtë rast dua ta falënderoj për zemërsisht. Shpresojmë që ne si Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare të arrijmë të realizojmë këto qëllime gjatë vitit 2024 dhe të avancojmë vazhdimisht ndër vite, derisa të arrijmë standardet e një sistemi bashkëkohor shëndetësor.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Raport i aktiviteteve për vitin 2024:

	<i>Aktivitetet</i>	<i>Kateg 1</i>	<i>Kateg 2</i>	<i>Gjithsejt</i>
Aplikim	1 Nr. i rast. që kanë aplik. Për herë të parë	17	8	25
	1.1 Sa prej tyre janë të aprovuara	12	6	18
	1.2 Sa janë në shqyrtim	6	///	6
	1.3 Sa prej tyre janë të refuzuara	///	1	1
RIAPLIKIM	2. Nr. i rast. të larguara për mos ri-aplikim	28	39	67
	2.1 Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar	384	336	7



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

	2.2 Nr. i rasteve të larguara për mungesë të dokumentacionit	18	3	21
VERIFIKIM	3 Nr. total i familjeve të verifikuara/riverif	443	386	829
	3.1 Sa prej tyre janë të aprovuara	394	342	736
	3.2 Sa prej tyre janë refuzuar/qregjistruar	49	44	93
KOM-MJEKSOR	4 Numri i rasteve të dërguara në KM	406	0	406
	4.1 Numri i rasteve të aprovuara nga KM	373	0	373
	4.2 Numri i rasteve të refuzuara nga KM	32	0	32
	4.3 Numri i rasteve të kthira nga KM për mos-kompletim dokumentacioni	1	0	1



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

ANKESAT	5 Nr. i ankesave të paraqitura nga Shfrytëzuesit	18		18
	a) Në shkallë të parë (I)	0	0	0
	b) Në shkallë të dytë (II)	18	0	18
	5.1 Numri i ankesave të aprovuara	///	///	///
	5.2 Numri i ankesave të refuzuara	10	///	10
	5.3 Numri i ankesave në shqyrtim	8	//	8
	5.4 Kontestet në gjykata	0	0	0
	a) Kontestet të pranuar	0	0	0
	b) Konteste të refuzuara	0	0	0
RIAKTIVIZIMI MET	6 Nr. i rasteve të Riaktivizimit	8		8



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Aktivite tjera: Gjate kësaj periudhe kemi ndihmuar disa familje me nga një pako ushqimore, të cilat kanë qenë nga Shoqata Katarit 300 pako, po ashtu edhe Shoqata Islamik Relief Kosova me 130 pako, Halil Kastrati 200 pako, dhe Mërgimtari Robert Hoti nga fsh: Carallukë me vendqëndrim në Suedi me 50 pako. Po ashtu për festën e Kurban Bajramit janë të ndihmuar 130 familje me mish nga shoqata Katarit. Dhe 50 Fëmijë Jetimë me nga një pako dhe veshembathje nga shoqata Bereqeti në Malishevë

Komente: Raporti përputhet me raportin e zyrtarve të SNS-së

Vlen te theksohet se familjet te e cilat kanë përfituar nga projekti Sas Pilotimi janë gjithsej 63 familje përfituese

Aktivite tjera: Kemi pasur trajnime në fushën e Strehimit Familjar, dhunës në familje, kundër viktimave të trafikimit dhe trajnime tjera në kuadër të Shërbimeve Sociale.

2 studenta kanë bërë praktikë në shërbimet sociale.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe kemi pasur raste të dhunës në familje dukshëm më shumë se sa vitin e kaluar ku të gjitha këto raste janë trajtuar në menyr të profesionalizuar nga ana e Organit të Kujdestarisë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

QENDRA PËR PUNË SOCIALE - Financat

Qendra për Punë Sociale në Malishevë gjatë kësaj periudhe ka bërë shfrytëzimin e mjeteve financiare në bazë të alokimeve të lejuara nga ana KK-Malishevë.

Vërejtje: Raporti për shpenzimet e ujit, të telefonit, të energjisë elektrike dhe të mbeturinave janë të dorëzuar në Drejtorinë e Financave të Komunës së Malishevës.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE - DSHP

Drejtoria e Shërbimeve Publike në këtë periudhë njëvjeçare është angazhuar maksimalisht për kryerjen e detyrave të punës të parapara në kuadër të veprimtarisë së vetë në realizimin e projekteve sipase planifikimeve buxhetore, si dhe të parapara me ligjet në fuqi.

Si Drejtori i janë përgjigjur kërkesave të qytetarëve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave dhe ankesave në afatin e parapara procedural që përcaktojnë ligjet, rregullorët dhe Statuti i Komunës.

Detyrat dhe projektet e parapara nga kjo Drejtori për periudhën janar-qershor të vitit 2024 të realizuara dhe disa prej tyre janë në procedurë të realizimit (tenderimit) i paraqesim në formë të shkruar;

- Mbikëqyrja e ofrimit të shërbimeve publike lokale, duke përfshirë furnizimin me ujë, rrjetin e ujësjellësit, rrjetit të kanalizimit.
- Mbikëqyrja e operatorit ekonomik për shërbimet e automarimangës (zhvendosja dhe bllokimi i automjeteve).



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Shenjëzimi vertikal dhe horizontal i rrugëve në territorin e Komunës së Malishevës
- Mbikëqyrja dhe përkujdesja për shërbimin e dekorimit të qytetit për festa zyrtare.
- Largimi dhe trajtimi i deponive inerte ilegale në territorin e Komunës së Malishevës
- Mbikëqyrja e realizimit të shërbimeve që janë ofruar nga Bashkësia Islame në Malishevë sipas kontratës së prokurimit për heqjen e shpenzimeve të varrimit.

MENAGJMI I MBETURINAVE

Sipas planit të punës për vitin 2024 kemi kryer aktivitetet dhe punët si në vijim;

- ✚ Hartimi i Planit Komunal për Menagjimin e Mbeturinave
- ✚ Vazhdimi i pilot-projektit për Reformën e Taksës së Mbeturinave dhe Edukimit Mjedisor
- ✚ Mbledhja dhe raportimi i shënimeve
- ✚ Mbikqyerja e zbatimit të standarteve të shërbimit për ndërmarrjen e kontraktuar për grumbullimin e mbeturinave.
- ✚ Punë të përditëshme të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, shqyrtimi i kërkesave, nxjerrja e vendimeve, dhënja e pëlqimeve, lejeve të ndryshme.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Gjatë vitit 2024 kemi realizuar disa aktivitete që kanë të bëjnë me fushën e menagjimit të mbeturinave, në bashkëpunim me JICA në korrik të vitit 2024 kemi përfunduar projektin 3 vjeçar ashtu siç është paraparë edhe në planin e punës së projektit.
- Gjatë kësaj periudhe 3 vjeqare kemi bërë shumë punë, disa pilot projekte me rëndësi të cilat na kanë shërbyer shumë për të parë gjendjen aktuale të menagjimit të mbeturinave në territorin e komunës sonë, vlerësimin e situatës aktuale, nevojat dhe hapat që duhet ndërmarrë në këtë drejtim.

Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të Edukimit Mjedisor dhe Reformës së Taksës gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024

Në kuadër të këtij aktivitetit kemi bërë fushatë ndërgjegjësimi nëpër shkolla fillore, ku target grupi i synuar kanë qenë nxënësit e klasave të VI (gjashta).

Ky aktivitet është mbajtur në shkollën fillore “Habib Berisha” në Gurbardhë dhe aktiviteti tjetër në shkollën fillore “Dëshmorët e Kombit” në Ngucat.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024



Zyrtari komunal ka shpjeguar dhe paraqitur gjendjen aktuale të mbeturinave në komunën tonë para nxënësve si dhe duke i inkurajuar ata, lidhur me përdorimin, ripërdurimin dhe reduktimin e mbetjeve në mënyrë të zvogëlojmë në minimum sasinë e mbetjeve për depozitim.

Mësimdhënësve përkatës iu është prezentuar Libri Udhëzues i Edukimit Mjedisor për Menaxhimin e Mbeturinave, material ky i punuar nga ekspertët Japonezë ku është marr miratimi i DKA në Malishevë për përdorimin e këtij udhëzuesi.

Përmbajtja dhe temat që janë spjeguar tek nxënësit:

Gjendja aktuale e sistemit të menaxhimit të mbeturinave në komunën tonë (të dhënat themelore të mbeturinave, problemet e shkaktuara nga mbeturinat, rrjedhshmëria e mbeturinave dhe vendi përfundimtar i deponisë), janë spjeguar objektivat tek nxënësit ku qëllimi ishte të kuptojmë gjendjen aktuale të mbeturinave në komunën tone, dhe të mendojmë për raportin mes jetës sonë dhe problemit të mbeturinave.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Janë formuar grupet ekologjike në shkollat ku është mbajtur trajnimi dhe aktivitetet, mjetet financiare të grumbulluara nga shitja e këtyre materialeve të riciklueshme i kanë përdorur për aktivitetet e tyre lidhur me mjedisin, kjo sipas rekomandimeve të zyrtarit komunal për MM, mësuar nga projekti me JICA.

Lojë me mbledhjen dhe klasifikimin e mbeturinave (objektivat ishin për të kuptuar kategoritë e mbeturinave dhe për të mësuar mënyrën e saktë të klasifikimit të tyre për të zvogluar sasinë e mbeturinave)

Aktiviteti për krijimin e **çantave Eko** nga bluzat e vjetra, iu është kërkuar nxënësve të bëjë të tilla në shtëpi për ti përdoruar nga familjet e tyre në mënyrë që ti ulin kosotot e blerjes së qeseve të plastikës, e që kjo do të ndikonte direkt për një ambient më të pastër.

Vizitë në deponinë qendrore në Landovicë, për të parë nga afër nxënësit se ku përfundojnë të gjitha ato mbeturina që ne i krijojmë çdo ditë.

Riciklimi dhe ripërdorimi i letrës/ **ORIGAMI** (objektivat ishin për të mësuar rreth riciklimit dhe sa energji do të kursehet nga riciklimi dhe për të mësuar rreth ripërdorimit të letrës përmes kulturës Japoneze ORIGAMI). Ju është shpjeguar nxënësve se prodhimi i mallrave me material të ricikluar, në vend të lëndës së parë ruan burimet natyrore dhe energjia. Kjo për shkak se materialet e ricikluara tashmë janë rafinuar dhe përpunuar një herë, prodhimi për here të dytë është shumë më i pastër dhe më pak energji intensive se i pari. Për shembull prodhimi me kanaçe alumini të ricikluar përdor 95% më pak energji sesa krijimi i të njëjtës sasi alumini me boksit.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Materialet	Kursimi I energjisë
Alumin	95%
Karton	24%
Xham	5-30%
Letër	40%
Plastikë	70%
Çelik	60%

Materialet	Kohëzgjatje për dekompozim
Gazeta	2-6 muaj
Lëvozhgat e perimeve	3 muaj
Kanaqe alumini	80-200 vite
Shishe të plastikës	450 vite
Bateritë	500 vite
Stiropor	I përjetshëm (nuk mund të dekompozohet)
Shishe xhami	I përjetshëm (nuk mund të dekompozohet)



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Në ligjëratat e mbajtura nga zyrtari komunal për MM, nxënësve iu është shpjeguar edhe dekompozimi i mbeturinave siç vijon;

Shënim: vitet në përgjigje janë një vlerësim i përafërt. Varet nga temperatura dhe kushtet natyrore, etj.

Në kuadër të aktiviteteve është shpjeguar edhe Lista e Kategorive të Mbeturinave

Kategoria	Mbeturinat organike	Mbeturinat inorganike	Të riciklueshme
Karakteristikat	Mund të zbërthehen natyrshëm dhe të përdorën për kompostim	NUK mund të dekompozohen në mënyrë natyrale dhe të hidhen në deponi.	Mund t'i shiten kompanisë së riciklimit për t'i kthyer ato në produkte/material të reja.
Materialet e mbeturinave	Lëvozhgat e perimeve, druri, lëvozhga e vezës, kocka e peshkut	Gomë, këpucë të vjetra, qeramikë	Letër e pastër, gazetë, revistë, karton, shishe qelqi, PET, kanaqe alumini, kanaqe çeliku



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Pas këtyre aktiviteteve nxënësit kanë filluar me ndarjen e disa nga llojet e mbeturinave të riciklueshme siç janë kapakët e shisheve të plastikës dhe kanaqet e aluminit.

Dorëzimi i materialit te kompanitë përkatëse me të cilat kemi bërë marrëveshje për pranimit e këtyre materialeve ku është përcaktuar një çmim, për kapakët e shisheve të plastikës çmimi 0.30€/kg dhe kanaqet e aluminit çmimi 0.60€/kg



Lidhja e marrëveshjes për materialin e riciklueshëm



Grumbullimi i materialeve nga nxënësit



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

REFORMA E TAKSËS SË MBETURINAVE

Në kuadër të këtij aktiviteti kemi bërë hapat e duhur dhe shumë të nevojshëm për një reformë të tillë, në bashkëpunim me JICA kemi bërë analiza, statistika lidhur me koston për MM, duke përfshirë të gjitha shpenzimet e mundshme dhe është ardhur në përfundim se kosotoja totale për ton/vit është 47.60€, ky rezultat është nxjerr sipas shpenzimeve të 3 viteve të fundit të ndërmarrjes publike.

Operatorët publikë të mbeturinave (kompanitë regjionale të mbeturinave) apo ato private ofrojnë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake për qytetarët, duke u ngarkuar drejtpërdrejt me tarifën e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, pa u kontraktuar siç duhet nga komunat. Për të arritur pajtueshmërinë me legjislacionin ekzistues, komunat duhet të kontraktojnë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake me operatorët.

Inkasimi i taksës komunale të grumbullimit të mbeturinave nga komuna garanton që të ketë fonde të mjaftueshme për të mbuluar ofrimin e shërbimit.

Në bashkëpunim me JICA kemi realizuar pilot projekte për të mbështetur komunën për të vendosur taksën komunale për mbeturinat.

Aktualisht taksa për mbeturina për ekonomi familjare REZIDENTE është 5.50 €/muaj, ndërsa për Amvisëritë JO REZIDENTE shuma e taksës është sipas formulës;

$$M \times T + (12-M) \times t$$

M= numri i muajve të vitit me mbi 15 € shpenzime elektrike (maksimum 6 muaj),



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

T = tarifa mujore (€),

12 = muajt në vitin kalendarik,

t = tarifa mujore me më pak se 15 € shpenzime elektrike (€) = 1 €

Shembull: $M = 3, T = 5.5, t = 1 \text{ €}$, atëherë $3 \times 5.5 \text{ €} + (12 - 3) \times 1 \text{ €} = 16.5 + 9 = 25.5 \text{ €}$

Lloji i shërbimit derë më derë, kjo është përcaktuar me Rregullorën Komunale për MM, nr. 02/273 datë 31.05.2023

Gjithashtu në kuadër të reformës së taksës për MM është zhvilluar një softuer për menaxhimin e taksës së Mbeturinave, mundësuar nga projekti me JICA.

Poashtu kemi bërë një marrëveshje me kompaninë Ekoregjioni me nr. 01/254 datë 04.03.2024 për bartjen e të dhënave të klientëve në databazën e komunës për të startuar me faturim.

Është paraparë që të lidhim një kontratë fillimisht me kompaninë e mbeturinave për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave për ekonominë familjare.

Sipas projektit dhe konsultat me stafin e lartë drejtues të komunës ishte e planifikuar që këtë reformë të fillojmë në Janar 2025, pasi që kemi vlerësuar se të gjitha përgatitjet ishin bërë paraprakisht për të startuar, kjo gjë fillimisht ishte paraparë të ndodhë në korrik 2024 mirpo me kërkesë të kompanisë regjionale Ekoregjioni kjo u shtye për në Janar 2025. Aktualisht me këtë taksë menagjon kompania regjionale për mbeturina me seli në Prizren, mirpo sipas Rregullorës Komunale për MM kjo taksë duhet të menagjohet nga Komuna,



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

prandaj janë bërë të gjitha ato vlerësime, analiza dhe parashikime nga ekspertët Japonezë për një reformë të tillë. Shpresojmë të startojmë në vitin 2025.

Grumbullimi dhe Transportimi i Mbeturinave;

Sipas Ligjit Nr. 04/L-60 (Ligji për Mbeturina (2011)) dhe Ligjit Nr. 08/L-071 (për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L60 (2022)), komunat janë përgjegjëse për menaxhimin e shërbimeve të mbeturinave në nivel lokal.

Sipas të dhënave që disponojmë nga KRM “Ekoregjioni” njësia në Malishevë si operator i licensuar për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, për vitin 2024 kishte planifikuar që çdo ditë të ketë shërbim lidhur me grumbullimin e mbeturinave të ekonomive familjare dhe bizneseve, pra 365 ditë në vit kishte ofruar shërbim;

Numri i ditëve të planifikuara për mbledhjen e mbeturinave në territorin e komunës së Malishevës për vitin 2024 ka qenë 365 ditë.

Numri i ditëve të realizuara për mbledhjen e mbeturinave në territorin e komunës së Malishevës për vitin 2024 ka qenë 365 ditë.

Sasia totale e depozitimit të mbeturinave nga ekonomitë familjare dhe bizneset në vitin 2024 ishte **10,336.98** ton., çmimi për deponim në deponinë rajonale aktualisht 8.31 €/ton

Numri i ekonomive familjare rezidente të shërbyera në vitin 2024 ishte 6565, jo rezidente 1728 dhe biznese 705.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Faturimi dhe Inkasimi i mjeteve:

- ✚ Shuma e mjeteve të faturuara për vitin 2024 për Amvisëritë.... 438,602.24€
- ✚ Shuma e mjeteve të faturuara për vitin 2024 për Bizneset..... 89,466.70€
- ✚ Shuma e mjeteve të inkasuara për vitin 2024 për Amvisëritë..... 421,145.38€
- ✚ Shuma e mjeteve të inkasuara për vitin 2024 për Bizneset..... 89,222.68€

Në shumën e inkasuar të mjeteve janë të përfshira edhe borgjet e vjetra.

Lloji	Mesatare (ton/ditë)	Përbërja mesatare
Mbeturinat e kuzhinës	9.8	33.5%
Letër	4 .9	16.8%
Tekstile	0.5	1.7%
Mbeturinat e gjelbra (bimësia).	1.1	3.8%
Bar / dru	0.2	0.7%
Plastike.	6.8	23.1%
Gome/lëkurë.	0.0	0,0%



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Metalet	0.8	2.6%
Shishe/xhama.	2.2	7.5%
Dheu/gurët/qeramika.	0.2	0.5%
Hiri nga pajisja e ngrohjes.	0.3	0.9%
Të tjerat	2.7	9.1%
Total	29.3	100.0%
Mbeturinat e kuzhinës, mbeturinat e gjelbra dhe bari/druri	11.1	37.9%

Përbërja dhe sasia mesatare e mbeturinave

Burimi: Anketa e përbërjes së sasisë së mbeturinave nga pilot projekti me ekipen e ekspertëve të JICA




Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024



Bashkëpunimi me Drejtorinë e Urbanizmit në hartimin, realizimin dhe mbikëqyrjen e projekteve në kuadër të veprimtarisë në fushën e shërbimeve publike si: rrugët, trotuarët, furnizimit me ujë, kanalizimet e ujrave të zeza, ndriçimit publik, gjelbërimit, etj.

Janë dhënë vendime, pëlqime për hyrjen në bulevardin "IBRAHIM MAZREKU" si dhe vërtetime për studentë dhe raste sociale;

Kemi bërë menaxhimin, kontrollimin dhe pastrimin e hapësirave publike, shesheve, varrezave të dëshmorëve, të maturantëve, si dhe pastrimin e rrugëve të qytetit me ujë sipas marrëveshjes nr.:01/645 datë 03.05.2023 në mes të KK-Malishevë dhe Ekorigjionin jugor - SH. A në afatë një vjeçar.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Kemi bërë menaxhimin e kontratës me nr. Prokurimit 76, dhe Nr. protokoli 03/144 e lidhur me me date 07/11/2022 nr. prok. 62500-22-5456-1-2-1, me emërtim **SHENJËZIMI I RRUGËVE DHE OBJEKTEVE PUBLIKE NË FSHATRA DHE QYTETIN E MALISHEVËS** me afatë prej tri viteve.

- Hapjen e 75 bunarëve me shoqatën QATAR CHARITY dhe Komunës së Malishevës.
- Ndërtimi i 10 shtëpive bashkëpunim në mes të shoqatës QATAR CHARITY dhe Komunës së Malishevës.
- Zbatimi i masav EE për OBS-01 i fituar për financimin nga FKEE dhe Komuna, ku 90% e financimit kryhet nga FKEE dhe 10% nga Kumuna e Malishevës.
- Strehimi i përkohshëm edhe i 3 familjeve në OBS-01 dhe 02.
- Hartimi i Rregulloreve për Transpotin Publik Urban dhe të Mbeturinave.
- Janë bërë largimi dhe pastrami i mbeturinave inerte në hapsira publike në territorin e Komunës së Malishevës, janë kryer 105 pika.
- Kryerja e punëve të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushëveprimtarisë së drejtorisë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL - DBPZHR

Drejtoria e Bujqësisë duke u bazuar në buxhetin dhe Planin e punës për vitin 2024, dhe në kërkesat e fermerëve, këtë vit ka realizuar disa projekte dhe aktivitete, ku janë ndihmuar fermerët dhe ekonomitë bujqësore në rritjen e produktivitetit për sektorët prioritar.

Bujqësia në Komunën e Malishevës, ka filluar të zhvillohet duke u bazuar në angazhimet e bujqëve lokal dhe është njëra prej degëve kryesore të zhvillimit ekonomik. Mund të thuhet se një pjesë e madhe e territorit të Komunës është e mbuluar me tokë pjellore dhe ka klimë të përshtatshme që garanton prodhimtari ekonomike dhe profitabilitet të drithërave, pemëve, perimeve dhe blegtorisë.





Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

PROJEKTET E REALIZUARA NGA DBPZHR - 2024

1. Përkrahja e fermerëve me subvencionimi të farës së patatës dhe qepujkave me 25% të çmimit të farës së blerë

Ky projekt është planifikuar që të ju dale në ndihmë fermerëve si dhe ti stimuloj që të rriten sipërfaqet e mbjella me këto kultura lavërtarie dhe perime. Në shpallje publike të datës 05/04/2024 me numër protokoli 08/28 kanë aplikuar 11 fermerë. Pasë verifikimit të dokumenteve dhe vizitave në teren të gjithë këta fermerë i kanë plotësuar kriteret e shpalljes dhe janë përfitues.

Vlera e këtij projekti është 8,199.75 €.





Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

2. Përkrahja e blegëtorve me subvencionim të qumështit përmes pagesave direkte qumësht/litër për 6 mujorin e dytë 2023

Ky projekt është planifikuar të ndahet në dy periudha të aplikimit (çdo 6 muaj), për 6 mujorin e dytë të vitit 2023, ku kemi publikuar thirrjen për aplikim me datë: 05.06.2024 dhe nr.: 08/63, ku në këtë projekt kanë aplikuar 71 fermerë të cilët dorzojnë qumësht në pikat grumbulluese të qumështit.

Pas vlerësimit të aplikacioneve të fermerëve Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka përpiluar listën e përfituesve ku janë përkrahur 71 fermerë (blegtorë) me **0.03 €uro** për litër të qumështit përkatësisht janë subvencionuar **761,080** litra qumësht. Vlera e përgjithëshme e këtij projekti ka qenë: **22,832.40 €uro** pagesat për shkaqe përmbartimore nuk janë bërë, mirëpo do të realizohet në fillim të vitit 2025.

3. Përkrahja e fermerëve përmes Organizatës “Islamik Relief Kosova”

Në bashkëpunim me Organizatën “Islamik Relief Kosova” me seli në Prishtinë si dhe Komunës së Malishevës (Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), kemi arritur Memorandum të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit më datës 07.08.2024 dhe nr. 01/928, në përqindje 63.18% Organizata Islamik Relief Kosova” dhe 36.82% Komuna e Malishevës.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024



Bazuar në këtë memorandum Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me datë: 12.09.2024 me numër protokoli 08/253, ka hapur thirrjen për aplikim për këto projekte;

1. Serrë bujqësore për kultivim me sip. 50 m²



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

2. Serrë bujqësore për kultivim me sip. 100 m².
3. Moto-kultivator.
4. Frezë për traktor.
5. Spërkatëse për traktor.
6. Makina mbjellëse të grurit.
7. Makina mbjellëse të misrit.

Ky projekt nuk ka përfunduar dhe sipas kërkesës së organizatës “Islamik Relief Kosova” e cila në komunën tonë ka shtyrë aktivitetin deri në përfundim të projekteve nëpër komuna tjera. Në Komunën tonë janë përfunduar disa faza të projektit: Faza e aplikimit, pastaj faza e verifikimit të dokumenteve dhe tani ndodhemi në fazën e vizitave të fermerëve që e kanë kaluar fazën e verifikimit. Për vitin 2025 mbetet të vazhdohet faza e vizitave pastaj faza e përzgjedhjes së fermerëve përfitues dhe ndarja e paisjeve.

4. Përkrahja e fermerëve pjesëmarrës në panairin AgroKos

Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe këtë vit, sikurse vitin e kaluar ka bërë përkrahjen e fermerëve që kanë shprehur interesim për pjesëmarrje në panairin bujqësor AGROKOS. Panairi është mbajtur më 16 dhe 17 tetor 2024 dhe nga komuna jonë kanë marrë pjesë 3 fermerë me prodhimet e tyre – arra, mjaltë dhe me perime të konzervuara.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Vlera e përkrahjes së fermerëve në panair është **1,793.60 €**



AKTIVITETET E REALIZUARA NGA DBPZHR - 2024

Drejtorja e Bujqësisë për këtë periudhë të punës përveç aktiviteteve që ka pasur në pritjen e palëve, pranimin e kërkesave nga ana e fermerëve, përgjigjen e ankesave, përgatitjen e vertetimave për viza turistike për ata fermer që merren me bujqësi, regjistrimin e fermerëve në programin e AZHB-së dhe lëshimin e NIF – it (numri identifikues i fermerit), konsultime me fermerët të cilët nuk kanë



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

pasur njohuri rreth bujqësisë, mënyrës së aplikimeve për subvencione dhe sqarime rreth procedurave të aplikimit, DBPZHR-ja ka kryer edhe punë të tjera si më poshtë:

1. Thirrja për aplikim për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, therrjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e dytë 2023.

Prej datës 15.01.2024 deri me datë 13.02.2024 ora 16:00 stafi i Drejtorisë së Bujqësisë ka qenë i angazhuar në aplikimin e fermerëve për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, viqave për majmëri dhe therrjet e raportuara të gjedhit për gjashtëmujorin e dytë 2023, që i ndanë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Gjatë kësaj periudhe në Drejtorinë tonë për këtë masë kanë aplikuar 43 fermerë.

2. Shpërndarja e mekanizmit bujqësor nga Aneks kontrata për furnizim me Mekanizëm Bujqësor

Në kuadër të zhvillimit të bujqësisë, lavërtarisë, pëmëtarisë, vreshtarisë dhe perimtarisë, Komuna e Malishevës, respektivisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural bërë përkrahjen e fermerëve me Mekanizëm Bujqësorë nga Aneks kontrata për Mekanizëm



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Bujqësor të datës 14.12.2023 me numër protokoli 03/618. Nga kjo Aneks Kontrat për mekanizëm bujqësor kanë përfituar 9 fermerë aplikues në shpalljen publike të datës 01/08/2023 menumër të protokolit 08/761.

Këta fermerë kanë përfituar këtë lloj të mekanizmit:

1. Spërkatëse 400 litra 1 copë
2. Shpërndarëse të plehut kimik 350L 1 copë
3. Freza 1.6 m 7 copë

Në këtë projekt Komuna e Malishevës ka kontribuar me 70% të shumës së paisjeve bujqësore, kurse fermeri ka participuar me 30% të shumës.

Vlera e përgjithshme e këtij projekti - aneks kontrate është 7,790.00 €.

Shpërndarja e mekanizmit është bërë më 12.03.2024.

3. Thirrja për aplikim për pagesa direkte për vitin 2024

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka hapur thirrjen për aplikim për të gjithë fermerët e interesuar që të aplikojnë për mbështetje përmes Programit për Pagesa Direkte për vitin 2024.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Këto procedura të aplikimit kryhen në Drejtorin e Bujqësisë Malishevë, nga stafi i drejtorisë, ku i gjithë stafi merret me procedurat e publikimit të thirrjes, përgatitjen e dokumentacionit, sqarime të fermerët rreth procedurave për aplikim, si dhe digjitalizimin e parcelave të mbjellura.

Përkrahja jepet për këto kultura dhe aktivitete bujqësore: për sipërfaqet e mbjella me grurë dhe sasinë e prodhuar/ dorëzuar të grurit, për sipërfaqet e mbjella me farë të grurit, për sipërfaqet e mbjella me elb, për sipërfaqet e mbjella me thekër, për sipërfaqet e mbjella me tërshërë, për sipërfaqet e mbjella me misër, për sipërfaqet e mbjella me lulediell, për vreshtat ekzistuese, për verën e prodhuar dhe të deklaruar zyrtarisht, për pemishtet ekzistuese, për sasinë e dorëzuar/ shitur të frutave të mjedrës, për primin e sigurimit bujqësor për kulturën bujqësore të mjedrës, mollës, kumbullës, rrushit, dredhëzës, specit, arrës fasulës, misrit, qershisë, vishnjës dhe dardhës si dhe primin e sigurimit bujqësor tradicional (breshër), për kulturën bujqësore të mollës - pemishtet intensive, kulturën e specit - kultivimi intensiv dhe rrushin e verës, për prodhimtarinë e materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit, për sipërfaqet e mbjella me perime, për prodhimtarinë organike, për bimët mjekësore dhe aromatike, për lopë dhe buallica qumështore, për dele dhe dhi qumështore, për bletë, për pula vojse, për dosa për riprodhim.

Periudha e aplikimit: Aplikimi ka zgjatur 30 ditë kalendarike, ka filluar nga data 13.03.2024 dhe ka përfunduar me date 12.04.2024 deri në orën 16:00. Mirëpo me vendim të Ministrisë është shtyer afati për aplikim deri më 29.04.2024. Gjatë kësaj periudhe të aplikimit për Pagesa Direkte për vitin 2024 në Komunën e Malishevës kanë aplikuar 963 fermerë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

4. Dëmet në Bujqësi të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore elementare

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi, komuna ka formuar komisionin profesional për vlerësimin e dëmeve në teren.

Komisioni komunal ka përgjegjësi të:

- Pranimin e kërkesës nga ana e fermerit/ës;
- Verifikimin e gjendjes faktike në teren i shoqëruar me procesverbal dhe i nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit;
- Përgatitja e raportit të vlerësimit për secilin fermer/e, si dhe dokumentet e bashkëngjitura në vijim:
 - a) Kërkesa e fermerit-ës;
 - b) Procesverbali i komisionit komunal për konstatimin e gjendjes në teren;
 - c) Fotot nga terreni;
 - d) Kopja e letërnjoftimit të fermerit-ës;
 - e) Kopja e llogarisë bankare e fermerit-ës;
 - f) Deklaratë nën betim/ zotim për saktësinë e të dhënave të prezantuara gjatë procesit të vlerësimit të dëmeve.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Në Komunën e Malishevës kemi pasur dëme nga fatkeqësitë natyrore elementare gjatë muajit prill, ku ka shkaktuar dëme në bujqësi.



Foto nga tereni gjatë vlerësimit të dëmeve nga ngricat pranverore.

Sektori më i dëmtuar ka qenë ai i pemëtarisë, ku sipas verifikimit nga ana e komisionit në Komunën tonë, dëme nga fatkeqësitë natyrore elementare kanë pasur 9 fermerë si kultivues të kulturave pemëtare, dhe serave si dhe është përgatitur raporti i vlerësimit për secilin fermerë si dhe raporti përfundimtarë, dhe njëkohsisht janë dorzuar te Komisioni qendrorë i formuar nga Qeveria e Kosovës për shqyrtim dhe kompenzim të dëmeve.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Vlera e përgjithshme e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare ka qenë: **21,287.96 €uro**. Kemi pasur edhe kërkesa për dëme të shkaktuara nga zjarri në kulturat bujqësore, mirëpo këto dëme nuk kompenzohen nga komisioni qeveritar për dëme elementare në bujqësi.

5. Planifikimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2024

Në këtë vit sipas shënimeve të grumbulluara nga terreni në Komunën tonë kanë qenë të planifikuara të mbillën me kultura pranverore afër 1,569.00 ha. *Tabela 1: Struktura e planifikuar e mbjelljeve pranverore*

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e planifikuara ha
1	Misër për kokërr	1205
2	Misër i gjelbërt (për sillazh)	85
3	Tërshërë	108
4	Elb Pranveror	13
5	Thekër	11
5	Patate	57
7	Perime	72
8	Bimë Foragjere	18
9	Fasule Monokultur	--



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

6. Realizimi i planit për mbjelljet pranverore për vitin 2024

Në këtë vit sipas shënimeve të grumbulluara nga tereni në Komunën tonë janë mbjellë me kultura pranverore afër 1,803.00 ha.

Tabela 2: Struktura e realizuar e mbjelljeve pranverore

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e realizuara ha
1	Misër për kokërr	1205
2	Misër i gjelbërt (për sillazh)	264
3	Tërshërë	108
4	Elb Pranveror	56
5	Thekër	11
5	Patate	57
7	Perime	72
8	Bimë Foragjere	18
9	Fasule Monokultur	12



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

7. Fushata e korrje-shirjeve për vitin ekonomik 2023/2024 në Komunën e Malishevës

Fushat e korrje-shirjeve në këtë vit në komunën tone ka filluar me datë 02.07.2023. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i ka bërë të gjitha përgaditjet e nevojshme në mënyrë që ky proces mjaft i rëndësishëm të shkoj mirë dhe të mos ketë pengesa, për këtë arsye është formuar shtabi komunal për korrje-shirje.

Shtabi komunal i formuar me anë të vendimit të Kryetarit në përbërje prej 5 anëtarëve, ka vizituar të gjithë mullinjët dhe pikat grumbulluese të grurit. Gjatë gjithë kohës sa ka zgjatur fushta shtabi komunal ka qenë në teren duke bërë inspektime duke vlerësuar për pjekurinë e grurit si dhe për lagshtinë e grurit, se a ka qenë në suazat e lejuara për korrje.

Në këtë vit në territorin e komunës sonë kanë qenë të mbjella me drithra të bardha rreth 3,268 ha, dhe këto sipërfaqe janë pritur që të korren gjatë kësaj periudhe.

Drejtori e Bujqësisë para fillimit të kësaj fushate i ka informuar autokombajnerët dhe i ka njoftuar lidhur me rregullat që duhet ti përmbahen si dhe rreth qmimit të rekomanduar për korrje-shirje nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e që ka qenë 130 €/ha.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024



Kushtet atmosferike të mira, kanë ndikuar që fushata e korrje-shirjeve të filloj me kohë. Këto kushte kanë ndikuar që rendimenti të jetë i mirë.

Rendimenti mesatar i grurit për këtë vit ka qenë rreth 5,500.00 kg/ha. Fushata e korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Malishevës zyrtarisht ka përfunduar me datë: 26.07.2024.

8. Thirrja për aplikim për pagesa direkte për vitin 2024

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural / Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë do të vazhdoj të mbështes sektorin e blegtorisë, sipërfaqes dhe rendimentit përmes pagesave direkte për qumësht/litër, therret e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri, zogjtë për majmëri (brojlerët), akuakulturë sasinë e dorzuar të grurit dhe pagesë të pjeshme për sasinë e plehut artificial të shpenzuar/përdorur për kulturat bujësore ashtu siç parashihet me programin e Pagesave Direkte 2024.

Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, për therret e raportuara të gjedhit, për viçat për majmëri, për akuakulturë, për zogj për majmëri (brojlerët), Subvencionimi për sasi-kg të grurit të dorëzuar, Subvencionimi i pjesshëm për sasinë e



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

plehut artificial të shpenzuar/përdorur gjatë kultivimit të kulturave bujqësore të pranuar: grurë, grurë për prodhimin e farës, elb, thekër, tërshërë, misër, luledielli, patate dhe fasule monokulturë. Aplikimit ka filluar më 01.08.2024 dhe ka përfunduar më 01.09.2024.

9. Planifikimi i mbjelljeve vjeshtore për vitin 2024

Në këtë vit, sipas shënimeve të grumbulluara nga tereni në Komunën e Malishevës planifikohen të mbillen 3,623.00 ha me kultura lavërtare siç janë:

Grurë = 3,453 ha, Tërshër Dimërorë = 56 ha, Thekër = 12 ha, Elb Dimërorë = 89 ha, Bimë Foragjere = 13 ha.

10. Realizimi i vizitave te fermerët gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024 në baza mujore janë vizituar fermerë të ndryshëm, vizitat janë të karakterit të ndryshëm si; vizita për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe zjarri, vizita me karakter informues, që të informohemi për nevojat që ka fermerët tanë, vizita monitoruese, etj.



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024



11. Realizimi i planit për mbjelljet vjeshtore për vitin 2024/2025

Sipas shënimeve të grumbulluara në terren gjatë muajit Nëntor dhe fillim të muajit Dhjetor rezulton se kemi një dallim të vogël në mes planit për mjellje vjeshtore dhe realizimit të mbjelljeve, ku kemi 2 ha më pak të mbjella. Kjo rënie është tek kultura e thekrës. Sipërfaqet e mbjella me: Grurë = 3,453 ha, Thekër = 10 ha, Tërshër = 56 ha, Bimë foragjere = 13 ha, Elb dimërorë = 89 ha

Gjithësej sipërfaqe të mbjella me kultura vjeshtore janë 3,621.00 ha.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

DREJTORIA I INSPEKTORATIT - DI

Në kuadër të Drejtorisë së Inspektoratit funksionojnë këta sektorë:

1. Sektori i Tregut
2. Sektori i Ndërtimit
3. Sektori i mbrojtës së Ambientit
4. Sektori i Komunikacionit
5. Sektori i Shërbimeve Publike

Drejtorja e Inspektoratit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 ka qenë e angazhuar në funksion të realizimit të planeve të saj të punës me të gjitha resurset e saj.

Disa nga punët e realizuara nga Drejtoria e Inspektoratit janë;

Drejtorja e Inspektoratit ka bërë inspektimin e terrenit në përgjithësi të të gjithë sektorët.

Ka bërë planifikimin e punëve për drejtori për vitin 2025, vlerësimin e punëtorëve për vitin 2024 si dhe Raportin e punës për drejtori për vitin 2024.

Ka bërë inspektimin e një objekti banesor pas disa ankesave të një qytetari-banuesi, pasi ka pas dyshime se investitori nuk është duke e zbatuar projektin dhe me këtë rast është vërejtur se në një pjesë të objektit nuk ka bërë respektim të projektit, dhe është dhënë urdhëresë për respektim të projektit sipas lejes së ndërtimit të lëshuar.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

-Ka bërë Rekomandim për Drejtorinë e Shërbimeve Publike për pastrimin e disa pikave ilegale të mbeturinave inerte dhe komunale, pasi që kemi konsideruar që është më urgjente, përkatësisht përkaj rrugës Banjë-Senik dhe në rrugën tranzite Banjë-Carrallukë si dhe në disa lokacione tjera.

-Po ashtu ka bërë edhe disa kërkesa tjera për disa pika tjera për pastrim të mbeturinave kryesisht të mbeturinave inerte.

-Me rastin e inspektimit në teren është vërejtur se në ish objektin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe QPS një qytetar ka filluar të bëjë demolimin e kulmit të objektit përkatësisht ka bërë heqjen e tjegullave dhe të një pjese të konstruksionit të drurit (lanëve), këtë demolim është duke e bërë pa pëlqim nga organet kompetente me këtë rast në bashkëpunim me Policinë e Malishevës kemi bërë ndërprerjen e mëtutjeshme të demolimit të kulmit.

-Kemi dërguar Ankesë në Gjykatën e Apelit për Kundërvajtje për një vendim lidhur me një rast të ndërtimit pa leje ndërtimore.

-Inspektim terreni pas kërkesës së DKA, në bashkëpunim me Policinë është bërë vëzhgimi rreth paralajmërimit të organizimit të shëtitjes së maturantëve në Brezovicë pa pëlqim komunal.

-Në bashkëpunim me Policinë e Malishevës janë inspektuar disa lokale -subjekte afariste në afërsi të shkollave të mesme dhe fillore në Malishevë dhe Kijevë

-Në bashkëpunim me zyrtarë të Drejtorisë së Gjeodezisë e kanë bërë vendosjen e pikëve gjeodezike të pronës publike prej rrethrotullimit deri tek ura e madhe në rrugën "Ibrahim Mazreku".

-Ka dhënë urdhëresa për pajisje me vendime për transport urban për k-taxi të cilët pretendojnë të zhvillojnë veprimtarinë e tyre.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

-Pasi janë përfunduar të gjitha procedurat administrative, në bashkëpunim Policinë e Kosovës, zyrtarë të drejtorisë së Gjeodezisë, me kompaninë e kontraktuar për rrënim, është e filluar nga ura e madhe në drejtim të rreth rrotullimit të bëhet lirimi i hapësirës publike përkatësisht rrënimin e objekteve nga hapësirat publike.

-Njëkohësisht në mënyrë vullnetare disa persona përgjegjës të disa lokaleve kanë bërë lirimin e hapësirave publike edhe në rreth rrotullim përkatësisht kanë bërë heqjen e terasave

-Pasi që punimet e projektit për parkingjet nëntokësore janë duke u zhvilluar me intensitet më të madh, në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike kanë zhvendosur vendparkimin e taxive prej rrugës “Skënderbeu” në rrugën “Adem Jashari” përkatësisht te stacioni i autobusëve.

-Në bashkëpunim me zyrtarë të gjeodezisë dhe Policinë e Malishevës kanë bërë vendosjen e pikave gjeodezike të pronës publike në të gjitha anët për rreth rrotullimit si dhe në rrugën “Imer Krasniqi” deri te rruga e transitit.

-Po ashtu, pas marrjes së disa informatave me foto se nga një automjet një qytetar i komunës së Rahovecit ka hedhur mbeturina inerte në pronë publike në rrugën Gurbardh-Turjak DI ka marr informatat se kush është ai qytetar dhe ka shqiptuar gjobën prej 200 €.

-Me rastin e ndotjes së ambientit përkatësisht të djegies së disa mbeturinave nga dy qytetarë në vende të ndryshme në Malishevë DI kanë shqiptuar gjobën me nga 200 € për secilin , po ashtu me rastin e djegies së mbeturinave në afërsi të shtëpive nga një qytetar në Kijevë ka shqiptuar gjobën prej 500 € për arsye se edhe ka bërë rrezikimin e përgjithshëm, po ashtu ka shqiptuar gjobë prej 200€ edhe për një qytetar i cili ka hedhur eshtra të shtazëve në hapësira publike.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Pas parashtrimit të kërkesave nga disa subjekte afariste kemi inspektuar dhe me këtë rast kemi lëshuar Pëlqime për disa subjekte afariste për plotësimin e kushteve minimale teknike që këto subjekte i plotësojnë për zhvillimin e veprimtarisë afariste.
- DI ka inspektuar vazhdimisht ndërtimet të cilat kanë Leje Ndërtimore se a janë duke e respektuar ndërtimet e zhvilluara sipas lejes së dhënë. Zakonisht inspektohet faza e ndërtimit para hedhjes së betonit në pllakë lidhur me respektimin e standardit të ndërtimit/hekurit (armaturës), po ashtu inspektohet edhe faza e betonimit të shtyllave të objekteve si dhe piketimet e objekteve.
- Janë shqyrtuar më shumë se 113 kërkesa të inspektimeve të ndërtimit, në lidhje me respektimin e standardit të ndërtimit.
- Po ashtu inspektime kanë bërë për parandalimin e ndërtimeve eventuale pa leje ndërtimore, ku është parë rast që një investitor ka bërë fillimin e ndërtimit të pent`hausit pa leje ndërtimore dhe DI ka vendosur paraprakisht shiritat dhe ka urdhëruar të bej respektimin e lejes ndërtimore.
- Kemi marrë pjesë në të gjitha fazat e rrënimit të objekteve me rastin e lirimit të hapësirave publike që është duke u bërë, në Malishevë
- Inspektime të terenit në tërë territorin e Malishevës janë bërë lidhur me hedhjen e mbeturinave si komunale ashtu edhe inerte.
- Ka bërë rekomandime të ndryshme kryesisht Drejtorisë së Urbanizmit dhe asaj të Shërbimeve Publike, kompanisë së ujësjellësit lidhur me deblokimin e kanalizimit si dhe për ndërrim të gypave të kanalizimit komplet në ato vende ku nuk ka mundësi të behet deblokimi.
- Ka bërë vërejtje dhe urdhëresa për disa persona përgjegjës të subjekteve afariste për marrjen e pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës në pronën publike në sheshin Ibrahim Mazreku.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Ka bërë inspektimin e vijave urbane në përgjithësi për të verifikuar se kompanitë transportuese a janë duke i mbajtur vijat e rregullta urbane të lejuara dhe me këtë rast ka hasur edhe në raste se nuk ju kanë përmbajtur vijave urbane të rregullta dhe DI ka shqiptuar gjoba mandatore për këto kompani transportuese.
- Po ashtu në kuadër të inspektimeve të transportit rrugor ka inspektuar edhe për veprimtari ilegale kryesisht për taxit ilegal si dhe veprimtarin e k-taxive pa pëlqime komunale ku në rastet ku kemi hasur duke bërë transport ilegal të udhëtarëve ju kemi shqiptuar gjobë mandatore disa personave përgjegjës të k-taxi-ve.
- Edhe këtë vit është inspektuar informaliteti në treg, kryesisht subjekte të cilat janë duke zhvilluar veprimtari afariste ilegale e që në këtë vit ka qenë gjendje shumë e mirë dhe në këtë aspekt, ka pas shumë pak raste ku kemi hasur në këso subjekte dhe me vërejtjen e dhen ata janë regjistruar.
- Në bashkëpunim me organet qendrore DI ka asistuar në asgjësimin e mallit të një subjekti afarist kryesisht të tekstilit.
- Është bërë orari i kujdestarisë gjatë gjithë vitit përkatësisht për çdo tre muaj me ndryshime të herë pas herëshme për barnatoret e qytetit të Malishevës.
- Janë inspektuar shumë subjekte afariste lidhur me kontrollin e mallrave ushqimore për skadencën e afatit, ruajtjen e përgjithshme të mallit, kontrollin e çmimeve kryesisht përputhjen e çmimit të tij raft-arkë
- Janë inspektuar furrat e bukës dhe atë për kontrollin e peshës së deklaruar të bukës. Janë shpërndarë disa Aktvendime të Taksës Komunale për subjekte afariste.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

-Gjithashtu janë inspektuar tregjet javore si ai i automjeteve, i kafshëve si dhe i përgjithshmi (gjelbëri) për mirëvajtjen e përgjithshme të tyre.

-Janë inspektuar të gjitha hapësirat publike në territorin e Malishevës me theks të veçantë janë inspektuar hapësirat publike të institucioneve arsimore, shëndetësorë si dhe hapësirat publike në fshatra, dhe në qytet.

-Është inspektuar gjatë gjithë vitit vazhdimisht hapësira publike në bulevardin Ibrahim Mazreku lidhur me shfrytëzimin e hapësirave publike nga personat përgjegjës të disa subjekteve afariste lidhur me lejimin shfrytëzimit të hapësirës nga subjektet për tavolinat shërbyese në periudhën verore si dhe shërbimet tjera, ku me rastin e inspektimeve kemi pas edhe raste që është bërë tentimi i shfrytëzimit të hapësirave pa pëlqim nga organet komunale dhe kemi bërë eliminimin e tyre si dhe ka pas raste që kemi shqiptuar gjopa mandatore. Zyrtarë të DI kanë marrë pjesë në komisione për hartimin dhe ndryshimin e rregulloreve të ndryshme komunale si dhe në komisionin për Përfundim Komunal.

-Janë inspektuar 13 objekte me Leje Ndërtimore të reja të filluara në këtë vit.

-Janë inspektuar 26 objekte të pajisura me Leje Mjedisore Komunale se a po zbatohen-respektohen masat mbrojtëse mjedisore të cekura në raportin mjedisor e që janë respektuar masat mbrojtëse të cekura në raport mjedisor.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Drejtoria e Inspektoratit gjithashtu ka lëshuar; Procesverbale, Aktvendime, Pëlqime, Vërtetime, shqyrtime të kërkesave-ankesave të natyrave të ndryshme, Gjopa mandatore, Kërkesa për gjykatë, Shkresa-Kërkesa policisë, etj.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTËR - DGJK

Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër, në përputhje me mandatin e saj ligjor ka arritur të realizojë pjesën më të madhe të objektivave të parapara për vitin 2024. Në fillim të kësaj periudhe janë vendosur në prioritet kërkesat dhe lëndët e papërfunduara gjatë vitit paraprak, shqyrtimi i të gjitha kërkesave brenda afatit të rregullt ligjor, thellimi i bashkëpunimit me të gjitha departamentet në Komunën e Malishevës si dhe organet tjera relevante në nivel qendror.

Janë bërë shumë reforma në infrastrukturen ligjore me anë të udhëzimeve administrative nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës të cilat kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e efikasitetit të punës në sektorin e gjeodezisë dhe kadastrit.

Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadaster brenda saj ka dy sektorë të cilët dallojnë për nga lloji i shërbimeve dhe lëndëve që janë kompetente për t'i shqyrtuar. Ka numër dhe lloje të ndryshme të kërkesave që kryhen në këtë drejtori si: kërkesa për ndërrim pronari, regjistrim dhe fshirje të hipotekave, kërkesa për ndarje dhe bashkim të parcelave, kërkesa tereni nga bashkësit lokale të fshatrave, kërkesa për rilevim të pronave publike, kërkesa për historiate të parcelave, si dhe kërkesa tjera shtesë nga departamentet tjera brenda administratës komunale.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Përshkrime të përgjithshme për fushën e veprimit të drejtorisë

- Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër kryen punë profesionale dhe shërbime tjera subjekteve të ndryshme, është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, sigurimin e hartave Orto-Foto, rikonstruimin të informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ mbi tokën dhe pronën;
- Planifikimi i rrjetit me pika të reja kontrolluese dhe themelimi i pikave të reja;
- Vektorizimi i planeve të skanuara-i ngastrave dhe zonave kadastrale;
- Azhurnimi i pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe të matjeve të reja;
- Ndarja e ngastrave dhe shënimi i kufinjeve në rastin e shpronësimit, kryen procedurat e përgatitjes së dokumentacionit rreth shpronësimit të tokës;
- Regjistrimi i pronës së paluajtshme në regjistrat e tokës;
- Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas detyrës zyrtare dhe zhvillon procedurat e regjistrimit sipas kërkesës së palëve;
- Bënë korrigjimin e regjistrit lidhur me regjistrimin e pronës sipas ligjeve në fuqi;
- Bënë azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara, azhurnimi i regjistrit të ndërrimeve të matjeve nga terreni;
- Regjistrimin e hipotekës;
- Regjistrimin e servituteve;
- Regjistrimin e pronës dhe të objekteve;



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Regjistrimin e pronës së dhënë në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër;
- Lëshon certifikata të pronësisë, kopje plani.

Objektivat e parapara për vitin 2024

Gjatë vitit 2024 sipas planit të punës kemi paraparë dhjetë objektiva, të cilat janë:

1. Zhvillimi i procedurave administrative për modifikim dhe plotësim të regjistrave kadastral me të dhënat që mungojnë si, tipi i pronës, numri personal i pronarit, lloji i shfrytëzimit, kultura apo atribut tjera, procedura që do të zhvillohen sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të palëve.;
2. Implementimi në regjistrat kadastral sipas Vendimit Përfundimtar Nr.03/197 datës 25.09.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës në kuadër të shpronësimit të sipërfaqeve për shtyllat e linjes 400kV projekti i KOSTT-it, në zonat kadastrale Balincë, Vermircë, Shkarashnik, Drenoc, Carrallukë, Mirushë, Dragobil, Burim dhe Gurbardhë në Komunën e Malishevës;
3. Regjistrimi i vendimeve të vjetra për ekspopojim të pronës në rrugët regjionale Malishevë-Kijevë, Malishevë – Arllat, Malishevë – Rahovec dhe Malishevë -Bllacë, aty ku nuk janë bërë ndryshimet sipas lëndëve dhe regjistrave për zgjerimin e rrugëve;
4. Përgatitja e lëndëve të cilat janë në shqyrtim në Asamble Komunale, dhe zhvillimi i procedurave lidhur me çështjet pronësore si: dhënia e pronës në shfrytëzim, këmbimi i pronës komunale me pronën private, parcializimin e pronës për ndonjë interes të përgjithshëm, përgatitja e lëndëve për shpronësim, etj;



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për matje, ingjizim, kërkesa për rilevim të pronave e rrugëve publike, kërkesa nga Kryetari, Drejtoria e Urbanizimit, Drejtoria e Inspektoratit, institucione tjera, policia, gjykata, bashkësitë lokale;
6. Puna në RDPP, shqyrtimi i të gjitha kërkesave që kanë të bëjnë me regjistrim të kontratave për bartje, dhurim të pronave, kontratave për bashkëinvestim, regjistrimi i hipotekave, barrave tatimore, vendimeve gjyqësore, regjistrimi i shënimeve të përmbarimit, regjistrimi i ndarjeve dhe bashkimit të parcelave, servituteve.

Realizimi i objektivave

Gjatë viteve paraprake në proces të punës së përditshme, kemi hasur në shumë raste që mungojnë disa attribute të cilat duhet t'i kenë regjistrat kadastral, si tipi i pronës, lloji i shfrytëzimit, e po ashtu edhe mos harmonizim të pjesës grafike dhe asaj tekstuale. Në këto rrethana kemi paraqitur si objektiv para vetes që të bëhën modifikimet e nevojshme në regjistrat kadastral, plotësimi i të dhënave bazuar në dokumentacionet që posedojmë dhe autorizimet ligjore që kemi.

Në takimet që kemi pasur me zyrtar të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSTT sh.a, në lidhje me regjistrimin e vendimeve perfundimtare për shpronësim dhe krijimin e të drejtës së servitutit, na është dorëzuar e gjithë lënda dhe të dhenat e nevojshme, që të procedojmë më tutje për të bërë regjistrimin e të drejtës së servitutit në Zonat Kadastrale brenda territorit të Komunës së Malishevës. Kjo me qëllim që të krijohet një siguri me e madhe gjatë ndryshimeve me prona që mund të ndodhin në teren.

Sa i përket regjistrimeve të vendimeve të vjetra për ekspoprijim për zgjerimin e rrugëve regionale, gjatë vitit 2024 e kemi paraqitur si objektiv por nuk kemi bërë shumë në këtë drejtim. Do të jetë një synim edhe në vitet e ardhshme por që është sfidë në vete duke marrë



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

parasysh mungesën e dokumentacioneve. Edhe gjatë vitit të kalaur ka pasur shumë çështje që janë trajtuar nga Kuvendi Komunal e që kanë pasur të bëjnë me pronën e paluajtshme, kështu që vazhdimisht kemi qenë në dispozicion për të ofruar informacione, dokumente dhe sqarime për anëtarët e kuvendit për çështjet që janë trajtuar.

Bashkëpunimi në mes organeve komunale ka qenë në nivel të kanqshëm, kemi shqyrtuar dhe realizuar shumë kërkesa që na kan ardhur nga Zyra e Kryetarit, Avokati i komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Inspektoratit, Policia dhe Bashkësitë Lokale. Të gjitha këto në interes publik me qëllim të realizimit sa më të mirë të projekteve komunale.

Njëra ndër objektiva ka qenë edhe përkushtimi në shqyrtimin e kërkesa të ndryshme që kanë të bëjnë me regjistrimin e të drejtave në regjistra kadastral. Ka qenë një numër i madh i kërkesave që kanë të bëjnë me regjistrimin e kontratave të shitblerjes, dhurimit, këmbimit, regjistrimi dhe fshirjen e hipotekave, barrave tatimore, vendimeve gjyqësore, regjistrimin e ndarjeve dhe bashkimit të parcelave, servituteve si dhe kërkesa tjera të ndryshme që kanë të bëjnë me regjistrat kadastral.

Konsiderojmë që kemi arritur një nivel të knaqshëm të përmbushjes se objektivave, duke shtuar këtu edhe punën e përditshme që kemi me palë në përpeje që t'i japim sqarimet dhe informacionet e nevojshme që ata kërkojnë.

Sektorët e drejtorisë - Në kuadër të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, puna dhe procedurat janë të shpërndara në dy sektor: sektori i gjeodezisë dhe sektori i kadastrës.

Spektori i Gjeodezisë - është sektori ku palët kanë mundësi që ta shohin gjendjen e pronave të tyre në pjesën hartë - grafike, të bëjnë kërkesa të ndryshme për ndarje, bashkim parcelash, matje të ndryshme, kërkesa për koordinata, korrigjime, barazime të pjesës grafike me pjesën tekstuale, paisijen me kopje plani, etj. Po ashtu ky sektor realizon bashkëpunime me drejtori tjera aty ku paraqitet nevoja që të bëhen incizime dhe konstatime në terren.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Pasqyrimi i punëve dhe numrit të kërkesavë të pranuar dhe shqyrtuara në sektorin e gjeodezizë:

Tabela Nr.1

Përiudha	Lloji i kërkesave									Totali për muaj
	Kopje plani	Koordinata	Historiate	Ndarje të ngastrave	Kërkesa fshati	Korrigjim sipas detyrave zyrtare	Përgjigje për kërkesa të ndryshme	Kërkesa zyrtare	Propozim për Urbanizëm	
Janar	4	30	0	0	0	6	1	0	4	45
Shkurt	22	16	1	0	1	2	0	2	11	55
Mars	13	20	3	0	2	0	0	0	2	40
Prill	10	23	0	2	1	0	1	0	0	37
Maj	9	30	2	1	0	0	0	2	2	46
Qershor	3	18	1	1	0	0	0	0	3	26
Korrik	1	13	1	2	1	3	2	0	2	25
Gusht	1	20	1	0	0	2	1	2	1	28
Shtator	12	17	1	2	0	4	1	0	4	41
Tetor	12	23	1	3	0	2	0	0	2	43
Nëntor	5	10	1	2	0	3	3	0	1	25
Dhjetor	13	23	0	0	2	3	1	0	3	45
Totali i kërkesave	105	243	12	13	7	25	10	6	35	456
Të hyrat €	580.00 €	5,644.00 €	210.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	6,434.00 €



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Sektori i Kadastrit

Ky sektor bënë pranimin e lëndëve të cilat kanë të bëjnë me regjistrime dhe ndryshime në regjistrat kadastral të cilat bëhen në bazë akteve të ndryshme juridike, vendimeve gjyqësore, vendimeve administrative apo kontratave të ndryshme, regjistrimi i hipotekave, servituteve, objekteve, etj.

Për secilin shërbim me udhëzime administrative dhe rregullore janë të parapara tarifat. Pasi zyrtarët e kadastrit pranojnë lëndën, e njëjta shqyrtohet nëse është e pakompletuar atëherë me shkrim njoftohet pala për plotësim lende dhe pas plotësimit merret vendimi për aprovim, për ndryshimet e nevojshme në regjistra.

Po ashtu ky sektor lëshon dokumente të ndryshme kadastrale si certifikata të pronës, certifikatë që nuk posedon pasuri të paluajtshme.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Tabela 2, Pasqyrimi i punëve të shërbimi i kadastrit

Në këtë tabelë është pasqyruar numri i kërkesave dhe i dokumentacioneve të lëshuar përgjatë këtij viti, siç janë: Fleta poseduese, Fleta poseduese për nevoja zyrtare, për raste sociale, Certifikata që nuk posedojnë pronë, Certifikata që nuk posedon pronë për raste sociale, si dhe të hyrat e realizuar nga këto shërbime.

Muaji	Fleta poseduese		Fleta posduese zyrtare		Fleta posduese për rastet sociale		Certifikata që nuk posedon pronë		Certifikata që nuk posedon pronë-rastet sociale		Gjithsejt	
	Dok.	Të hyrat	Dok.	Të hyrat	Dok.	Të hyrat	Dok.	Të hyrat	Dok.	Të hyrat	Dok.	Të hyrat
Janar	67	268.00 €	18	0.00 €	0	0.00 €	17	51.00 €	93	0.00 €	195	319.00 €
Shkurt	60	240.00 €	88	0.00 €	1	0.00 €	17	51.00 €	109	0.00 €	275	291.00 €
Mars	49	196.00 €	30	0.00 €	2	0.00 €	20	60.00 €	122	0.00 €	223	256.00 €
Prill	35	140.00 €	57	0.00 €	1	0.00 €	10	30.00 €	145	0.00 €	248	170.00 €
Maj	40	160.00 €	36	0.00 €	0	0.00 €	10	30.00 €	83	0.00 €	169	190.00 €
Qershor	26	104.00 €	17	0.00 €	1	0.00 €	7	21.00 €	63	0.00 €	114	125.00 €
Korrik	47	188.00 €	25	0.00 €	0	0.00 €	12	36.00 €	70	0.00 €	154	224.00 €
Gusht	60	202.00 €	28	0.00 €	0	0.00 €	21	30.00 €	60	0.00 €	169	232.00 €
Shtator	218	436.00 €	30	0.00 €	3	0.00 €	8	8.00 €	61	0.00 €	320	444.00 €
Tetor	51	102.00 €	56	0.00 €	1	0.00 €	17	17.00 €	119	0.00 €	244	119.00 €
Nëntor	47	94.00 €	42	0.00 €	2	0.00 €	26	26.00 €	87	0.00 €	204	120.00 €
Dhjetor	58	116.00 €	1	0.00 €	53	0.00 €	14	14.00 €	99	0.00 €	225	130.00 €
Totali:	758	2,246.00 €	428	0.00 €	64	0.00 €	179	374.00 €	1111	0.00 €	2540	2,620.00 €



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Tabela 3, Numri i lëndëve dhe kërkesave sipas sistemit SIKTK - Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri dhe lloji e lëndëve sipas Sistemit të Informacioneve Kadastrale të Pronës në Kosovë (SIKTK), që është në përdorim nga të gjitha Zyret Kadastrale Komunale në nivel vendi.

RAPORTI VJETOR PËR LËNDËT NË SIKTK 2024					
Lloji i lëndës	Komuna	Total	Lëndët e Aprovuara	Lëndët e Refuzuara	Lëndët e Procesuara
Bartja e posedimit - Ndarje fizike	Malishevë	3	3	0	0
Bartja e posedimit - Blerje	Malishevë	191	188	3	0
Bartja e posedimit - Dhurim	Malishevë	143	140	1	2
Bartja e posedimit - Këmbim	Malishevë	3	3	0	0
Bartja e posedimit - Shpronësim	Malishevë	1	1	0	0
Bartja e posedimit - Trashëgimi	Malishevë	53	52	1	0
Bartja e posedimit - Vërtetim pronësie	Malishevë	230	228	1	1
Bartja e posedimit Aktgjykim dhe fitime tjera	Malishevë	28	25	3	0
Bartja e pronësisë - Këmbimi	Malishevë	1	1	0	0
Bartja e pronësisë - Trashëgimia	Malishevë	1	1	0	0
Bartja e pronësisë - Vërtetim pronësie	Malishevë	11	10	1	0
Bashkimi	Malishevë	71	68	3	0
Bashkimi i personave të njëjtë me ID të ndryshëm	Malishevë	26	25	1	0
Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit	Malishevë	41	38	1	2
Fshirja e ngarkesave tjera	Malishevë	1	0	0	1



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK	Malishevë	5	5	0	0
Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të gjykatës	Malishevë	1	1	0	0
Fshirja e njësisë Kadastrale	Malishevë	1	0	0	1
Fshirja e Servitutit	Malishevë	2	2	0	0
Modifikimi atributive të parcelës	Malishevë	70	68	2	0
Modifikimi i atributive të pjesës së ndërtesës	Malishevë	1	1	0	0
Modifikimi i qiramarrjes	Malishevë	1	0	1	0
Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale	Malishevë	28	21	7	0
Modifikimi i të drejtave	Malishevë	2	2	0	0
Ndarja	Malishevë	217	212	4	1
Ndarja e pjesës së ndërtesës	Malishevë	1	0	1	0
Regjistrimi i hipotekës	Malishevë	48	43	5	0
Regjistrimi i ndërtesës	Malishevë	11	11	0	0
Regjistrimi i ngarkesës tatimore	Malishevë	8	7	1	0
Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës	Malishevë	3	3	0	0
Regjistrimi i qiramarrjes	Malishevë	8	8	0	0
Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit	Malishevë	8	7	1	0
Regjistrimi i vërejtjes me kërkesë të palës	Malishevë	10	7	3	0
Regjistrimi i vërejtjes me vendim të gjykatës	Malishevë	2	2	0	0
Regjistrimi i vërejtjes sipas kërkesave tjera	Malishevë	3	3	0	0
Totali i të hyrave nga SIKTK: 108,952€	TOTALI	1226	1178	40	8



Republika e Kosovës
Republic of Kosova




Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Bazur në të dhënat e paraqitura më lartë konstatohet që viti 2024 ka qenë një vit me mjaftë angazhime dhe me një vëllim të madhë të punë. Si rezultat i këtyrë angazhimevë nga të gjithë sektorët janë shqyrtuar një numër i madhë i kërkesave si dhe janë realizuar të hyra të konsiderueshme. Numri total i kërkesave dhe të hyrave për vitin 2024:

1. **4222** kërkesa të ndryshme, për pajisje më dokumentacion, Certifikata të Pronës, kopje plani, Certifikata që nuk posedon pronë, kërkesa për regjistrime të ndryshme në sistemin kadastral, regjistrimi i kontratave për shitblerje, dhurim, regjistrime të hipoteka, e kërkesa të ndryshme të paraqitura në tabelat e mësipërme.
2. **118,006.00 € (euro)**, të hyra të realizuara gjatë vitin 2024, si rezultat i numrit të madh të shërbimeve të ofruara nga kjo drejtori. Me anë të tabelave grafike të mëposhtme kemi paraqitur një krahasim të punëve gjegjësisht kërkesave dhe të hyrave të realizuara ndër vite. Tabela Nr.4





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo




Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Tabela Nr.5 Krahasimi i të hyrave ndër vite

Në tabelën e mëposhte kemi paraqitur një krahasim të të hyrave në 8 vitet e fundit.



Këto janë aktivitetet dhe punët e realizuara gjatë kësaj periudhe.

Kjo drejtori mbetet e përkushtuar në rritjen e efikasitetin në punë dhe ofrimin e shërbimeve në afatin optimal kohor.



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

DREJTORIA E PRONËS

Përmes këtij raporti të punëve të realizuara gjatë periudhës kohore Janar-Dhjetor 2024 do të pasqyrohet e tërë puna e cila është zhvilluar në Drejtorin e Pronës. Gjatë kësaj periudhe kohore janë kryer, pranuar shkresa të ndryshme: janë pranuar Aktvendime të ndryshme, Kërkesa, Ankesa, Deklarata, Procesverbale, Konstatime, janë kryer Aktvendime të ndryshme: Aktvendime për heqjen dorë nga paluajtshmëria private, Aktvendime për uzurpime, Procesverbale tereni, Përgjigje në kërkesa, janë përcjellë Ankesa për Agjencionin Kadastral të Kosovës, është pranuar Konstatim nga Drejtoria Kadastrit.

Gjat kësaj periudhe kohore janë nxjerrdhe pranuar: Aktvendime, Kërkesa, Ankesa, Përgjigje, Konstatime, Procesverbale, Deklarata, Njoftime, etj.

Në tabelën e më poshtme gjeni numrin e lëndëve të trajtuara.

Procesverbale tereni për ekzekutimin e aktvendime për uzurpim	16
Procesverbal në lidhje me uzurpimin e pronës publike në Malishevë	2
Aktvendime në lidhje me uzurpimin e pronës publike në Malishevë	2
Aktvendime plotësuese	4



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Aktvendime nga Gjykatat në lidhje me uzurpimet e pronës publike në Malishevë	4
Aktvendim për faljen e pronsis private në Malishevë	2
Aktvendim i pranuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës	2
Kërkesa për marrjen e kopjeve të lëndëve të vjetra	23
Kërkesa për marrjen e kopjeve të lëndëve të uzurpimeve në Malishevë	2
Kërkesë drejtuar Avokatit të Komunës, në lidhje me kallzim penal për uzurpimin e pronës publike	1
Kërkesa për marrjen e kopjeve të lëndëve të trojeve ndërtimore	9
Përgjigje janë nxjerrë në lidhje me kërkesat	33
Ankesa në lidhje me uzurpimin e pronës publike	3
Shkresa përcjellëse në lidhje me ankesat për uzurpimin e pronës publike	4
Njoftim për Drejtorinë e Kadastrit për daljen në teren lidhjen me uzurpim në Malishevë	



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT - DKRS

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN JANAR - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Në vitin 2024, janë zhvilluar një sërë aktiviteteve kulturore dhe rinore në të mirë të zhvillimit të rinisë dhe kulturës në komunën e Malishevës. Përveç bashkëpunimit me OJQ-të lokale, kemi bashkëpunuar edhe me institucione të tjera të rëndësishme si Departamenti i Rinisë, Kulturës dhe Sportit i Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Instituti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore-Prizren, OSBE, dhe kjo ka ndikuar edhe në zhvillimin e aktiviteteve kulturore e rinore në komunën tonë.

Fokus i punës sonë ka qenë zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme, si vullnetarizmi, organizimi i Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës”, Festivali “MALFEST” aktivitete për shënimit të datave historike, pasurimi i bibliotekave të shkollave, mbështetja e krijuesve letrarë duke i ndihmuar ata në organizimin e përrurimeve të librave të tyre, organizimi i turnireve sportive, aktivitete rinore, etj.

Në fillim të muajit janar kam përgaditur dhe dorëzuar planin e punës të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2024 dhe kam dorëzuar raportin një vjeçar të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2023.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Së bashku me zyrtarin e kulturës Mehdi Krasniqi, kemi vizituar disa objekte të Trashëgimisë Kulturore me qëllim të informimit të pronarëve, poseduesve dhe shfrytzuesve të asetit të Trashëgimisë Kulturore që janë në Mbrojtje të Përkohshme të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2024/2025.

Gjatë kësaj vizite kemi takuar pronarët e aseteve , përfaqësuesit e fshatrave dhe kemi shpërndarë disa njoftime informuese për përgjegjësitë ndaj aseteve të trashëgimisë kulturore, bazuar në Ligjin Nr. 02/L-88 PËR TRASHËGIMIN KULTURORE.

Bashkë me zyrtarin e kulturës Mehdi Krasniqi kemi pritur përfaqësuesit nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore - Prizren, ky takim u realizua me qëllim të dorëzimit të kopjeve të njoftimeve informuese të pranuar dhe nënshkruara nga pronarët dhe përfaqësuesit e fshatrave në lidhje përgjegjësitë e pronarëve dhe shfrytëzuesit të aseteve të trashëgimis kulturore që janë në mbrojtje të përkohshme.

Në këtë takim u informuam se çdo vit nga Qendra Rajonale e Trashëgimis Kulturore do pranojm njoftime informuese për listën e aseteve tjera që janë në mbrojtje të përkohshme dhe të njëjtat do të pranohen nga poseduesit, pronaret dhe përfaqësuesit e aseteve.

Në janar, kemi filluar me përgaditjet për “Flakën e Janarit” , kemi konkretizuar agjendën e programit në tërësi dhe kam përgatitur ftesat. Shënimi i Flakës së Janarit- sipas agjendës janë vënë vënë buqeta me lule te vendi i rënies, më pas Homazhe dhe nderime te varri i dëshmorit Hysni Mazreku-Malishevë dhe Homazhe dhe nderime te varri i dëshmorit Ali Kryeziu – Bubavec.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Gjithashtu, për të nderuar “Flakën e Janarit” kemi organizuar konkurs në poezi dhe orë letrare në Sallën e Kuvendit Komunal.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN SHKURT - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Në muajin shkurt, kemi nisur përgatitjet dhe planifikimin për shënimin e 16-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Kemi diskutuar për mënyrën e shënimit të kësaj dite, si dhe kemi konkretizuar agjendën aktivitetëve për shënimin e kësaj dite.

Kemi bërë shpërndarjen e ftesave dhe agjendën e aktivitetëve me rastin e shënimit të 16-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës , ftesat i kemi shpërndarë te Stacioni Policor në Malishevë, Shoqatat e dala nga Lufta e UÇK-së dega në Malishevë, Kryqi i kuq, HANDIKOS, LMT KFOR, QKMF, Shoqata e Pensionistëve, Bashkësia Islame, etj.

Më 17 shkurt, është shënuar 16-vjetori i Pavarësisë së Kosovë, aktivitetet kanë filluar sipas agjendës mbledhja solemne më pas nderime para Shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në Malishevë, homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe në Kleçkë, vizitë në Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz.

Gjithashtu, kemi organizuar edhe trasnportin dhe drekë për familjet e dëshmorëve.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Në Qendrën e Komptencës “Kujtim Krasniqi” është mbajtur sesion informues për trashëgiminë kulturore të Kosovës që nga periudhat prehitorike-moderne. Ky projekt është i mbështetur nga MKRS në bashkëpunim me DKRS.

Në muajin shkurt për nder të shënimit të 16-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës është organizuar turnir Sportiv në Volejboll.

Më datë 15.02.2023, së bashku me Klubin e Volejbollit Malisheva, është organizuar turniri në Volejboll, për nder të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Turniri është organizuar në shkollën "17 Shkurti" në Banjë të Malishevës.

Në muajin shkurt për nder të shënimit të 16-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës është organizuar turnir Sportiv në Futboll ndërmjet institucioneve lokale. Në këtë turnir moren pjesë: Stacioni Policor-Malishevë, Komuna Malishevë, Gjimnazi “Hamdi Berisha” Bashkësia Islame, Shkolla Fillore “Ibrahim Mazreku”.

Fitues në këtë turnir ishin:

Vendi i parë - Stacioni Policor-Malishevë

Vendi i dytë - Komuna Malishevë



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Fituesit në fund u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport.

Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 60 Sportista, ndërsa numri i shikuësve 150.

Fituesit në fund u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjithashtu komuna e Malishevës së bashku me DKRS ka mbuluar shpenzimet e ushqimit për ekipet pjesëmarrëse.

Aty theksova se Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport vazhdimisht i ka përkrahur klubet sportive dhe aktivitetet sportive, por synohet që në të ardhmen kjo mbështetje të jetë edhe më e madhe.

Gjithashtu i urova të pranishmit për 16- vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 50 Sportista, ndërsa numri i shikuesve 200.

Në kuadër të shënimit të 16-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, nën përkujdesjen e kryetarit të komunës, është bërë përrurimi i tri veprave letrare të Mehdi Krasniqit: “Poetët s’kanë shtëpi”, “Unë guxoj me të dashtë- Io oso di amarti” dhe “Peng i kryefjalës”. Për librat folën Prof.Dr. Zymer Neziri dhe Prend Buzhala.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN MARS - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Më 1 mars, kemi nisur përgatitjet dhe planifikimin për shënimin e Epopesë së UÇK-së.

Është mbajtur takimi i parë me këshillin organizativ për shënimin e Epopesë së UÇK-së, në këtë takim të këshillit kemi diskutuar për mënyrën e shënimit të kësaj dite, si dhe kemi konkretizuar agjendën aktiviteteve për shënimin e kësaj dite.

Me 2 mars, kemi filluar me përgatitjet e agjendës dhe ftesave, më pas kemi bërë shpërndarjen e ftesave tek familjalet e dëshmorëve dhe në institucione në Komunën e Malishevës.

Më 5,6,7 mars, në kuadër të shënimit të manifestimit “Epopeja e UÇK-së”, kemi organizuar aktivitete të ndryshme. Aktivitetet kanë filluar me seancë solemne më pas janë bërë nderime pranë shtatores së Komandantit Legjendar “Adem Jashari” në Malishevë, homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe në Prekaz.

Aktivitetet e manifestimit “Epopeja e UÇK-së” janë përmbyllur me ndezjen e flakadanëve në kompleksin “Kodra e UÇK-së” në Ngucat.

Më 29 mars, kam përgaditur dhe shpërndarë agjendën dhe ftesat me rastin e shënimit të 24-vjetorit të masakrës së Burimit.

Më 31 mars, sipas agjendës është mbajtur një mbledhje përkujtimore dhe janë bërë homazhe në Kompleksin Memorial në vendin e ngjarjes (Vrella e Mëhillit) në fshatin Burim, dhe më pas homazhe të varrezat e martirëve në Dragobil.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara për shënimin e "Epopesë së UÇK- së", është organizuar turniri në futboll të femrave.

Ky aktivitet sportiv është organizuar në bashkëpunim me klubin e futbollit KFF "Malisheva", dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Në këtë turnir së bashku me zyrtarin e sportit Albert Morina dhe zyrtarin Arton Kafegjolli kemi qenë të pranishëm dhe kemi përcjellur për së afërmi këtë turnir. Pjesëmarrësit i përshënda dhe i urova ekipet pjesëmarrse në turnirin që është organizuar për nder të Epopesë së UÇK-së, që mbahet me 5-6 dhe 7 Mars.

Fituesit në fund u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjithashtu kemi mbuluar edhe shpenzimet e ushqimit për ekipet pjesëmarrëse.

Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 54 Sportista, ndërsa numri i shikuesve 100.

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara për shënimin e "Epopesë së UÇK- së", është organizua turniri në Ping Pong.

Ky aktivitet sportiv është organizuar në bashkëpunim me klubin e Ping Pongut "LLapusha", dhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Në këtë turnir morën pjesë 20 garues nga komunat te ndryshme: Malishevë, Skenderaj, Drenas dhe Klinë.

Në këtë turnir fitues u shpallen:



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

1.Tefik Ulluri

2.Bekim Kryeziu

3.Ali Krasniqi

Fituesit në fund u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport

Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 20 Sportista, ndërsa numri i shikuesve 30.

Gjatë këtij muaji në kuadër të aktiviteteve të drejtorisë, e kemi vizituar stadiumin e qytetit “Liman Gegaj” në Malishevë, me qëllim të njoftimit me punimet që janë duke u realizuar në stadiumin e qytetit, përkatësisht në ndërtimin e tribunave dhe zhveshtoreve në stadium të cilat janë në përfundim e sipër.

Kam realizuar takim me drejtorin e departamentit të infrastrukturës sportive në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku kemi diskutuar për projektet e nevojshme në komunën e tone, me theks të veçantë rëndësinë e stadiumit ndihmës në komunën e Malishevës.

Gjatë muajit mars kanë filluar garat komunale shkollore 2024. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, i ka përkrahur të gjitha aktivitetet sportive që janë pasqyruar në këtë raport. Numri i pjesëmarrësve të përfshirë në aktivitetet është rreth 300.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Me ftesë të Universitetit “Haxhi Zeka” të Pejës, kam marrë pjesë në takimin rajonal koordinues për implementimin e aktiviteteve, të cilat janë pjesë e memorandumëve të bashkëpunimit ndërmjet komunave, universitetit dhe forumit ekonomik rajonal Dukagjini (FERD). Në këtë takim është diskutuar lidhur me mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe universitetit, për trajnimin e zyrtarëve (nga dy për secilën komunë) për hartimin e projektpropozimeve, në mënyrë që komunat të kenë kuadro për të përgatitur projekte për aplikime në programe të ndryshme evropiane.

Bashkë me Karvanin e Shkrimtarëve për Fëmijë “Agim Deva” kam organizuar orë letrare në SHFMU “Rifat Berisha” në Berishë dhe në SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë. Në këto shkolla, anëtarët e karvanit bashkë me nxënësit kanë lexuar krijimet e tyre letrare, kanë diskutuar lidhur me librin dhe rëndësinë e leximit të librave, për aktivitetin e grupeve letrare të shkollave. Në fund të orëve letrare në të dyja shkollat janë dhuruar libra botime të shkrimtarëve për fëmijë.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN PRILL - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Janë mbajtur garat regjionale në futsall që është mbështetur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Së bashku me zyrtarin e sportit Albert Morina dhe Arton Kafexholli kam marrë pjesë në këto gara dhe kam bërë shpërndarjen e mirënjohjeve, kupave dhe medaljeve për shkollat fituese. Shkollat fituese në garat regjionale në futsall nga komuna e Malishevës kanë marrë pjesë në garat rajonale në Gjakovë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Si DKRS kemi filluar përgaditjet për organizmin e ditës së çlirimit të komunës së Malishevës që është më 16 qershor. Kemi bërë kërkesë për binë, zërim dhe elementet të tjera të cilat nevojiten për organizimin e 16 qershorit (akademinë solemne, ndarjen e çmimeve, konkurset pamore letrare e artistike si dhe organizmin e koncertit festiv që planfikohet të mbahet në Bulevardin “Ibrahim Mazreku” me artistë të mirënjohur).

Gjatë muajit prill kanë filluar garat regjionale shkollore në futsall, ku si Malishevë e kemi pasur nderin që garat regjionale të organizohen në komunën tonë.

Gjatë muajit prill kami organizuar aktivitete për librin. Kemi zhvilluar aksionin për pasurimin e bibliotekës së SHFMU "Ismail Qemali" të Bellanicës, bibliotekë kjo, që e pasuruam me 611 ekzemplarë librash të dhuruara nga autorë të ndryshëm, donatori Mentor Mazreku (i cili jeton në Gjermani) dhe libraria “Arbri” në Malishevë (me pronar Selajdin Mazreku). Në emër të shkollës librat i pranoi drejtori Xhevdet Zogaj.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN MAJ - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Kam zhvilluar takim me drejtorin e Departamentit të Rinisë pranë Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Xhevat Bajrami. Me drejtorin z. Bajrami kemi diskutuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet DKRS-së dhe DiR-it në të mirë të rinisë. E kam njoftuar për aktivitetet rinore që kemi planifikuar t'i realizojmë për këtë vit me OJQ-të rinore në komunën e Malishevës.

Në maj, kemi nisur përgatitjet dhe planifikimin për shënimin 16 Qershorit -Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Malishevës. Kemi konkretizuar agjendën aktivitetëve për shënimin e kësaj dite. Po ashtu kemi përgaditur dhe publikuar konkursin artistik në lëmin e artit pamor, letrar dhe muzikor. Kam pasur takim me këshillin organizativ të 16 qershorit

Gjatë këtij muaji kam pasur takime me disa nga përfaqësuesit e klubëve sportive ku është diskutuar për qështje të ndryshme sportive, kemi biseduar për vështërsit, me të cilat përballen këto klube sportive të cilat bëjnë gara në nivele të ndryshme garuse.

Së bashku me kryetarin e komunës z. Ekrem Kastrati kam marrë pjesë në garat e kupës së Kosovës në Atletikë e cila është mbajtur në stadiumin e qytetit "Liman Gegaj" në të cilën klubi i Atletikës Malisheva fitoi vendin e parë.

Kemi bërë përgatitjet për turnirin tradicional "Ibrahim Mazreku" në futboll të vogël që mbahet më 16 qershor.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Gjatë këtij muaji kam bërë pergaditjen të kontratave për të gjitha OJQ-të të cilat kan përfituar nga thirrja publike e cila është shpallur nga DKRS.

Gjatë muajit maj është mbajt turniri tradicional “Ngucati nderon dëshmorët” të cilin e e ka mbështëtur financiarisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN QERSHOR - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Kam takuar përfaqësues nga Qendra Rajonale e Trashëgimis Kulturore, konkretisht me drejtorin e QRTK-së z. Samir Hoxha dhe kemi bërë kërkesë për restaurimin e mullinjëve dhe aseteve të tjera me rendësi të veqant kulturore në komunën e Malishevës.

Më 15 qershor, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës, janë zhvilluar aktivitete kulturore dhe sportive.

Aktivitete të shumta janë zhvilluar për nder të Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës:

Orë letrare, ky aktivitet u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës, ku të pranishëm në këtë orë letrare ishin rreth 50 persona.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Konkurs në poezi, rezultatet janë shpallë gjatë orës letrare.

Gjithashtu, u mbajt edhe konkursi dhe publikimi i rezultateve në fushën e muzikës.

Më 16 qershor, shënimi i Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të komunës së Malishevës, ka nisur me vizitën dhe vendosjen e buqetave me lule te varrezat e Dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe Prekaz.

Është mbajtur aktiviteti “Marshojmë për Ditë të Çlirimit”, është mbajtur me të gjitha institucionet lokale nga komuna deri te varrezat e dëshmorëve në Malishevë.

Parakalimi i grupit të motoçiklistëve në qytet për nder të Ditës së Çlirimit.

Pas homazheve kemi vazhduar me mbledhjen solemne të Kuvendit Komunal, Akademën Përkujtimore, ndarjen e çmimeve tradicionale të kuvendit komunal, programin kulturor-artistik që është mbajtur në Bulevardin “Ibrahim Mazreku në Malishevë. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm të gjithë strukturat lokale, familjet e Dëshmorëve dhe musafir të shumtë brenda dhe jashtë vendit. Për të ndëruar këtë datë historike dhe për të pasuruar edhe më shumë këtë aktivitet me programin e tyre artistik ishin Ansambli “Dibra”, artisti Basri Lushtaku dhe artistë të ndrzshëm. Në këtë aktivitet të pranishëm ishin rreth 1000 pjesëmarrës.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Pas tubimit qendror kemi vazhduar me Bulevardin Ibrahim Mazreku, në të cilën kanë marrë pjesë këngëtar , Shoqëri Kulturore Artistike dhe grupe të ndryshme të muzikës, këngëtarë të njohur të vendit tonë. Gjatë kësaj mbrëmje, janë argëtuar rreth 3000 qytetarë të ndryshëm përfshirë të gjitha moshat.

Në mbrëmje është mbajtur koncert festiv për të rinjët, për nder të Ditës së Çlirimit dhe Dëshmorëve të komunës së Malishevës.

Për nderë të 16 Qershorit ditës së Çlirimit dhe ditës Dëshmorve të Malishevës në bashkpunim me klubin e futbollit të femrave “16 Qershori” është mbajtur turnir në stadimuin “Liman Gegaj” Malishevë, ku pjesëmarrës ishin 7 ekipe nga vende të ndryshme.

Ekipet fituese:

-Vendi i parë: Kff Deqani

-Vendi i dytë: Kff 16 Qershori -Malishevë

-Vendi i tretë: Kff Jakova

Për nderë të 16 Qershorit ditës së Çlirimit dhe ditës Dëshmorëve të Malishevës në bashkpunim me klubin e Ping-Pongut “Llapusha” është mbajtur turnir në palestrën sportive “Habib Zogaj” në Malishevë, ku pjesëmarrës ishin garues nga vende të ndryshme, në fund



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

të turnirit fitues i vendit të parë doli Afrim Veliu nga klubi i Ping-Pongut “Llapusha”, në fund fituesit u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Për nderë të 16 Qershorit ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës në bashkëpunim me klubin e Futsallit “Malisheva” është organizuar turnir në futboll të vogël për meshkuj në qendrën sportive “Fusha Jonë” në Lubizhdë ku pjesmarrës ishin 100 ekipe nga vend të ndryshme të Kosovës.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport i ka përkrahur të gjitha aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive që janë realizuar gjatë muajit qershor.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN KORRIK - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Gjatë këtij muaji me kërkesën tone dhe me aprovimin e kryetarit kemi nxjerrë vendimin për themelimin e këshillit organizativ për organizimin dhe manifestimin e Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës” që do të mbahet më 1 dhe 2 gusht 2023.

Gjatë këtij aktiviteti kemi paraparë edhe organizmin e panairit artizanal dhe së bashku me OJQ “Fatjona” kemi bërë të gjitha përgaditjet që panairi të mbahet më 1 dhe 2 gusht dhe që do ti paraprijë festivalit folklorik “Oda e Llapushës”.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Poashtu, në muajin korrik kam filluar përgaditjet edhe për festivalin rinor “MAL FEST” i cili do të organizohet për herë të parë në komunën tonë, së bashku me OJQ-të në komuën tonë dhe në bashkëpunim me biznese të shumta brenda dhe jashtë komunës sonë.

Gajtë këtij muaji kam qenë në takim me Drejtorin e kompanisë Golden Eagle në Suharekë, me të cilin kemi biseduar lidhur me organizmin e festivalit “MAL FEST” dhe kompania në fjalë ka qenë sponzori gjeneral i festivalit. Poashtu, takime kam pasur edhe me sponzoret e tjerë të festivalit, siç janë: Stone Castle, Kastrati, Kështjella etj.

Ky festival ka karakter rinor dhe do të përcjellët me aktivitete të tjera rinore, siç janë: ekspozita me fotografi, gara në rrjete sociale për fotografinë më të mirë. Gjithashtu, në këtë festival biznese të shumta do të jenë prezente me pijet dhe ushqimet e tyre. Ky festival do të mbahet në Bulevardin “Ibrahim Mazreku” me datë 3 dhe 4 gusht.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN GUSHT - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Me 1 gusht, krahas Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës”, për dy ditë është hapur edhe panairi me punë artizanale, i cili këtë është organizuar në hapsirat e oborrit të Muzeut të Qytetit në këtë panair janë prezantuar punimet e dorës në veshje, si dhe të ushqimeve tradicionale.

Panairi është organizuar nga shoqata e gruas “Fatjona” në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte afër 20 pjesëmarrës, ndërsa numri i vizitorëve ishte rreth 2600 vizitorë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Më 1 dhe 2 gusht, kemi organizuar Festivalin Folklorik “Oda e Llapushës” – edicioni i tetë, një festival me karakter garues gjithkombëtar, në këtë festival u prezantuan vlera të larta të folklorit shqiptar, ku morën pjesë rapsod të shumtë, Shoqëri kulturo-artistike, Ansamblet e këngëve dhe valleve nga të gjitha trevat shqiptare dhe diaspora.

Festivali filloi me defileun artistik, të grupeve, shoqërive kulturore-artistike, rapsodëve. Defileu ka nisur në orën 18:00, duke filluar nga Rruga “Hamdi Berisha” pranë KEDS-it deri te Bulevardi “Ibrahim Mazreku” në qendër të qytetit.

Nata e parë e festivalit filloi në orën 19:00, ku u prezantuan 12 pikët pjesëmarrëse përfshirë rapsodë, grupe, ansamble kulturore.

Në natën e dytë juria profesionale ka bërë ndarjen e çmimeve të fituese të festivalit.

Juria profesionale e cila përcjelli dy netë radhazi Festivalin Folklorik “Oda Llapushës” - edicioni IX , pasi dëgjoi me vemendje pikat muzikore të cilat u prezantuan në këtë festival, nga solistë, duete, trio, kuartete solistësh dhe grupe e ansamble nga hapsirat shqiptare.

Gjatë këtij muaji, më datë 3 dhe 4 gusht është mbajtur Festivali Rinor “MALFEST”. Ky festival është mbajtur në parkun e qytetit në Malishevë dhe gjatë këtyre dy ditëve kanë performuar artistë të ndryshëm, brenda dhe jashtë komunës sonë. Gjatë këtij festivali pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë edhe të shërbimit me pije dhe ushqim, në të cilën kanë qenë prezent sponsorët tanë.

Festivali ka pasur edhe karakter kulturor, është mbajtur një ekspozitë me disa nga ikonat e muzikës në Malishevë dhe është mbajtur një takim debatues për fotografinë në përgjithësi. Ky festival “MAL FEST” është mbajtur për herë të parë në komunën e Malishevës dhe në të ka pasur pjesëmarrës të shumtë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Në kuadër të festivalit “MAL FEST” është mbajtur një konkurs më fotografi të bukurive natyrore dhe të trashëgimisë kulturore të komunës së Malishevës. 3 vendet e para janë shpërblyer edhe me mjete financiare.

Gjithashtu, gjatë këtij muaji është mbajtur edhe organizimi për manifestimin e 25-vjetorit të Dëshmorëve të Kombit, Dita e Brigadës 121 “Kumanova” në fshatin Kleçkë.

Gjatë muajit gusht, së bashku me kryetarin e komunës z. Ekrem Kastrati dhe zyrtarët për sport kemi vizituar Klubin e Atletikës, konkretisht Atletin Grevist Bytyqi, i cili është atleti i parë që e përfaqëson Kosovën në Lojërat Paraolimpike “Parisi 2024”.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN SHTATOR - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Më 15 dhe 16 shtator 2024 e organizuar nga KVRL dhe mbështetur nga DKRS është mbajtur Kampi Rinor 2023. Në këtë kamp janë zhvilluar aktivitetet me karakter garues, lojëra të ndryshme dhe është mbajtur një ligjëratë nga përfaqësuesi i Kryqit të Kuq, z. Isuf Morina.

Është mbajtur Akademi Përkujtimore për të përkujtuar civilët e vrarë në masakrën e Gollubovcit. Po ashtu, janë bërë edhe homazhe te varrezat. Në komunën e Malishevës është festuar Dita e Rinisë dhe janë mbajtur aktivitete të shumta.

Është organizuar konkurs në poezi për të rinjë.

Konkurs në ese.

Konkurs në artin pamor.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Gjatë këtij muaji janë mbajtur ligjërata për parandalimin e bullizimit të rinjve të komunës së Malishevës. Aktiviteti në fjalë është mbajtur në shkollat e mesme të komunës së Malishevës. Ky aktivitet është mbajtur në bashkëpunim me Organizatën Joqeveritare rinore “Feniksi”.

Në muajin shtator është mbajtur akademi përkujtimore për masakrën e Gollubovcit. Gjithashtu, janë bërë edhe homazhe nderimi të varrezat e civilëve në Gollubovc.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN TETOR - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Gjatë këtij muaji së bashku me zyrtar të tjerë komunal kemi marr pjesë në aktivitetin e përzgjedhjes së tribunave dhe zhveshtoreve të reja në stadiumin e qytetit “Liman Gegaj” në Malishevë. Të pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe kryetari i komunës z. Ekrem Kastrati si dhe zëvendësministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit znj. Daulina Osmani.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport ka bërë organizimin e Akademisë Përkujtimore dhe është shfaqur program artistik me artistë të ndryshëm nga gjithë trevat shqiptare.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Gjatë muajit nëntor kam marrë pjesë në Konferencën për Rini “Dreamin Kosovo” që është mbajtur në Prizren. Në këtë konferencë me karakter rinor kanë marrë pjesë përfaqësues rinorë nga komuna të ndryshme të Kosovës, gjithashtu edhe përfaqësues rinorë ndërkombëtar. Organizatori i kësaj konference ka nderuar komunën e Malishevës me mirënjohje për kontributin e dhënë për rini.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN NËNTOR - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Gjithashtu, në këtë muaj kemi mbajtur ligjërata me të rinjtë e komunës së Malishevës për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës. Kjo ligjëratë është mbajtur në bashkëpunim me Organizata Joqeveritare rinore nga komuna e Malishevës.

Gjatë këtij muaji së bashku me zyrtarin për sport Arton Kafexholli dhe Albert Morina kemi marrë pjesë në aktivitetin, Turnirin Memorial “Drinor Berisha” i cili është organizuar nga Shkolla e Futbollit “FC Malisheva”. Në këtë turnir morën pjesë 7 klubet më të mira në kategorinë e kadetëve U17.

Kampioni i këtij turniri u shpallë “KF Llapi” nga Podujeva.

Nënkampion doli “FC Malisheva” Malishevë.

Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 140 Sportista, ndërsa numri i shikuesve 300.

Me rastin e festave të 28 Nëntorit, në aktivitetin i cili është organizuar nga kryetari Erion Veliaj në Tiranë, grupmoshat e reja të “Fc Malisheva” si dhe SHKA “Zëri Llapushës” morën pjesë në këtë aktivitet në të cilën përfaqësuan qytetin e Malishevës.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Kemi mbajtur aktivitete kulturore, rinore e sportive për nderë të 28 nëntorit. Fillimishtë kemi mbajtur seanc solemne në Asamblen Komunale. Gjithashtu, janë bërë edhe homazhe nderimi të Varrezat e Dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe Prekaz.

Në kuadër të festave të Nëntorit, kemi pajisur me rreth 1000 ekzemplarë librash bibliotekën e SHFMU "Hilmi Hoti" të Carallukës. Kjo shkollë kishte përgatitur një orë letrare në të cilën, poezitë e tyre i lexuan nxënësit e shkollës. Kjo bibliotekë është pajisur me libra dhe lekturë shkollore, falë kontributit të krijuesve letrarë nga komuna të ndryshme të Kosovës, librarisë "Arbri" në Malishevë dhe mërgimtarit z. Mentor Mazreku.

RAPORTI I PUNËS PËR MUAJIN DHJETOR - SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Organizuar nga Qendra e Rinisë dhe mbështetur nga DKRS, janë mbajtur ligjërata për vullnetarizmin në Qendrën e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" dhe në Gjimnazin "Hamdi Berisha". Në këtë ligjëratë të rinjtë janë njohur me mënyrën se si organizohet puna vullnetare dhe përfitimet nga kjo punë.

Në këtë muaj është mbajtur Orë letrare në bashkëpunim me SHKL "Tafil Kelmendi. Aktiviteti është mbajtur në sallën e asamblesë komunale.

Në këtë muaj, në bashkëpunim me Qendrën e Rinisë kemi organizuar aktivitet "Të rinjtë në zyret e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport". Të rinjtë kanë kryer praktikë njëditore në zyret e DKRS dhe janë njoftuar për së afërmi me punën njëditore të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Malishevës.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Gjatë këtij muaji kanë përfunduar punimet për renovimin e Palestrës Sportive “Habib Zogaj” në Malishevë. Është bërë ndërrimi i çatisë, i dritareve, izolimi i mureve të jashtme, ndriqimi i palestrës si dhe ngrohja e palestrës. Ky investim është bërë nga komuna e Malishevës në bashkëpunim me Fondin Kosovar për Efiqenc.

Në bashkëpunim me SHKL “Tafil Kelmendi”, më 3 dhjetor 2024, në komunën e Malishevës është organizuar ceremonina e ndarjes së Çmimit Vjetor “Dr.Tafil Kelmendi” dhe janë përruruar tri veprat letrare të autorit Rexhep Toplana. Në këtë aktivitet letrar kanë marrë pjesë krijues të shumtë letrarë nga komuna të ndryshme të Kosovës.

Gjatë vitit 2024, DKRS-sektori për kulturë është angazhuar në mbështetjen e aktiviteteve kulturore, dhe rinore, përkundër mundësive të vogla financiare që ka pasur.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME - DAP

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2024, duke ju falënderuar të gjithë stafit të saj profesional, ka arritur që të realizoj thuajse të gjitha aktivitete e saj të parapara në Planin e Punës, dhe kjo ka ndikuar që Komuna e Malishevës të shënojë një lëvizje pozitive në rankimin e Komunave lidhur me performancën në qeverisje.

Gjithashtu, DAP përveç detyrave të parapara në planin e punës, ka realizuar edhe disa aktivitete të tjera, si më poshtë:

Dërgimi i materialeve të nevojshme përmes e-maileve (Asambleja Komunale)

Hapja e e-maileve zyrtare për të gjithë zyrtarët komunalë.

Hartimi i planit për integritet, për çfarë edhe ka fituar edhe çmim nga institucionet qendrore.

DAP, aktivitetet e kryen në sektorin e gjendjes civile, zyrën e pritjes dhe në sektorin e prokurimit, ku për dy të parat keni raport të detajuar, ndërsa lidhur me zyrën e prokurimit keni një shtojcë të veçantë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Shërbimi i Gjendjes Civile

Shërbimi i Gjendjes Civile në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithëshme të KK të Malishevës edhe gjatë muajit Janar-Dhjetor 2024 i ka kryer shërbimet sipas kërkesave të qytetarëve në harmonizim me ligjet dhe rregulloret që aplikohen, Kërkesat janë kryer me kohë dhe gjithëherë janë zgjidhur sipas procedurës duke ju përmbajtur afateve ligjore.

Tani e japim e raportin e këtij shërbimi si vijon;

- Aktvendime për ndërrimin, përmirësimin e emrit apo të mbiemrit personal.....	42
-Aktvendime për regjistrim me vonës në LAL.....	218
-Aktvendime për regjistrime me vonës në LAV.....	60
Anulime të regjistrimeve në LAL.....	02



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

RAPORT I REGJISTRIMEVE DHE LËSHUARJES SË QERTIFIKATAVE NË SHËRBIMIN E GJENDJES CIVILE KK MALISHEVË PËR PERIODEN JANAR-DHJETOR- 2024

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Regjistrimet e reja në LAL	00	00		00	00	00	00	00	00	00	00	00	00
Regjistrimet e mëvon. në LAL	32	12	07	05	08	06	33	76	08	06	07	17	217
Regjistrimet e reja në LAM	82	57	42	51	52	13	19	99	24	28	29	68	564
Regjistrimet e reja në LAV	09	12	10	11	07	08	08	07	08	12	16	10	118
Regjistrimet e mëvon. në LAV	11	07	01	03	09	01	04	05	07	05	01	04	58
Çertifikata të Lindjes	2303	998	1025	1394	1406	1358	1783	3020	899	1029	753	1477	17445
Çertifikata Martesore	543	391	330	360	334	248	378	647	296	386	240	365	4518



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Çertifikata të Vdekjes	87	82	61	59	47	37	57	91	60	67	52	77	777
Çertifikata të Statusit Martesor	305	193	136	166	143	102	127	219	130	122	93	240	1976
Deklaratë për bashkësin familjare	306	213	179	158	211	157	138	181	783	298	139	135	4874
Çertifikatë e Shtetësisë	20	09	28	09	05	05	10	27	23	08	36	18	198
Çertifikatë e Vendbanimit	2912	280	233	206	144	153	227	209	199	180	160	164	5067
Ekstrakte të Lindjes	2666	1898	1549	1980	1580	1298	2114	2758	1321	1603	907	1417	21091
Vërtetim nga Arkiva	46	43	32	19	24	17	35	37	26	27	13	26	345



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

RAPORT I REGJISTRIMEVE DHE I LËSHUARJES SË QERTIFIKATAVE NË SHËRBIMIN E GJENDJES CIVILE KK MALISHEVË
PËR REGJISTRIMET E LINDJEVE, MARTESAVE DHE VDEKJEVE QË KANË NDODHUR JASHTË KOSOVËS PËR PERIODËN
JANAR- DHJETOR 2024

Muajt Regjistrimet	Jana r	Shku rt	Mars	Prill	Maj	Qersh or	Korri k	Gusht	Shtator	Tetor	Nënt or	Dhjet or	Total
Regjistrimet në LAL	25	17	10	16	11	12	51	148	08	23	02	44	367
Regjistrimet në LAM	04	02	00	00	06	02	04	11	00	04	01	07	41
Regjistrimet në LAV	01	01	02	03	01	00	03	08	01	02	01	04	27
Çertifikata e Lindjes	18	13	07	07	09	08	51	138	03	17	02	25	298
Çertifikata e Martesës	02	01	00	00	04	00	02	10	00	02	00	08	29
Çertifikata e Vdekjes	01	01	02	01	02	00	03	04	00	02	01	02	19



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Raporti nga Zyra e Pritjes:

Zyra e Kryetarit: Kërkesa 269, Vendime 666, Njoftime 49, Autorizime 27, Procesverbale 13, Raporte 56, Formular 6, Aplikacione 17, Propozime 7, Deklarata 12, Aktemerime 19, Projekte 18, Të ndryshme 172. **Gjithsej 1331.**

Vërtetime të dokumenteve nga origjinali: Gjithsesj 134

Asambleja Komunale - Gjithsej 477

Drejtoria e Administratës - Gjithsej 430

Drejtoria për Ekonomi dhe Financa – Gjithsej 1037

Zyra e Prokurimit - Gjithsej 68

Fatura të regjistruara - Gjithsej 831

Drejtoria e Urbanizmit - Gjithsej 565

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër - Gjithsej 505

Drejtoria për Inspektorat – Gjithsej 286

Drejtoria për Bujqësi – Gjithsej 769

Drejtoria për Shërbime Publike - Gjithsej 273

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim - Gjithsej 49

Drejtoria për Arsim dhe Edukim – Gjithsej 1646



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - Gjithsej 199

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Gjithsej 201

Në total gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, janë pranuar dhe proceduar 8733 lëndë nga zyra e pritjes.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM - DMSH

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe ka qenë bartëse e aktiviteteve në përgatitjen dhe menaxhimin e emergjencave në territorin e Komunës së Malishevës dhe e cila ka menaxhuar dhe koordinuar me sektorët mvarës në kryerjen e punëve dhe detyrave të parashtruara sipas Planit të Punës për vitin 2024, në përputhëshmeri me ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret që janë në fuqi. Të gjithë sektorët e kësaj drejtorie i kanë kryer punët dhe detyrat e parapara me kohë dhe me sukses.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur situata emergjente për të cilat ka pasur nevoj aktivizimi i KKMSH (komiteti komunal për mbrojtje dhe shpëtim).

Kjo periudhë karakterizohet me Raste Emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore, gjegjësisht vërshimeve dhe erërave të forta (stuhi) që kanë goditur territorin e Komunës së Malishevës në muajin Qershor duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në bujqësi, infrastrukturë dhe ekonomi familjare, bazuar në raportin e komisionit komunal për vlersimin e demëve nga FNFT, vlera e demëve është tejet e lartë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Vlenë të theksohet se si pasojë e këtyre rastëve emergjente, nuk ka pasur raste të humbjeve të jetës dhe as lëndime të rënda në njerëz.

DMSH po ashtu është angazhuar edhe në këto punë:

- Freskimi i Planit të Vlerësimit të Rrezikut për Territorin e Komunës së Malishevës me të dhëna të reja;
- Freskimi i Planit të Reagimit për Komunën e Malishevës me të dhëna të reja;
- Përgatitja dhe mbajtja e takimeve të Këshillit Komunal për Siguris në Bashkësi;
- Vijimi i trajnimeve profesionale të personelit të NjPZSH-së;
- Gatishmëria dhe menaxhimi i personelit të Drejtorisë gjatë Rasteve Emergjente;
- Përgatitja, implementimi dhe monitorimi i projektit për masat parandaluese ndaj etheve hemoragjike, (spërkatja selektive e zonave endemike gjatë mujait qershor dhe korrik 2024, e kryer nga firma e kontraktuara nga MBPZHR dhe komuna e Malishevës;
- Aktivizimin e Njësitit për Mbrojtje dhe Shpëtim për sezonin veror (vëzhgimin dhe shuarjen e zjarrit);
- Vazhdimi i punës në hartimin e POE për Komunën e Malishevës;
- Pjesëmarrja e personelit në Komisionin Komunal për Vlerësimin e Dëmeve konform QRK;
- Pjesëmarrja e personelit në meanxhimin të kontratave nga ZKA;
- Inspektimi i Rasteve Emergjente, hulumtimi i shkatërrimeve të rreziqeve nga FNFT;



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Janë këto aktivitetet, në të cilat ishte vënë fokusi i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe, gjë që edhe ka rezultuar që të mos kemi asnjë rast me fatalitet në popullatë dhe personelin e ekipeve reaguese.

Sektori i Planifikimit Emergjent

Edhe gjatë kësaj periudhe ka vazhduar të jetë elementi themelor në identifikimin e shkakëtareve të rrezikut, evidentimin dhe parandalimin e tyre, si dhe hartimin e planeve relevante operative emergjente.

Sektori i Planifikimit Emergjent, gjatë kësaj periudhe, ka kryer punët në:

- Freskimin e Planit të Vlerësimit të Rrezikut për territorin e Komunës së Malishevës me të dhëna të reja;
- Freskimin e Planit të Reagimit për Komunën e Malishevës;
- Inspektimin e Rasteve Emergjente;
- Përgatitjen e planprojekteve për marrjen e masave parandaluese ndaj rreziqeve për sezonin veror (zjarret, etheve hemorragjike etj.);
- Përgatitjen për mbajtjen e takimeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Menaxhimi i Projektit të Spërkatjes Selektive të Territorit të Komunës së Malishevës ndaj EHKK nga kompania e kontraktuar;
- Hartimi i planprojekteve (funsionalizimi i QOKE- instalimi i videokamerave në qytezën e Malishevës);
- Punimeve në hartimin e Planprojektit për zgjidhjen e problemit të kafshëve të braktisura për komunën e Malishevës;



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Menaxhimi i projekteve(kontratave);
- Hartimi i Planit për themelimin e ekipeve vullnetare nëpër fshatra nga lëmia e Zjarrëfikjes, Ndihmës së parë dhe Kërkim-Shpëtimit;
- Menaxhimi i rasteve emergjente (vërshime, shembje dheu, stuhi, operacion i kërkim-shpëtimit).

Spektori për Informim dhe Alarmim

Sa i perketë këtij sektori në mungese të personelit për informim dhe alarmim nuk është në funksion.

Megjithatë, edhe gjatë kësaj periudhe, është vazhduar të mbahen kontaktet e vazhdueshme me qendra tjera të alarmimit të të gjitha niveleve të Kosovës-QRAKE dhe QNAKE.

Spektori i Preventivës ndaj zjarrit dhe hulumtimit

Gjatë kësaj periudhe sektori i preventivës ndaj zjarrit ka qenë elementi themelor në gjetjen dhe hulumtimin e shkaktarëve të zjarreve në Komunën e Malishevës, sipas planprogramit të punës për vitin 2025, duke kryer këto aktivitete nga fushëveprimi i mbrojtjes nga zjarri:

- Inspektive të rregullta në objekte publike dhe private;
- Dalje në vende të ngjarjes për hulumtimin e shkaqeve të shpërthimit të zjarrëve,
- Lëshimi i pëlqimeve për mbrojtje nga zjarri në dokumentacionin investivo-teknik për ndërtimin e objekteve;



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

- Gjatë kësaj periudhe janë kryer inspektime të rregullta në objekte të impianteve për shitjen e derivateve të naftës dhe butan gazit, objekte industriale, hotele, qendrave tregtare, lokaleve afariste, institucioneve shkollore dhe shëndetësore;
- Në bashkëpunim me hetuesit e stacionit policor kemi dalë në vendet e ngjarjes për hulumtimin e shkaqëve të shpërthimit të zjarrit;
- Në institucione komunale është bërë verifikimi i aparateve për shuarjen e zjarreve, propozimi për plotësimin e aparateve shtesë dhe servisimin e aparateve ekzistuese.

Njësi për Zjarrëfikje dhe Shpëtim (NjPZSH)

NjPZSH gjatë kësaj periudhe ka kryer detyrat sipas përshkrimit të vendeve të punës, Planit të Punës, Rregullores së NjPZSH dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushëveprimtarin e NjPZSH-së duke aplikuar standardet e kërkuara.

Me sukses janë arritur objektivat, qëllimi kryesor i të cilave ka qenë luftimi i zjarrit dhe mbrojtja e pasurisë dhe të mirave materiale të qytetareve, duke qëndruar sa më afër komunitetit ku punojmë dhe jetojmë.

Kontribut të veçant kanë dhënë puntoret sezonal të angazhuar nga ana e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, të cilët me punën dhe angazhimin e tyre kanë ndihmuar ekipet e zjarrëfikseve gjatë intervenimeve të ndryshme.

NjPZSH, në këtë periudhë të raportimit ka pasur gjithsej 410 intervenime-dalje

Duhet theksuar se muajt; tetor, nëntor dhe dhjetor kanë qenë të qetë, ku vlen të cekët se numri i intervenimeve ka qenë i vogël, ku në total dalja në 3 muajt e fundit ka qenë vetëm 24 raste intervenimi.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

SFIDAT

Gjatë kësaj periudhë DMSH ka hasur edhe në sfida gjatë implementimit të planeprogramit të punës për vitin 2024 dhe atë:

- mungesa e personelit;
- mungesa e fondit emergjent;
- mungesa e logjistikës;
- statusi i padefinuar i NjPZSH-së.

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM

Kjo është një drejtori e re, e cila do të formësohet si një në ekonominë rajonale, e cila do të shfrytëzojë shtrirjen gjeografike të saj dhe këtë zgjerim do ta ketë edhe jashtë kufijve, duke harmonizuar dhe stimuluar një frymë të rëndësishme në aspektin e zhvillimit ekonomik, social dhe infrastrukturor. Aspekt ky që do të ndërtohet mbi trashëgiminë natyrore, kulturore, arkitektonike, mundësive zhvillimore ekzistuese dhe inovacioneve nëpërmjet politikave transparente duke zgjeruar horizontet në shumë sektorë.

Drejtorja për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm merret me regjistrimin e bizneseve, planifikimin, zhvillimin ekonomik dhe promovimin e turizmit. Kjo drejtori, për herë të parë është themeluar në vitin 2024.



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Përgjatë punës, janë planifikuar dhe realizuar vizita nëpër biznese të ndryshme, për të parë nga afër gjendjen, nevojat, kërkesat dhe planet e tyre lidhur me mbarrëvajtjen e punëve të tyre, për një zhvillim sa më efektiv dhe të qëndrueshëm.

Në vazhdimësi janë vizituar pikat turistike të komunës së Malisheves, për t'u informuar në tërësi lidhur me gjendjen e tyre.

Në vazhdim janë të paraqitura përmes fotove disa nga aktivitetet e realizuara për vitin 2024, në kuadër të fushëveprimtarisë dhe ushtrimit të funksionit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm në krijimin dhe evidentimin e të ardhurave për buxhetin e Kuvendit të Komunës.





Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Po ashtu kjo drejtori ka bërë punë edhe në ridraftimin, harmonizimin dhe sistemimin e Rregullores komunale të tarifave dhe të ngarkesave për vitin 2024.

Përgatitja e programit të evidencës së bizneseve për gjendjen, pagesat dhe ngarkesën e bizneseve për vitin 2024. Është caktuar **taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë** subjekteve që janë të regjistruara dhe konsiderohen aktive dhe ushtrojnë veprimtarinë afariste si biznese në territorin e Komunës së Malishevës.

Janë nxjerrë **1627 aktvendime** mbi caktimin e tarifës për taksapagues nga veprimtaria biznesore. Ngarkesa e caktuar me këto akte të veçanta juridike arrinë shumë e planifikuar (formuar) të të ardhurave për Komunën prej **257 275.00 €**.

Regjistrimi i çdo pagese të kryer nga subjekti përkatës taksapagues që arrinë shumë **19 605.00 €**.

Në vazhdimësi gjatë tërë vitit është **realizuar bashkëpunimi, konsultimet, shkëmbimi i të dhënave, ofrimi i shënimeve, ndihma** me kolegët puna e të cilëve lidhet me biznesin si: inspektoriati komunal, të cilët kryesisht nga këtu pajisen me shënimet mbi gjendjen e obligimeve dhe të dhënave tjera për bizneset dhe, si dhe të gjitha punët administrative nga drejtoritë tjera si, Emergjencë, Shërbimet publike, Zyra për barazi gjinore, dhënja ndihmë studentëve me të dhëna të ndryshme për punimin e temave studimore që kanë të bëjnë me të dhëna të ndryshme për bizneset.



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

Gjatë vitit 2024 janë kryer gjithsejt **656 lëndë**, prej tyre:

- ✓ 206 regjistrime të reja të biznesit,
- ✓ 91 ndryshime në biznese,
- ✓ 42 ndrrime të certifikatave të reja të bizneseve,
- ✓ 211 nxjerrje të informatave të bizneseve,
- ✓ 24 shuarje biznesi,
- ✓ 82 vërtetime biznesi

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në strukturën organizative të Komunës së Malishevës është e sistemuar në kuadër të zyrës së Kryetarit të komunës. NJAB operon me tre (3) auditor, njëri prej tyre është edhe udhëheqës i NJAB-së.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-021, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, NJAB ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt vetëm udhëheqësit të subjektit të sektorit publik dhe e njofton Komitetin e Auditimit. Në raport



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT - 2024

me strukturat tjera organizative në subjektin e sektorit publik, njësia për auditimin e brendshëm ka pavarësinë funksionale në planifikimin e punës së auditimit, në kryerjen e auditimit dhe në raportim.

Në harmoni me Udhëzimin Administrativ MF-NR. 01/2019, për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimi në Subjektin e Sektorit Publik, me datën 27.01.2022, Kryetari i komunës ka themeluar Komitetin e Auditimit (KA) si organ të pavarur këshilldhënës për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.

Llogaridhënia menaxheriale

Udhëheqësi i NJAB-së rregullisht i raporton Kryetarit të Komunës, si dhe Departamentit Qendrore Harmonizues në Ministrinë e Financave, Transfereve dhe Punës (DQH/AB-MFTP), përmes Raporteve gjashtëmujore dhe Raportit Vjetor.

Për çdo raport individual të entitetit të audituar NJAB i raporton Kryetarit të Komunës, ndërsa një kopje të raportit ia dorëzon edhe drejtorit të drejtorisë përkatëse.

Për periudhën raportuese, KA është njoftuar në kohë reale me aktivitet e NJAB-së.

